Prizren Belediyesi Meclisi, mükâfat alan kişinin Prizren Belediyesi ve Kosova Cumhuriyeti'nin çıkarlarına aykırı çalışması durumunda, verilen mükâfatları geri alma hakkını saklı tutar.

BÖLÜM V
SON HÜKÜMLER

Madde 30
Cezalar

Belediyenin mükâfatlarını taklit eden eşyaların üretilmesi, satılması ve taşınması yasaktır ve Kosova'daki mevcut yasalar gereğince cezalandırılır.

Madde 31
Önceki Mükâfatlar

Bu yönetmeliğin yürürlüğe girmesinden önce mükâfatlandırılmış kişiler, mükâfatlarını taşımaya devam edebilir.

Madde 32
Bu Yönetmeliğin Uygulanmasından Sorumlu Kişiler

Bu yönetmeliğin uygulanmasından: Belediye Başkanı, Belediye Meclisi ve ilgili belediye müdürlükleri sorumlu olacaktır.

Madde 33
Yürürlükten Kaldırma Hükümleri

Bu yönetmeliğin yürürlüğe girmesiyle birlikte, 24 Aralık 2015 tarihli ve No. 001/016-180880 numaralı önceki yönetmelik yürürlükten kaldırılır.

Madde 34
Yürürlük

Bu yönetmelik, Yerel Yönetim Kanunu'nun 81. ve 82. maddelerine uygun şartlar yerine getirildikten sonra ve Belediye'nin resmi web sitesinde resmi dillerde yayınlandıktan ve Kosova Cumhuriyeti Resmi Gazetesi'nde yayımlandıktan sonra yürürlüğe girer.

Meclis Başkanı
Antigona Bytyqi

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 563/24 Dt. 18.09.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Data/Date:	**18.09.2024**
Nga/Od/From	Grupi punues
Për/Za/To:	Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës së Prizrenit
CC	Antigona Bytyqi, Kryesuese e Kuvendit Komunal të Prizrenit
Tema/Subjekat/Subject	Raporti (me komente) për ecurinë e konsultimit për raporti për: Rregullores për dhënien e titujve, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Prizrenit

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna me theks neni 30-Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

-Me 31.05.2024, kryetari i Komunës, Shaqir Totaj ka formuar grupin punues për Hartimi e Rregullores për dhënien e titujve, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Prizrenit. Anëtarët e këtij grupi janë: Blerim Rakaj, anëtar; Laura Kelmendi, anëtare; Haziz Krasniqi, anëtar; Idriz Kryeziu, anëtar; Vetan Xhemaj, anëtar; Edona Krasniqi, anëtare; Xhafer Ponik, anëtar; Fatlum Berisha, anëtar, Eroll Shabani anëtar (OJQ EcMaNdryshe).

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **27.08.2024** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/08/Njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-me-qytetare-per-Projekt-Rregullore-per-Dhenien-e-Dekoratave-nga-Komuna-e-Prizrenit.pdf

Në facebook:

Në platformë: https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42593

Njoftimi si lajm në webfaqe:

https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-projekt-rregulloren-per-dhenien-e-dekoratave-nga-komuna-e-prizrenit/

Me 27.08.2024, njoftimi dhe plani (në tri gjuhë) u është dërguar përmes emailit, qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata të ndryshme, drejtor të shkollave, bizneseve, organizatat studentore, ekspert të fushave, mediat lokale, shoqatave të ndryshme si dhe organizata rinore, që të kenë mundësi të njihen më detajshëm me dokumentin në fjalë, sepse disa nga ta nuk kishin pasur mundësi ta lexonin të publikuar në ueb faqe.

Me 06.09.2024, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe:
https://kk.rks-gov.net/prizren/news/mbahet-konsultim-publik-me-qytetare-per-projekt-rregulloren-per-tituj-dekorata-dhe-cmime-nderi-nga/

Në facebook:
https://www.facebook.com/share/p/bPyEnjT8Cb3uetP6/?mibextid=oFDknk

09.09.2024, është publikuar procesverbali për mbajtjen e konsultimit publik, procesverbali është i publikuar në këtë vegëz:

https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/09/Procesverbali-per-Projekt-Rregulloren-per-Dhenien-e-Dekoratave-nga-Komuna-e-Prizrenit-SCAN.pdf

Dokumenti ka qenë në konsultim publik në uebfaqen zyrtare të komunës dhe platformën e konsultime publike, nga data **27.08.2024** deri me **13.09.2024**, ndërsa komentet janë pranuar deri me datë **13.09.2024**.

Tabelori me të dhëna të shkurtra:

Metodat e konsultimit	**Data / Kohëzgjatja**	**Numri i pjesëmarrësve**	**Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime**	**Numri i kërkesave të pranuara**
1-Takime i drejtpërdrejtë me qytetarë për Raporti për: Projekt-Rregullores për dhënien e titujve, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Prizrenit	**06.09.2024** Nga-11:10 Deri-11:45	F M T 3 12 15	5	8 0-Pjesërisht 4-Refuzohen 2-Pranuara 2-Adresuar

Nr	**Kërkesat /Sugjerimet / Komentet**	**Kush ka dhënë kërkesë/ sugjerim**	**Statusi i kërkesës:** **Pranuar:** **Pjesërisht:** **Refuzuar:** **Adresuar**	**Arsyetimi i Komisionit i hartuar me datë 18.09.2024 për pranimin e kërkesave të qytetarëve**
1	1.Cilët janë kriteret për ndarjen e çmimeve dhe dekoratave	Haki Reshtana	**Adresuar**	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se kjo kërkesë është përgjegjësi e komunës së Prizrenit dhe se kriteret janë përcaktuar nga komisioni përkatës, duke u bazuar edhe ne rregullore.
	2.Pse në komision nuk është asnjë anëtar i komunitetit turk		**Refuzuar**	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se kjo kërkesë është përgjegjësi e komunës së Prizrenit dhe se anëtarët e komisionit janë grup profesional i përberë nga zyrtar dhe i mbështetur me ekspertizë e USAID-it përmes kontratës sociale.

2	1.Kërkoj të informohet për arsyen e rritjes së numrit të çmimeve dhe dekoratave që ndanë komuna	Shukri Quni	**Adresuar**	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se kjo kërkesë është përgjegjësi e komunës së Prizrenit dhe grupi punues ka vlerësuar qe rritja e numri te çmimeve e pasuron rregulloren, reflekton pasurinë e pasur kulturore, trashëgiminë historike dhe mirënjohjen e shumë personaliteteve të Prizrenit dhe me gjerë nder vite. Të gjithë anëtarët e komisionit ishin dakord për këtë përgjigje.
	2.Kërkoj që çmimi Xhevat Berisha të ndahet për çdo vjet për arsimtarët dhe profesorët më të suksesshëm		**Pranohet**	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se kjo kërkesë është përgjegjësi e komunës së Prizrenit dhe se vet titulli i çmimit tregon se ky çmim është i paraparë të ndahet çdo vit për kontribute dhënësit në fushën e arsimit dhe më gjerë. Të gjithë anëtarët e komisionit ishin dakord për këtë përgjigje.
3	1.Kërkoj që të saktësohet periudha e dhënies së dekoratës	Bashkim Gashi	**Refuzohet**	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se kjo kërkesë është përgjegjësi e komunës së Prizrenit. Dhe se çmimet do të vlerësohen dhe jepen varësisht nga të arriturat nga personalitet në fushat e ndryshme gjatë gjithë vitit. Të gjithë anëtarët e komisionit ishin dakord për këtë përgjigje.
	2.Dekoratat të mund të jepen më shumë se 1 personi për të njëjtin kontribut		**Pranohet**	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se kjo kërkesë është përgjegjësi e komunës së Prizrenit dhe se mundësia e dhënies së çmimit të më shumë se një personi është e paraparë në rregullore. Të gjithë anëtarët e komisionit ishin dakord për këtë përgjigje.
4	1.Mirë është që të ndahet dekoratë që lëngojnë nga sëmundjet me kancer	Shukrije Berisha	**Refuzohet**	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se kjo kërkesë është përgjegjësi e komunës së Prizrenit dhe se në kuadër të rregullores është paraparë çmimi për kontributin e dhënë në shëndetësi. Të gjithë anëtarët e komisionit ishin dakord për këtë përgjigje.

5	1.Kërkoj nga komisioni ti vizitoj OJQ-të dhe të diskutojnë për çmime	Resmije Krasniqi	**Refuzohet**	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se kjo kërkesë është përgjegjësi e komunës së Prizrenit dhe se grupi punues ka organizuar konsultim publik me qytetarë dhe OJQ të komunës së Prizrenit, rregullorja ka qenë në konsultim publik dhe në platëformen e konsultimeve publike dh enë webfaqen zyrtare të komunës. Të gjithë anëtarët e komisionit ishin dakord për këtë përgjigje.

Shkurtesat:

F-Femra

M-Meshkuj

T-Totali

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

1. Vendimi për formimin e grupit punues për Projekt-Rregullores për dhënien e titujve, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Prizrenit,
2. Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik,
3. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik.

Raporti është përgatitur nga :

Haziz Krasniqi

NJOFTIM PUBLIK

Njoftohen të gjithë banorët e Komunës së Prizrenit për organizimin e konsultimit publik për Projekt-Rregullore për Dhënien e Dekoratave nga Komuna e Prizrenit

Data : 06.09.2024

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit Komunal (Shtëpia e Bardhë)

Ora : 11:00

Të dashur qytetarë/e,

Komuna e Prizrenit përmes grupit punues për hartimin e Projekt-Rregullores për Dhënien e Dekoratave nga Komuna e Prizrenit, duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Prizrenit. Nr. 01/011-5643 dhe Udhëzimet Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, lëshon këtë:

NJOFTIM PUBLIK

Lidhur me organizimin e konsultimit publik me qytetarë për Projekt-Rregulloren për Dhënien e Dekoratave nga Komuna e Prizrenit

Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga **27.08.2024** deri me datën: **13.09.2024**, ndërsa konsultimi publik me qytetarë do të mbahet me **06.09.2024**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal (Shtëpia e Bardhë) me fillim në ora **11:00**.

Komentet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni deri me datën **13.09.2024** në ora **16:00**, në emailat e zyrtarëve: Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net dhe Haziz.Krasniqi@rks-gov.net .

Për më shumë detaje për rregulloren, mund t'i vizitoni vegëzat e mëposhtme:

Uebfaqen zyrtare në rubrikën planet në konsultim publik:
https://kk.rks-gov.net/prizren/category/konsultime-publike/planet-ne-konsultim-publik/

Platformën për Konsultime Publike:
https://konsultimet.rks-gov.net/

Facebook:
https://www.facebook.com/kkprizren

Ymer Berisha
Për:
Udhëheqës i Njësisë për Komunikim me Publikun

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 516/24 Dt. 27.08.2024

JAVNO OBAVEŠTENJE

Obaveštavaju se svi građani Prizrena za organizovanje javne konsultacije za Nacrt Uredbe za dodelu odlikovanja od strane opštine Prizren

Dana : 06.09.2024

Mesto: Sala Skupštine opštine (Bela Kuća).

Vreme: 11:00

Poštovani građani,

Opština Prizren preko radne grupe za izradu Razvojnog Nacrt Uredbe za dodelu odlikovanja od strane opštine Prizren, oslanjajući se na Zakon Br.03/L-040 za Lokalnu Samoupravu, Statut opštine Prizren Br. 01/011-5643 i Administrativna Uputstva (MALS) Br.04/2023 za otvorenu Administraciju u opštinama, daje ovo

JAVNO OBAVEŠTENJE

U vezi sa organizovanjem javne konsultacije građanima sa građanima za Nacrt Uredbe za dodelu odlikovanja od strane opštine Prizren

Ovaj dokument će biti na javnoj konsultaciji od **27.08.2024** do datuma: **13.09.2024**. godine, dok će se javna konsultacija sa građanima održati **06.09.2024**. godine, u sali za sastanke Skupštine opštine (Bela kuća) sa početkom od **11:00** časova.

Komentare i sugestije možete slati do dana **13.09.2024** do **16:00** časova, na email službenika: Adelina.Hoxhaj@rks-gov.ne i Haziz.Krasniqi@rks-gov.net .

Za više detalja u vezi pravilnika, možete posetiti sledeće stranice:

Službena ueb stranica u rubrici za javne konsultacije:
https://kk.rks-gov.net/prizren/category/konsultime-publike/planet-ne-konsultim-publik/
Platforma za Javne konsultacije:
https://konsultimet.rks-gov.net/
Facebook:
https://www.facebook.com/kkprizren

Ymer Berisha
per: [illegible]
Rukovodilac Jedinice za Odnose sa Javnošću

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 516/24 Dt. 27.08.2024



KAMU BİLDİRİSİ

Prizren Belediyesi Tarafından Ödüllerin Verilmesine İlişkin Taslak -Yönetmelik ile ilgili kamu istişarenin düzenleneceği tüm Prizren Belediyesi sakinlerine duyurulur.

Tarih : 06.09.2024

Yer: Belediye Meclis toplantı salonunda (Beyaz Ev)

Saat : 11:00

Sevgili vatandaşlar,

03/L-040 sayılı Yerel Öz Yönetim Kanun'un, 01/011-5643 sayılı Prizren Belediye Tüzüğü, Belediyelerde Açık Yönetim ile ilgili 04/2023 sayılı İdari Yönergeye (YYB) istinaden Prizren Belediyesi Tarafından Ödüllerin Verilmesine İlişkin Taslak - Yönetmelik ile ilgili çalışma grubu aracılığında aşağıda yer alan duyuruyu ilan etmektedir:

Prizren Belediyesi Tarafından Ödüllerin Verilmesine İlişkin Taslak -Yönetmelik ile ilgili halkla kamu istişarenin düzenlenmesi için

KAMU BİLDİRİSİ

Söz konusu belge **27.08.2024-13.09.2024** tarihine kadar kamu istişarede olacaktır. Halkla kamu istişare ise **06.09.2024** tarihinde Belediye Meclisin toplantı salonunda (Beyaz Ev) saat **11:00** başlamak üzere düzenlenecektir.

Yorum ve önerilerinizi **13.09.2024** tarihinde saat **16:00** kadar: Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net ve Haziz.Krasniqi@rks-gov.net yetkililerin e – posta adreslerine iletebilirsiniz.

Yönetmelikle ilgili daha fazla bilgi için aşağıdaki siteleri ziyaret edebilirsiniz:

Resmi web sitenin kamu istişare yönetmelikler kısmında:
https://kk.rks-gov.net/prizren/category/konsultime-publike/planet-ne-konsultim-publik/
Kamu İstişare Platformu:
https://konsultimet.rks-gov.net/
Facebook:
https://www.facebook.com/kkprizren

Ymer Berisha
Për: [illegible]
Halkla İletişim Birim Yöneticisi

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 516/24 Dt. 27.08.2024

PUBLIKUNO PENJARIPE

Penjargyona o sah Prizrenoska Komunake dizune vash organizipe e publikuna konsultaciako vash Proyekt-Regulativa vash Dekoraciengo Deipe kotar Prizrenoski Komuna

Data : 06.09.2024

Than: Komunake Sombeshipaski Kedipyengi Sala (Parno Kher)

Ora : 11:00

Kamle dizune,

Prizrenosko Komuna prekal butyaki grupa vash hramipe e Proyekt-Regulativako vash Dekoraciengo Deipe kotar Prizrenoski Komuna, baziripea pe Krisi Gn. 03/L-040 vash Lokaluno Korkororaipe, Prizrenoska Komunako Statuti. Gn. 01/011-5643 thay Administartivuno Godideipasko LII (MALR) gn.04/2023 vash Puterdi Administracia ani Komuna, mekhla akava:

PUBLIKUNO PENJARIPE

Phanglo e organizipea e publikuna konsultaciako e dizunenca vash Proyekt-Regulativa vash Dekoraciengo Deipe kotar e Prizrenoski Komuna

Akava dokumenti ka ovel pe publikuno konsultipe kotar **27.08.2024** ji pe data: **13.09.2024**, ji kay publikuno konsultipe e dizunenca ka adikergyol pe **06.09.2024**, ani kedipyengi sala e Komunake SOmbeshipasko (Parno Kher) shrdipea pe ora **11:00**.

Komentya thay sugestie shay te biqhalen ji pe data **13.09.2024** pe ora **16:00**, ko sevalutnenge emailya: Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net thay Haziz.Krasniqi@rks-gov.net .

Vash maybut detalya vash e regulativa, shay te vizitinen o tele sikavde linkya:

Ofisialuni uebqham ani rubrika planya vash publikuno konsultipe:
https://kk.rks-gov.net/prizren/category/konsultime-publike/planet-ne-konsultim-publik/
Platforma vash Publikune Konsultacie:
https://konsultimet.rks-gov.net/
Facebook:
https://www.facebook.com/kkprizren

Ymer Berisha
Për:
Phiravno e Uniako vash Komunikipe e Publika

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 516/24 Dt. 27.08.2024

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunes Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 337/24 Dt. 31.05.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM
Për formimin e Grupit Punues

1. Formohet dhe emërohet Grupi Punues për hartimin e Rregullores për dhënien e titujve, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Prizrenit. Për anëtarë të këtij Grupi Punues, emërohen:

   1.1. Blerim Rakaj,
   1.2. Laura Kelmendi,
   1.3. Haziz Krasniqi,
   1.4. Idriz Kryeziu,
   1.5. Vetan Xhemaj,
   1.6. Edona Krasniqi,
   1.7. Xhafer Poniku,
   1.8. Fatlum Berisha.
   1.9. Eroll Shabani.

2. Detyrat e Grupit Punues të emëruar si në pikën 1 të këtij Vendimi është që në afat sa më të shkurtër kohor të hartoj Rregulloren për dhënien e titujve, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Prizrenit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, dhe pas hartimit të draftit përkatës, të njëjtat ti procedohen organeve kompetente për shqyrtim dhe miratim.

3. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

4. Obligohet Grupi Punues për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Grupit Punues,
- Arkivës së Kryetarit.

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e **qytetarëve** pjesëmarrës në konsultimin publik për: Projekt-Rregullore për Dhënien e Dekoratave nga Komuna e Prizrenit.

Emaili dhe numri i telefonit do të përdoren për t'ju dërguar njoftime-ftesa për organizimin e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike.

Data e mbajtjes së konsultimit: **06.09.2024**.

Nr.	Emri	Mbiemri	Gjinia	Emaili	Nr.Tel	Nënshkrimi
1	Edis	Mustafi	M.	[redacted]	[redacted]	
2	Rezart	Ibrahimi	M			
3	Muhamed	Bytyqi	M			
4	Bujar	Puka	M			
5	Pellumb	Pulaj	M			
6	BAKHTIR	QAHFI	M			
7	SHUKRI	QUNI	M			
8	Rezmije	Krasniqi	F			
9	Salih	Bytyqi	M			
10	Shukrije	Berisha	F	shukrijeberisha		
11	Hasan	Berisha	M			
12	HAZIR	KRASNIQI	M			
13	Jeta	Berisha	F			
14	Berat	Hala	M			
15	Mur	Berisha	M			

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 547/24 Dt. 09.09.2024

Procesverbali për- Projekt-Rregulloren për dhënien e titujve, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Prizrenit

Konsultimi publik me qytetarë është organizuar nga grupi punues për hartimin e Plotësim-Ndryshimin e Rregullores për mbikëqyrjen, menaxhimin dhe shfrytëzimin e objekteve publike sportive dhe kulturore .Njoftimet për qytetarë për organizimin e konsultimit publik janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

-Me 31.05.2024, kryetari i Komunës, Shaqir Totaj ka formuar grupin punues për Hartimi e Rregullores për dhënien e titujve, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Prizrenit. Anëtarët e këtij grupi janë: Blerim Rakaj, anëtar; Laura Kelmendi, anëtare; Haziz Krasniqi, anëtar; Idriz Kryeziu, anëtar; Vetan Xhemaj, anëtar; Edona Krasniqi, anëtare; Xhafer Ponik, anëtar; Fatlum Berisha, anëtar, Eroll Shabani anëtar (OJQ EcMaNdryshe).

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **27.08.2024** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/08/Njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-me-qytetare-per-Projekt-Rregullore-per-Dhenien-e-Dekoratave-nga-Komuna-e-Prizrenit.pdf

Në platformë:

https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42593

Njoftimi si lajm në webfaqe:

https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-projekt-rregulloren-per-dhenien-e-dekoratave-nga-komuna-e-prizrenit/

Me 27.08.2024, njoftimi dhe plani (në tri gjuhë) u është dërguar përmes emailit, qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata të ndryshme, drejtor të shkollave, bizneseve, organizatat studentore, ekspert të fushave, mediat lokale, shoqatave të ndryshme si dhe organizata rinore, që të kenë mundësi të njihen më detajshëm me dokumentin në fjalë, sepse disa nga ta nuk kishin pasur mundësi ta lexonin të publikuar në ueb faqe.

Me 06.09.2024, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe:

https://kk.rks-gov.net/prizren/news/mbahet-konsultim-publik-me-qytetare-per-projekt-rregulloren-per-tituj-dekorata-dhe-cmime-nderi-nga/

Në facebook:

https://www.facebook.com/share/p/bPyEnjT8Cb3uetP6/?mibextid=oFDknk

Konsultimi ka filluar në orën 11:10

Ymer Berisha, udhëheqës i Njësisë për Komunikim me Publikun tha se edhe ky dokument do të ketë bashkautorësinë me qytetarët dhe nga qytetarët presim kërkesa, komente, ide dhe sugjerime në mënyrë që ky dokument të jetë sa më përmbajtjesore, profesional dhe lehtë i zbatueshëm.

Për mbajtjen e këtij konsultimi, zyrtarët përgjegjës do të mbajnë shënime dhe do të hartojnë procesverbal dhe më pas edhe raport për gjithë ecurinë e këtij procesi, të dy dokumentet do të publikohen në webfaqen zyrtare të komunës, në mënyrë që të kemi memorie institucionale dhe kurdo që qytetari ka dëshirë të dijë se çka është është kërkuar në këtë konsultim mund ti çaset webfaqes dhe të gjej dokumentin zyrtar.

Kerkesat e qytetarëve të parashtruara gjatë mbajtjes së konsultimit publik me qytetarë:

Haki Reshtana:

1.Cilët janë kriteret për ndarjen e çmimeve dhe dekoratave

2.Pse në komision nuk është asnjë anëtar i komunitetit turk

Shukri Quni:

1.Kërkoj të informohet për arsyen e rritjes së numrit të çmimeve dhe dekoratave që ndanë komuna

2.Kërkoj që çmimi Xhevat Berisha të ndahet për çdo vjet për arsimtarët dhe profesorët më të suksesshëm

Bashkim Gashi:

1.Kërkoj që të saktësohet periudha e dhënies së dekoratës

2.Dekoratat të mund të jepen më shumë se 1 personi për të njëjtin kontribut

Shukrije Berisha:

1.Mirë është që të ndahet dekoratë që lëngojnë nga sëmundjet me kancer

Resmije Krasniqi

1.Kërkoj nga komisioni ti vizitoj OJQ-të dhe të diskutojnë për çmime

Konsultimi ka përfunduar në orën 11:45.

Procesmbajtës:
HAZIZ KRASNIQI

Kuvendi Komunës së Prizrenit
Nr.001/011 -
Më: ..... shtator 2024
Prizren

Në bazë të nenit 12 paragrafit 1, 2, pika d), të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5 paragrafit 1 pika 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, nenit 27 paragrafit 1, të Statutit të Komunës Nr. 01/011-5643, dt.15 tetor 2008, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më ..... shtator 2024, miratoi këtë:

PROPIZIM-V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE PËR PERIUDHËN 2024-2026

Neni 1

Miratohet Plani lokal i veprimit për barazinë gjinore për periudhën 2024-2026, në Komunën e Prizrenit.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi do të jetë, Plani lokal i veprimit për barazinë gjinore për periudhën 2024-2026.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdesen: Kryetari i Komunës, drejtoritë dhe njësitë – sektorët tjerë të përfshira në këtë Plan.

Neni 4

Vendimi, hyn në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikqyrës, konform nenit 81, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, dhe publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesja e Kuvendit
Antigona Bytyqi

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo - Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Municipality of Prizren - Prizren Belediyesi

PLANI LOKAL I VEPRIMIT
PËR
BARAZINË GJINORE

2024 - 2026

Tetor~~Maj~~ 2024

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore (PLVBGJ) 2024 - 2026 u përgatit nga Komuna e Prizrenit me mbështetjen e UN Women Kosovë në kuadër të zbatimit të projektit "Gender Equality Facility" (GEF) me fonde të Bashkimit Evropian.

Grupi Punues

1. Mybexhele Zhuri, Kryesuese
2. Kumrije Bytyqi, Anëtare
3. Nexhat Maçkaj, Anëtar
4. Veton Xhemaj, Anëtar
5. Jakup Kastrati, Anëtar
6. Emine Gashi, Anëtare
7. Haziz Krasniqi, Anëtar
8. Adelina Hoxha, Anëtare
9. Gjafer Ponik, Anëtar
10. Eleonora Fetollari, Anëtar
11. Fatlum Berisha, Anëtar
12. Eroll Shabani, EC Ma Ndryshe, Anëtar
13. Fisnik Minci, Gazetar Anëtar

Në përgatitjen e këtij plani ndihmuan edhe znj. Tringa Kasemi, Drejtore Ekzekutive, Qendra për Barazi dhe Drejtësi, dhe znj. Dhurata Prokshi, DEMOS.

Ekspertiza teknike nga UN Women / GEF:
Artan Binaku, Koordinator Projekti
Monika Kocaqi, Konsulente ndërkombëtare

© Komuna e Prizrenit, 2024. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës, z. Shaqir Totaj

Të nderuara/nderuar, bashkëqytetare e bashkëqytetarë!

Kam kënaqësinë t'ju prezantoj një dokument tepër i rëndësishëm për Komunën tonë, që fuqizon themelet e ndërhyrjeve për Prizrenin tonë të dashur dhe fokusohet në një çështje tepër të rëndësishme për mbarë shoqërinë e për mua personalisht, siç është përparimi drejt barazisë gjinore.

Për barazinë gjinore flitet shumë dhe përparimi i legjislacionit e politikave të Kosovës në këtë drejtim vlen për t'u theksuar e përgëzuar. Komuna jonë, është përpjekur të zbatojë e bëjë realitet këto ligje e politika kombëtare, me qëllim që të mundësojë shërbime të barabarta e gjithëpërfshirëse, por edhe të trajtojë me respekt e dinjitet çdo qytetare e qytetar, që askush të mos mbetet pas. Prizreni, vatra e dijes dhe shkollimit shqiptar, turk e boshnjak, nuk mund të mos hedhë hapat e duhur për të plotësuar nevojat e grupeve më të cenueshme dhe për të fuqizuar zërin e grave, të rejave e vajzave, në të gjitha fushat e jetës. Këtë qëllim e kam pjesë të punës sime, pasi mendoj se thelbi i mirëqeverisjes dhe bashkëqeverisjes është pikërisht identifikimi i nevojave të ndryshme të gjithsecilës dhe gjithsecilit në komunitet si dhe përdorimi me mençuri dhe drejtësi gjinore i të gjitha burimeve komunale, për t'i trajtuar me efektivitet këto nevoja.

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 - 2026 që ju po shfletoni tani, na shërben si mjet praktik i përmbushjes së qëllimit tonë të përbashkët, për Prizrenin e mundësive të barabarta për të gjitha/gjithë banoret e banorët e tij, si dhe për të gjitha/gjithë kalimtaret/kalimtarët, mikeshat/miqtë, e vizitoret/vizitorët, pavarësisht moshës, gjinisë e karakteristikave të tjera individuale. Masat dhe veprimet e parashikuara në këtë plan janë reflektim i nevojave të identifikuara nga zyrtaret/zyrtarët komunalë, por të para edhe nën dritën e përparësive të dokumenteve kombëtarë e ndërkombëtarë të rëndësishëm, veçanërisht të atyre dokumenteve që unifikojnë përvojat e komunave në mbarë Evropën, siç është edhe Karta Evropiane për Barazi të Grave e Burrave në Jetën Lokale.

Gjithashtu ky plan është rezultat i konsultimeve të gjera dhe gjithëpërfshirëse me institucionet publike dhe jo publike në nivel lokal. Falënderimet shkojnë për përfaqësueset dhe përfaqësuesit e këtyre institucioneve, organizatat e shoqërisë civile, të rejat dhe të rinjtë, si dhe anëtaret e anëtarët e Kuvendit Komunal, të cilat/cilët u bënë pjesë e takimeve këshilluese në kuadër të hartimit të këtij plani dhe e miratuan pa hezitim atë. Falënderime të veçanta për UN Women Kosovë që na mbështeti me asistencë teknike përgjatë gjithë procesit, përmes Projektit "Gender Equality Facility" që zbatohet me fonde të Bashkimit Evropian.

Së fundmi, së bashku me falënderimet për zyrtaret dhe zyrtarët e komunës, për angazhimin dhe punën e palodhur për hartimin e këtij plani, dëshiroj të shpreh angazhimin tonë të përbashkët edhe për zbatimin e tij, duke vënë në dispozicion të gjitha burimet e nevojshme njerëzore, financiare, e infrastrukturore, për të përparuar me hapa të sigurt dhe të qëndrueshëm drejt arritjes së barazisë gjinore!

z. Shaqir Totaj
Kryetar i Komunës së Prizrenit

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE 5
I. HYRJE 6
II. KORNIZA LIGJORE DHE INSITUCIONALE 8
III. METODOLOGJIA 10
IV. VIZIONI, OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE 12
V. KOSTO PËR ZBATIMIN E PLVBGJ 2024 - 2026 15
VI. RAPORTIMI DHE MONITORIMI 18
VII. MATRICA E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2024 - 2026 19

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

ABGJ	Agjencia për Barazinë Gjinore
BDPfA	Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave
DA	Drejtoria e Administratës
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DBZHR	Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
DEF	Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave
DES	Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë
DEZH	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim
DGJK	Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastër
DI	Drejtoria e Inspektorateve
DKRS	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
DPMS	Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
DSHP	Drejtoria e Shërbimeve Publike
DSH	Drejtoria e Shëndetësisë
DTZHE	Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik
DUPH	Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor
EU GAP III	Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkimit Evropian III
GG	Grupi Jo-Formal i Grave
KBGJ	Komiteti për Barazi Gjinore
KPF	Komiteti për Politikë dhe Financa
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
NJDNJBGJ	Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
ON	Organizatë Ndërkombëtare
PKBGJ	Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore
PLVBGJ	Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
SDG	Objektiv i Zhvillimit të Qëndrueshëm
ZBGJ	Zyrtare/Zyrtar për Barazinë Gjinore
ZK	Zyra e Kryetarit

I. HYRJE

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore (PLVBGJ) 2024 – 2026 u përgatit nga Komuna e Prizrenit, si mjeti kryesor i zbatimit të angazhimeve publike për barazinë gjinore. të reflektuara në:

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
- Instrumentet kryesore ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin e vendit.
- Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040.
- Ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020, si dhe tërësinë e ligjeve të vendit të fokusuara tek barazia, mosdiskriminimi dhe fuqizimi i grave.
- Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024, si dhe tërësinë e kornizës zhvillimore vendore (programe e strategji) për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave.
- Instrumente dhe mjete të BE-së të fokusuara tek barazia gjinore, si pjesë e procesit të integrimit, veçanërisht ato që përmbajnë veprimet që duhet të ndërmerren në nivelin lokal – siç është edhe Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.

PLVBGJ u përgatit përmes një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim dhe konsultim me institucionet publike lokale, organizatat e shoqërisë civile, Grupin Jo Formal të Grave, organizatat ndërkombëtare, Kuvendin Komunal dhe me zërat e banoreve dhe banorëve të Komunës së Prizrenit, të cilat / cilët patën mundësi të njihen dhe të japin komentet e tyre mbi këtë dokument përgjatë procesit të konsultimit publik. I gjithë procesi u mbështet nga UN Women Kosovë në kuadër të zbatimit të projektit "Gender Equality Facility" (GEF) me fonde të Bashkimit Evropian.

Barazia gjinore nënkupton që të gjitha qeniet njerëzore, si gratë dhe burrat, janë të lirë të zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje pa pasur kufizime të vëna nga stereotipet gjinore, rolet e ngurta gjinore, apo paragjykimet. Barazi gjinore do të thotë që sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave merren parasysh, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë. Barazi gjinore nuk do të thotë që gratë dhe burrat duhet të bëhen të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse kanë lindur femra apo meshkuj. (UN Women, 2011).

Drejtësia gjinore nënkupton që gratë dhe burrat trajtohen në mënyrë të drejtë, sipas nevojave të tyre përkatëse. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë, ose trajtim që është i ndryshëm, por që konsiderohet i barasvlershëm për sa i përket të drejtave, përfitimeve, detyrimeve dhe mundësive. Në kontekstin e zhvillimit, synimet për drejtësi gjinore shpesh kërkojnë përfshirjen e masave që kompensojnë për disavantazhet historike dhe sociale të grave. (UN Women, 2011).[1]

Siç përshkruhet edhe në tekstin e Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale[2], njësitë e vetëqeverisjes lokale janë sfera të qeverisjes që gjenden më pranë njerëzve, ndaj dhe përfaqësojnë nivelet që kanë më tepër mundësi të luftojnë vazhdimësinë dhe riprodhimin e pabarazive, si dhe të avancojnë për një shoqëri me të vërtetë të barabartë. Këto mund të arrihen duke ndërthurur zbatimin e kompetencave të tyre me bashkëpunimin me të gjithë gamën e aktorëve lokalë, për veprime konkrete në favor të barazisë ndërmjet grave dhe burrave[3], të rejave dhe të rinjve[4], vajzave dhe djemve.[5]

Zbatimi dhe promovimi i të drejtës së barazisë duhet të qëndrojë në zemër të konceptit të vetëqeverisjes lokale. Barazia gjinore prej vitesh është evidentuar si një çështje me përparësi në nivel vendi, e për këtë qëllim edhe në nivelin lokal është punuar e po punohet vazhdimisht. Në nivel vendi, në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024, i cili bazohet në Ligjin Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore, jepen qartësisht fushat kryesore të ndërhyrjes, si dhe objektivat specifikë për zbatimin e të cilave duhet

[1] Për një listë më të plotë me koncepte mund të vizitoni edhe: https://eige.europa.eu/thesaurus/browse
[2] Tekstin e Kartës mund ta gjeni në: https://charter-equality.eu/the-charter/lobservatoire-europeen-en.html
[3] "Gra dhe burra" në këtë PLVBGJ nënkupton periudhën moshore duke filluar nga mbi 29 vjeç, deri në fund të jetës (përfshirë edhe të moshuarat/moshuarit).
[4] "Të reja dhe të rinj" në këtë PLVBGJ nënkupton periudhën moshore nga 18 - 29 vjeç.
[5] "Vajza dhe djem" në këtë PLVBGJ nënkupton periudhën moshore nga 0 - 18 vjeç.

të punojnë së bashku institucionet qendrore, lokale, OJQ-të dhe të gjithë partnerët lokalë, kombëtarë e ndërkombëtarë.

Siç përcaktohet edhe në Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024 – 2026, misioni i Komunës së Prizrenit është: "Promovimi dhe ofrimi i zhvillimit dhe rritjes së mirëqenies së banoreve dhe banorëve të komunës, duke ruajtur dinjitetin njerëzor dhe duke ofruar shërbime sa më cilësore, në kohë dhe ***të barabarta*** për të gjitha / gjithë, si dhe ***të ndjeshme për nevojat*** e grave/të rejave/vajzave dhe burrave/të rinjve /djemve."

Në zbatim të kornizës ligjore e të politikave në fuqi në lidhje me çështjet e barazisë gjinore, Komuna e Prizrenit, ka themeluar Njësinë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore dhe ka emëruar një Udhëheqëse të Njësisë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore e cila në mënyrë të përvitshme harton dhe zbaton një plan të veprimeve konkrete për përparimin drejt barazisë gjinore. Ky plan e ka gjetur zbatimin me mbështetjen financiare nga komuna dhe donatorë, përmes partneriteteve e bashkëpunimit. Po kështu, Komuna e Prizrenit po aplikon parimet e integrimit gjinor dhe buxhetimit të përgjegjshëm gjinor përmes analizave gjinore të programeve të drejtorive të caktuara[6], mbledhjes së të dhënave të ndara sipas seksit dhe statistikave gjinore, përcaktimit të treguesve të ndjeshëm gjinorë, etj.

Megjithatë, pavarësisht përparimit të bërë në këtë drejtim në nivel vendor apo komunal, duhet të pranojmë që realiteti ende flet për barazi dhe drejtësi gjinore të munguara në praktikë. Pabarazitë dhe diskriminimi apo disavantazhimi i shumëfishtë, jo vetëm ndërmjet gjinive por edhe ndërmjet grupeve brenda të njëjtës gjini, vijojnë të mbështeten në një sërë nocionesh shoqërore të ndërtuara mbi bazën e steriotipeve të shumta të pranishme në familje, arsim, kulturë, komunikim, botën e punës, në organizimin e shoqërisë, etj.

Prandaj, nëse duam të krijojmë një shoqëri të mbështetur në barazi, është thelbësore që organet e vetëqeverisjes lokale të marrin parasysh plotësisht integrimin gjinor në politikat, organizimin dhe praktikat e tyre të punës. Barazia e vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, është gjithashtu edhe çelësi për suksesin ekonomik dhe shoqëror.

PLVBGJ 2024 - 2026 është konceptuar dhe lidhur pikërisht me kornizën ligjore dhe të politikave kombëtare, por mbështetet dhe merr frymëzim edhe nga dokumentet ndërkombëtarë të rëndësishëm, e synon të përafrohet me standardet dhe kërkesat e *acquis* të BE-së për barazinë gjinore. Masat dhe veprimet e parashikuara në këtë plan, janë hartuar duke pasur parasysh faktin që asnjë ndërhyrje e bërë me sado kujdes dhe burime në dispozicion, nuk mund të jetë e suksesshme nëse nuk merr në konsideratë dhe nuk adreson siç duhet e në mënyrë të barabartë, nevojat e ndryshme të grave e burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve pra të të gjitha/gjithë anëtareve dhe anëtareve të komunitetit. Megjithatë, fuqizimi i grave, të rejave e vajzave mbetet një ndër synimet kryesore, për përmbushjen e objektivave të barazisë gjinore. Për të shprehur sa më qartë domosdoshmërinë e gjithë përfshirjes, në të gjithë tekstin në vijim në këtë PLVBGJ, është përdorur në mënyrë të vazhdueshme shprehja **"në të gjithë diversitetin e tyre"**.[7] Përmes saj theksohet rëndësia e mbështetjes, trajtimit dhe fuqizimit të grave, të rejave dhe vajzave (por edhe burrave, të rinjve e djemve) në tërësi, përfshirë edhe nga grupe të cenueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë e të ndërthurur, për shkak të seksit, moshës, zonës ku jetojnë, etnisë, aftësive të kufizuara, nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, të qenit prind i vetëm, të qenit viktimë / e mbijetuar / i mbijetuar i trafikimit të qenieve njerëzore, apo formave të tjera të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, statusit të migrantes / migrantit, azilkërkueses / azilkërkuesit, apo për shkak të të qenit "person nën mbrojtje ndërkombëtare" (pra me status refugjateje/refugjati, të përkohshëm dhe nën mbrojtje plotësuese), me status "pa shtetësi", etj.

[6] Rol të rëndësishëm këtu ka luajtur edhe mbështetja e vazhdueshme e dhënë nga UN Women, sidomos në kuadër të Programit Rajonal: "Financimi transformues për Barazinë Gjinore drejt një Qeverisjeje më Transparente, Gjithëpërfshirëse dhe Llogaridhënëse në Ballkanin Perëndimor", i financuar nga SIDA dhe i zbatuar në Kosovë prej vitit 2020.

[7] Në kuadër edhe të përafrimit të këtij Plani Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore me Planin e Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore – EU GAP III.

Të gjitha masat dhe veprimet e paraqitura si pjesë e PLVBGJ 2024 - 2026, janë shoqëruar me të dhëna lidhur me treguesit e rezultateve, drejtoritë kryesore përgjegjëse dhe institucionet e organizatat partnere në zbatim, afatet kohore, përgjegjësit për monitorim, si dhe kostot e nevojshme për zbatim. Këto patjetër që janë lidhur dhe me fushat e ndërhyrjes, rezultatet e pritshme, objektivat specifikë, treguesit përkatës dhe dokumentet kryesore ku mbështeten hapat e planifikuar.

II. KORNIZA LIGJORE DHE INSITUCIONALE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përcakton konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut sikurse Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (njohur si CEDAW), Rezoluta 1325 e Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë, apo Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën e Dhunës ndaj Grave e Dhunës në Familje (e njohur si Konventa e Stambollit), drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin vendor dhe në rast konflikti konsiderohet që këto konventa kanë prioritet ndaj akteve dhe ligjeve të nxjerra nga institucionet publike.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, themelon bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës.

Ligji për Barazi Gjinore, garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë.

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore synon të sigurojë që barazia gjinore është në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, në kuadër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve.[8]

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 - 2026 i Komunës Prizren, mbështetet në një tërësi dokumentesh të rëndësishëm ligjorë dhe institucionalë, të cilët udhëheqin njëkohësisht edhe veprimet mbarëkombëtare për fuqizimin e gruas dhe përparimin drejt barazisë gjinore në Kosovë. Si më kryesoret mund të përmendim:

1. **Instrumentet kryesore ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave:**
   - Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut,
   - Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut,
   - Konventa për të Drejtat Politike të Grave,
   - Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore,
   - Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW),
   - Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve,
   - Deklarata dhe Platforma për Veprimit e Pekinit,
   - Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje,
   - Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë,
   - Agjenda e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm, 2030,
   - Strategjia e Barazisë Gjinore 2020 - 2025 e Bashkimit Evropian dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021 - 2025,
   - Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.

2. **Korniza ligjore dhe zhvillimore kombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave:**
   - Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 7, 21 dhe 22,
   - Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040,
   - Ligji për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020,
   - Ligji për Trashëgimi Nr.2004/26,

[8] Shih PKBGJ, fq. 11

- Ligji Nr. 06/L-077 Për ndryshim- plotësimin e Ligjit Nr. 2004/32 për Familjen,
- Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi Nr.05/L-021,
- Ligji për Pronat dhe të Drejtat Pronësore Nr.03/L-154,
- Ligji i Punës Nr. 03/L-212,
- Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore Nr. 08/L-185,
- Ligji Nr.04/l-81 Për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr. 02/L-17,
- Ligji Nr.2011/04-L-096 Për ndryshim- plotësimin e Ligjit të Skemës së Ndihmave Sociale Nr.2003/15,
- Ligji Nr. 03/L022 Për Mbështetje Materiale të Familjeve me Fëmijë me Aftësi të kufizuar Përhershme,
- Ligji Nr. 08/L-109 Për Kompensimin e Viktimave të Krimit,
- Ligji Nr. 06/L-084 Për Mbrojtjen e Fëmijës,
- Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi,
- Ligji Nr. 06/L-026 Për Azil,
- Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020 - 2024,
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim,
- Programi i Reformave Ekonomike,
- Strategjia për Rregullim më të Mirë,
- Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave,
- Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit,
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat Pronësore,
- Rregullorja për banim social,
- Plani i Veprimit për Promovim dhe Edukim Shëndetësor 2024-2026, i Ministrisë së Shëndetësisë, etj.

Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë PLVBGJ 2024 - 2026 kuptohet që mbështeten edhe në strategjitë apo planet kombëtare të veprimit që mbulojnë sektorët e caktuar sipas fushave të tyre.

Përgjegjëse kryesore për zbatimin e PLVBGJ mbetet **Komuna.** Kjo nënkupton përgjegjësi si për zbatim të drejtpërdrejtë të masave dhe veprimeve të parashikuara, ashtu edhe për koordinimin me institucionet dhe aktorët përkatës, që bëjnë të mundur zbatimin e këtyre masave dhe veprimeve. Pra nëse komuna nuk ka mundësi financiare, njerëzore apo infrastrukturore që të zbatojë drejtpërdrejt një masë apo veprim të caktuar, përgjegjësia e saj është të koordinohet dhe të bashkërendojë veprimet me atë institucion që e ka këtë mundësi, duke përfshirë edhe OJQ, institucionet private, organizatat ndërkombëtare, etj. Udhëheqësja e Njësisë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore do të mbetet përgjegjëse për një sërë masash dhe veprimesh të parashikuara në PLVBGJ, por, tashmë ky është një plan i të gjithë komunës ndaj dhe përgjegjësia kryesore për këtë plan në tërësi jo domosdoshmërisht bie mbi ZBGJ. Gjithashtu, PLVBGJ 2024 - 2026, i zbërthyer vit pas viti, zëvendëson edhe Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore që ZBGJ përgatiste dhe paraqiste përpara Kryetarit të Komunës dhe Agjencisë për Barazi Gjinore, në mënyrë të përvitshme.

Rol të rëndësishëm në lidhje me adresimin e çështjeve gjinore, në nivelin lokal luan edhe Grupi Jo Formal i Grave (GG), të cilat gjithashtu kanë dhënë kontribut të rëndësishëm për hartimin e këtij Plani. Në vijim, të gjitha institucionet lokale dhe OJQ të cilat kanë dhënë kontribut gjatë hartimit të PLVBGJ përfshihen si partnere për zbatimin e masave dhe veprimeve kryesore në këtë PLVBGJ, janë gjithashtu të rëndësishme dhe të domosdoshme për të pasur rezultatet e dëshiruara në përparimin drejt barazisë gjinore. Rol të rëndësishëm këtu luajnë edhe organizatat ndërkombëtare nëpërmjet mbështetjes financiare dhe teknike për të zbatuar masa të caktuara të parashikuara në këtë PLVBGJ.

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore, është:

- një **mjet praktik i lokalizimit të dokumenteve të rëndësishëm kombëtarë, por edhe ndërkombëtarë në lidhje me barazinë gjinore** (veçanërisht instrumentet drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin e vendit).
- një **dokument i hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës**, me hapa të mirë përcaktuar, e **në përmbajtje të të cilit reflektohen arritjet dhe sfidat** e ndeshura ndër vite nga Komuna, **në përparimin drejt barazisë gjinore**.
- një **pasqyrim i qartë i roleve dhe përgjegjësive të domosdoshme** për t'u përmbushur brenda Komunës, si dhe ndërmjet Komunës e institucioneve lokale apo organizatave të shoqërisë civile e ato ndërkombëtare, me qëllim **zbatimin në praktikë të parimit të barazisë për të gjitha/gjithë gratë, burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë**, në të gjithë diversitetin e tyre, në Komunën e Prizrenit.

III. METODOLOGJIA

Metodologjia për hartimin e PLVBGJ 2024 - 2026 ishte gjithëpërfshirëse dhe u zhvillua përmes hapave në vijim:

- ✓ **Ngritja e Grupit Punues për përgatitjen e këtij plani, me Vendim të Kryetarit të Komunës**. Grupi Punues për përgatitjen e këtij PLVBGJ u ngrit me Vendim të Kryetarit Nr.650/23 datë 09.10.2023 dhe kishte në përbërje të tij 11 (njëmbëdhjetë) zyrtare / zyrtarë dhe 2 (dy) përfaqësues të shoqërisë civile, konkretisht:
  - Mybexhele Zhuri, Kryesuese
  - Kumrije Bytyqi, Anëtare
  - Nexhat Maçkaj, Anëtar
  - Veton Xhemaj, Anëtar
  - Jakup Kastrati, Anëtar
  - Emine Gashi, Anëtare
  - Haziz Krasniqi, Anëtar
  - Adelina Hoxha, Anëtare
  - Gjafer Ponik, Anëtar
  - Eleonora Fetollari, Anëtar
  - Fatlum Berisha, Anëtar
  - Eroll Shabani, EC Ma Ndryshe, Anëtar
  - Fisnik Minci, Gazetar Anëtar

- ✓ **Analiza dhe vlerësimi i situatës përmes të dhënave dhe informacionit ekzistues**. Kjo analizë u bazua në një tërësi dokumentesh ekzistues të komunës, por padyshim që u shtri edhe në tërësinë e kornizës ligjore dhe të politikave ekzistuese kombëtare e lokale, të lidhura me çështjet gjinore.

- ✓ **Përcaktimi i fushave kryesore të ndërhyrjes**, të domosdoshme për t'u përfshirë në matricën e PLVBGJ 2024 - 2026. Ky përcaktim u bë duke ndjekur një tërësi hapash, si vlerësimi i arritjeve dhe sfidave të komunës për adresimin e çështjeve të barazisë gjinore, identifikimi i prioriteteve bazuar në analizën e cekur më sipër, marrja në konsideratë dhe reflektimi i duhur i komenteve dhe sugjerimeve të dala nga diskutimet me stafin e komunës, etj.).

- ✓ **Konsultimet paraprake brenda komunës dhe hartimi i draft matricës së PLVBGJ**. Këto konsultime u zhvilluan me stafin e komunës si dhe në veçanti me anëtaret / anëtarët e Grupit Punues dhe me Grupin jo Formal të Grave. Që prej fillimit të këtyre konsultimeve u prezantuan instrumente kryesore të rëndësishme ndërkombëtare, sidomos ato të BE-së të lidhura me barazinë gjinore (si për shembull Plani i Veprimit i BE-së për Barazinë Gjinore / EU GAP III, apo Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.). Po kështu u prezantuan edhe prioritetet e cekura në dokumente të rëndësishme kombëtare si Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore 2020 - 2024, Plani i Zbatimit në Nivel Vendi për Kosovën i Planit të Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III, 2021 – 2025, etj. Më pas u kalua në përgatitjen e draft matricës së PLVBGJ-së, e cila përmbante objektivat strategjikë, rezultatet e pritshme, dokumentet se ku referoheshin masat dhe veprimet e parashikuara, objektivat

specifikë, treguesit në nivel objektivi, së bashku me vlerën bazë (e matur për vitin 2023 ose që do përcaktohet gjatë vitit 2024) dhe vlerën e synuar (target) deri në vitin 2026, rezultatin në nivel të objektivit specifik, si dhe aktivitetet, drejtorinë përgjegjëse për zbatim, partnerët dhe bashkëpunëtorët, afatin kohor, koston për tre vitet, burimin e financimit, treguesit për çdo aktivitet, si dhe përgjegjësit për monitorimin e zbatimit të PLVBGJ.

- ✓ **Postimi në faqen e Komunës për komente dhe sugjerime nga individët dhe grupet e interesit**. Draft PLVBGJ 2024 - 2026 u postua në datën 20.05.2024 në linkun https://kk.rks-rrov.net/prizren/konsultime-publike/planet-ne-konsultim-publiU Postimi qëndroi i hapur për komente dhe sugjerime deri në datën 07.06.2024, duke plotësuar kështu detyrimin për konsultimin publik, në mbështetje të Ligjit për vetëqeverisje Lokale Nr.03L-040 dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna.

- ✓ **Mbajtja e konsultimit publik me banoret dhe banorët e Komunës**. Në përputhje dhe vijim të sa cekur më sipër, Komuna e Prizrenit, mbajti edhe sesionin e dëgjimit publik në datën 29.05.2024, në ora 11.00.

- ✓ **Përmirësimi i draft PLVBGJ.** Pas seancës së dëgjimit publik dhe në përfundim të të gjithë procesit të konsultimit publik, Grupi Punues bëri edhe përmirësimin e draft PLVBGJ, bazuar në të gjitha komentet dhe sugjerimet e marra.

- ✓ **Kostimi i matricës së PLVBGJ**. Procesi i kostimit të matricës së PLVBGJ ishte një proces tepër i rëndësishëm që gjithashtu mori kohën e tij përgjatë përgatitjes së dokumentit të plotë. Kostimi u krye për secilin nga aktivitetet e parashikuara në matricën e PLVBGJ-së dhe fondet u ndanë sipas burimit të financimit, konkretisht fonde të mbuluara nga komuna, me burime ekzistuese njerëzore, infrastrukturore apo financiare, fonde të mbuluara nga donatorët, por edhe fonde për gjetjen e të cilave duhet të bëhen rishikime dhe planifikime në buxhetet përkatëse të viteve të ardhshme, ose duhet të lobohet për t'i siguruar përmes bashkëpunimit me donatorët, subjektet private e OJQ-të (pra hendeku financiar).

- ✓ **Dorëzimi i dokumentit të plotë, të kostuar e përfunduar, për miratim në Kuvendin Komunal**. Pas përgatitjes dhe përfundimit të të gjithë procesit, dokumenti i plotë i PLVBGJ, edhe i kostuar, u dorëzua për miratim në Kuvendin Komunal, duke ndjekur të gjitha hapat, detyrimet dhe afatet ligjore përkatëse.

- ✓ **Miratimi i PLVBGJ në Kuvendin Komunal.** PLVBGJ u miratua në mbledhjen e radhës së Kuvendit Komunal në ~~qershor~~ tetor 2024.

Të gjitha hapat e mësipërm shkojnë në linjë jo vetëm me detyrimet kombëtare, por edhe me metodologjinë e përgatitjes së PLVBGJ-ve siç sugjerohet nga Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve të Evropës (KBRE).[9]

Një rol të rëndësishëm në të gjithë procesin e përgatitjes deri në finalizimin e PLVBGJ kanë luajtur organizatat e shoqërisë civile, si dhe mbështetja dhe asistenca teknike e ofruar nga UN Women Kosovë, përmes një ekipi të mirë përgatitur si dhe një konsulenteje[10] të angazhuar për këtë qëllim, në kuadër të zbatimit të Projektit "Gender Equality Facility" (GEF) që financohet nga Bashkimi Evropian.

[9] Për më shumë shikoni në: https://charter-equality.eu/the-action-plan-step-by-step/definir-un-plan-daction-en.html
[10] Znj. Monika Kocaqi, konsulente ndërkombëtare.

IV. VIZIONI, OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE

Vizioni i PLVBGJ-së adreson:
"Një qeverisje të mirë, gjithëpërfshirëse e të drejtë gjinore, ku gratë dhe burrat, të rejat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë e Prizrenit, pavarësisht moshës, vendbanimit, grupit etnik e social, aftësive të kufizuara e nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, statusit civil, të migrantes/migrantit e azilkërkueses/azilkërkuesit, statusit të "personit nën mbrojtje ndërkombëtare" (me status refugjateje/refugjati, të përkohshëm dhe nën mbrojtje plotësuese), statusit "pa shtetësi", statusit të punësimit e gjendjes ekonomike, përkatësisë fetare, apo karakteristikave të tjera individuale, gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimin e saj në praktikë, në të gjitha fushat e jetës".

Parimet[11] që udhëheqin zbatimin e PLVBGJ, mbështeten kryesisht në parimet që udhëheqin në tërësi zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, siç paraqiten në vijim:

1. **Barazia ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve në të gjithë diversitetin e tyre, përbën një të drejtë themelore**. Kjo e drejtë duhet të zbatohet nga organet e vetëqeverisjes lokale në të gjitha fushat e tyre të përgjegjësisë; ajo përfshin gjithashtu edhe detyrimin për të eliminuar të gjitha format e diskriminimit, të drejtpërdrejta apo të tërthorta.

2. **Për të siguruar barazinë gjinore duhet të trajtohen çështjet e diskriminimit dhe të pengesave të shumëfishta.** Përpjekjet për arritjen e barazisë gjinore duhet të marrin parasysh dhe të trajtojnë – nga një këndvështrim gjithëpërfshirës, sistemik dhe strukturor – mënyrat se si ndërvepron gjinia me faktorë të tjerë si seksi, raca, ngjyra e lëkurës, origjina etnike ose sociale, tiparet gjenetike, gjuha, feja ose besimi, opinionet politike dhe çfarëdo opinionesh të tjera, përkatësia në një pakicë kombëtare, pasuria, origjina në lindje, aftësitë e kufizuara, mosha, ose orientimi seksual.

3. **Pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve në vendimmarrje është parakusht për një shoqëri demokratike**. E drejta për barazi të grave dhe burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve, kërkon që organet vetëqeverisëse lokale të marrin të gjitha masat e duhura dhe të miratojnë të gjitha strategjitë e përshtatshme për promovimin e përfaqësimit dhe të pjesëmarrjes së balancuar në të gjitha sferat e vendimmarrjes.

4. **Eliminimi i stereotipeve gjinore ka rëndësi themelore për arritjen e barazisë gjinore**. Organet e vetëqeverisjes lokale duhet të nxisin punën për eliminimin e stereotipeve dhe pengesave që krijojnë pabarazi në statusin dhe gjendjen e grave / të rejave / vajzave dhe që janë burimi i vlerësimit të pabarabartë të roleve të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve nga pikëpamja politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore.

5. **Integrimi i këndvështrimit gjinor në të gjitha veprimtaritë e organeve të vetëqeverisjes lokale është i nevojshëm për të çuar përpara barazinë gjinore**. Perspektiva gjinore duhet të mbahet parasysh gjatë hartimit të politikave, metodave dhe instrumenteve që ndikojnë në jetën e përditshme të popullsisë lokale – për shembull përmes përdorimit të teknikave të "vlerësimeve gjinore", "auditimit gjinor", "integrimit gjinor", dhe të "buxhetimit të përgjegjshëm gjinor". Për arritjen e këtij synimi duhet të analizohen dhe të merren parasysh përvojat e shumta dhe të gjera të grupeve të ndryshme të grave në jetën lokale, si edhe kushtet e jetesës dhe të punës së tyre.

6. **Planet e veprimit, të mbështetura me burimet e duhura, janë instrumente të nevojshme për çuarjen përpara të barazisë gjinore**. Organet e vetëqeverisjes lokale duhet të hartojnë

[11] Për shpjegime më të hollësishme mbi secilin parim, mund të referoheni tek teksti i Kartës Evropiane për Barazi në adresën: https://www.ccre.org/img/uploads/piecesjointe/filename/charte_egalite_al.pdf

plane dhe programe veprimi për barazinë gjinore, të mbështetura me burimet financiare e njerëzore të nevojshme për zbatimin e tyre.

Objektivat strategjikë të PLVBGJ.

PLVBGJ 2024 - 2026 përbëhet nga pesë objektiva strategjike, të cilat janë harmonizuar edhe me:

- Ligjin Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore,
- Programin e Kosovës për Barazinë Gjinore 2020 – 2024,
- Planin e Zbatimit në Nivel Vendi për Kosovën të Planit të Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III (EU GAP III) 2021-2025,
- Konventën për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW),
- Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit),
- Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit (BDPfA),
- Agjendën 2030, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) 2030,
- Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore të BE-së 2021 – 2025 (EU GAP III),
- Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.

Pesë objektivat strategjike të PLVBGJ 2024 - 2026 të Komunës Prizren, renditen në vijim:

1. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.
2. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.
3. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave.
4. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsim cilësor, kulturë e sport, për gratë, burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre.
5. Liri nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.

Secila nga këto objektiva strategjike është zbërthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifikë, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat detajohen në matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë për zbatimin dhe vlerësimin e rezultateve.

Përparimi dhe efektiviteti në zbatimin e PLVBGJ kërkon domosdoshmërisht vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore, financiare e infrastrukturore, si dhe koordinimin e veprimeve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet e tjera lokale, organizatat e shoqërisë civile, institucionet private, si dhe organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore. Mbledhja dhe përditësimi rregullisht i të dhënave të ndara jo vetëm sipas seksit, por edhe sipas një tërësie karakteristikash të tjera individuale, monitorimi i vazhdueshëm mbi ecurinë e zbatimit të veprimeve të parashikuara, si dhe transparenca e llogaridhënia për rezultatet e arritura, janë gjithashtu domosdoshmëri për të përparuar drejt vizionit që udhëheq këtë PLVBGJ.

Rezultatet e pritshme, objektivat specifikë dhe treguesit

Objektivi strategjik: **1. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.**
Rezultatet e pritshme: 1.a. Pjesëmarrja e të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike e publike, e përmirësuar. 1.b. Planet e zhvillimit dhe ndërhyrjes në të gjitha fushat, si dhe programet buxhetore të Komunës, me perspektivën gjinore të integruar.
Objektivat specifikë: 1.1. Rritja e pjesëmarrjes dhe krijimi i mundësive të barabarta për lidership në vendimmarrjen politike e publike, për gratë, të rejat dhe vajzat, në të gjithë diversitetin e tyre, duke sfiduar

normat shoqërore diskriminuese dhe stereotipet gjinore, që nxitin pabarazitë dhe diskriminimin e shumëfishtë e të ndërthurur.

1.2. Rritja e masave dhe veprimeve të Komunës që marrin parasysh e zbatojnë integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.

Treguesit në nivel objektivi:

1.1.a. Numri i grave, të rejave e vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, të informuara mbi të drejtat dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë në vendimmarrjen politike e publike.

1.2.a. Përqindja e buxhetit komunal dedikuar veprimeve për fuqizimin e grave dhe përparimin drejt barazisë gjinore.

Objektivi strategjik:

2. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.

Rezultatet e pritshme:

2.a. Edukimi mbi shëndetin seksual e riprodhues mes profesionisteve/profesionistëve dhe në komunitet, merr rëndësi të veçantë.

2.b. Vendimmarrja tek vajzat, djemtë, të rejat, të rinjtë, gratë dhe burrat për shëndetin seksual e riprodhues, e përmirësuar ndjeshëm.

Objektivi specifik:

2.1. Rritja e qasjes së grave, të rejave, e vajzave si dhe burrave, të rinjve e djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime cilësore shëndetësore dhe të shëndetit seksual e riprodhues.

Treguesi në nivel objektivi:

2.1.a. Numri i grave, të rejave, vajzave, si dhe burrave, të rinjve e djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, me akses të shtuar në kujdesin dhe shërbimet shëndetësore seksuale dhe riprodhuese.

Objektivi strategjik:

3. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave.

Rezultatet e pritshme:

3.a. Pjesëmarrja e grave dhe të rejave në aplikimin dhe përfitimin e subvencioneve të komunës në lidhje me bujqësinë dhe zhvillimin ekonomik, e përmirësuar ndjeshëm.

3.b. Mbështetja e komunës me shërbime sociale cilësore e të ndjeshme gjinore, e rritur.

Objektivat specifike:

3.1. Rritja e qasjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik të tyre.

3.2. Rritja e qasjes së grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave e djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime sociale cilësore, gjithëpërfshirëse e të përgjegjshme gjinore.

Treguesit në nivel objektivi:

3.1.a. Numri i grave / të rejave fermere e në ndërmarrësi, përfituese të granteve dhe subvencioneve të Komunës.

3.2.a Numri i banoreve/banorëve të komunës që përfitojnë nga shërbimet sociale cilësore, gjithëpërfshirëse e të përgjegjshme gjinore.

Objektivi strategjik:

4. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsim cilësor, kulturë e sport, për gratë, burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre.

Rezultatet e pritshme:

4.a. Numri i grave, të rejave e vajzave në të gjithë diversitetin e tyre, të përfshira në arsim cilësor e në procesin e të mësuarit gjatë gjithë jetës, rritur ndjeshëm.

4.b. Mundësitë e barabarta për angazhim dhe vlerësim të figurave të artit, kulturës e sportit, për gratë, burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat e djemtë, të përmirësuara.

Objektivat specifike:

4.1. Ofrimi i mundësive të barabarta për arsim cilësor e të mësuarit gjatë gjithë jetës, për vajzat, të rejat dhe gratë, si dhe djemtë, të rinjtë e burrat e Komunës, në të gjithë diversitetin e tyre.

4.2. Promovimi i modeleve të suksesshme të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, që investojnë dhe marrin pjesë aktivisht në art, kulturë dhe sport.

Treguesit në nivel objektivi:

4.1.a. Numri i vajzave, të rejave dhe grave nga të gjitha grupet, të përfshira në shërbime cilësore të arsimit dhe formimit profesional. 4.2.a. Numri i grave të rejave dhe vajzave që promovohen si modele të suksesshme në art, kulturë dhe sport.
Objektivi strategjik: **5. Liri nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.**
Rezultatet e pritshme: 5.a. Gratë, burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, janë agjentë të ndryshimit për një shoqëri të mundësive të barabarta e pa dhunë.
Objektivi specifik: 5.1. Fuqizimi i Mekanizmit Koordinues në mbrojtje të viktimave/të mbijetuarave / mbijetuarve të dhunës në familje e dhunës me bazë gjinore.
Tregues në nivel objektivi: 5.1.a. Numri i rasteve të menaxhuara me efektivitet e në mënyrë shumë-sektoriale të koordinuar, nga anëtarët e Mekanizmit Koordinues në Prizren.

V. KOSTO PËR ZBATIMIN E PLVBGJ MAJ 2024 - 2026

Të gjitha aktivitetet e parashikuara në matricën e PLVBGJ 2024 - 2026 shoqërohen edhe me një kosto financiare të domosdoshme për zbatimin e tyre, e cila zbërthehet më tej në kosto që mbulohet nga vetë Komuna (si me burimet ekzistuese njerëzore, financiare e infrastrukturore, ashtu edhe me burime që duhet të shtojë), kosto që mbulohet nga donatorët dhe palët e treta, si dhe kosto që ka nevojë për t'u siguruar (apo hendeku financiar).

Është e rëndësishme të theksohet se ndonëse një pjesë të mirë të aktiviteteve Komuna e mbulon përmes angazhimit të burimeve ekzistuese njerëzore e financiare (pra zyrtareve / zyrtarëve, të cilat/cilët aktualisht marrin një pagë fikse, sallave/ambienteve që ka në pronësi për të zhvilluar aktivitete të ndryshme, apo vënien në dispozicion të makinës dhe materialeve kancelarike të cilat blihen në total për të gjithë institucionin, etj.), në këtë Plan Lokal Veprimi për Barazinë Gjinore 2024 - 2026 evidentohet edhe vlera përkatëse e këtij kontributi, me qëllim që gjatë monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të tij, të mundësohet vlerësimi edhe përmes kosto-eficencës. Është e rëndësishme të mbahet në konsideratë fakti që këto përllogaritje janë bërë për minimumin e vlerave që do të kërkonte organizimi i aktiviteteve të propozuara.

Kostot e paraqitura janë orientuese dhe miratimi i këtij Plani Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 - 2026, të kostuar, nuk nënkupton automatikisht edhe buxhetimin e tij. Për të buxhetuar dhe alokuar fondet përkatëse të përvitshme, pa të cilat zbatimi i këtij PLVBGJ nuk merr jetë, Komuna duhet të përfshijë në kornizën e parashikimeve buxhetore vjetore dhe afatmesme edhe masat e parashikuara në këtë PLVBGJ. Në këtë kuadër edhe mbështetja dhe lobimi nga vetë Grupi Jo-Formal i Grave për sigurimin e burimeve financiare për realizimin e aktiviteteve/masave, përmes përfshirjes së tyre në buxhete vjetore apo afatmesme të Komunës, është domosdoshmëri.

Me rishikimin e përvitshëm të Planit Lokal të Veprimit, ***duhet bërë patjetër edhe rishikimi i kostove të propozuara***, bazuar edhe në mënyrën e përfshirjes së tyre në buxhetet vjetore apo KAB-et e Komunës, si dhe në marrëveshjet me donatorët apo partnerët e mundshëm. Kjo kërkon një vëmendje të shtuar sidomos në periudhën e përgatitjes së KAB-eve dhe buxheteve vjetore, për të përfshirë në to masat dhe veprimet e parashikuara në matricën e PLVBGJ, sipas ndarjeve në vite.

Nga përllogaritjet e bëra rezulton se kostot në tërësi për zbatimin e PLVBGJ 2024 - 2026 janë në vlerën **3,263,065 EUR**. Nga këto:

- ***243,765 EUR*** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 1. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.
- ***136,315 EUR*** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 2. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.

- ***2,203,300 EUR (ku përfshihen grante dhe subvencione në total të parashikuara nga komuna)*** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 3. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave.
- ***616,740 EUR*** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 4. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsim cilësor, kulturë e sport, për gratë, burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre.
- ***62,945 EUR*** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 5. Liri nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.

Në totalin e kostos **3,263,065 EUR** të nevojshme për zbatimin në tërësi të PLVBGJ 2024 - 2026 për të gjithë kohëzgjatjen e tij (tre vite):

- ***3,105,428 EUR janë kosto që do të mbulohen nga Komuna*** (me stafin ekzistues dhe me kontribut në natyrë – salla, mjete, etj.), pra ***të cilat nuk kanë nevojë të përllogariten si shtesë në buxhet, sepse edhe burimet njerëzore edhe infrastrukturore ekzistojnë.*** **Këtu përfshihen edhe grante apo subvencionime të planifikuara për fusha të caktuara dhe për banoret dhe banorët në të gjithë diversitetin e tyre dhe vit pas viti do maten se sa kanë përfituar gratë, të rejat dhe vajzat në veçanti.**
- ***28,353 EUR janë kosto që mbulohen nga donatorë*** të ndryshëm (të cilët kanë dakordësuar paraprakisht gjatë përgatitjes së draft PLVBGJ-së).
- ***129,285 EUR (ose 4% e totalit të buxhetit të tre viteve) janë hendek financiar,*** për të cilat komuna do të lobojë për gjetjen e burimeve financuese, ose do të bëjë planifikimet e saj shtesë në KAB-et e ardhshme, duke filluar nga KAB 2025 - 2027.

Objektivat strategjikë	**Objektivat specifikë**	**Gjithsej kosto për tre vjet**	**Komuna**	**Donatorë të konfirmuar**	**Hendek financiar**
1. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.	1.1. Rritja e pjesëmarrjes dhe krijimi i mundësive të barabarta për lidership në vendimmarrjen politike e publike, për gratë, të rejat dhe vajzat, në të gjithë diversitetin e tyre, duke sfiduar normat shoqërore diskriminuese dhe stereotipet gjinore, që nxitin pabarazitë dhe diskriminimin e shumëfishtë e të ndërthurur.	117,700 EUR	37,973 EUR	15,618 EUR	64,110 EUR
	1.2. Rritja e masave dhe veprimeve të Komunës që marrin parasysh e zbatojnë integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.	126,065 EUR	71,890 EUR	11,235 EUR	42,940 EUR
Gjithsej Objektivi strategjik 1:		**243,765 EUR**	**109,863 EUR**	**26,853 EUR**	**107,050 EUR**
2. Promovimi i shëndetit dhe të	2.1. Rritja e qasjes së grave, të rejave, e	136,315 EUR	133,315 EUR	1,500 EUR	1,500 EUR

drejtave seksuale dhe riprodhuese.	vajzave si dhe burrave, të rinjve e djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime cilësore shëndetësore dhe të shëndetit seksual e riprodhues.				
Gjithsej Objektivi strategjik 2:		**136,315 EUR**	**133,315 EUR**	**1,500 EUR**	**1,500 EUR**
3. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave.	3.1. Rritja e qasjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik të tyre.	6,300 EUR	6,300 EUR	0 EUR	0 EUR
	3.2. Rritja e qasjes së grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave e djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime sociale cilësore, gjithëpërfshirëse e të përgjegjshme gjinore.	2,197,000 EUR	2,191,000[12] EUR	0 EUR	6,000 EUR
Gjithsej Objektivi strategjik 3:		**2,203,300 EUR**	**2,197,300 EUR**	**0 EUR**	**6,000 EUR**
4. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsim cilësor, kulturë e sport, për gratë, burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre.	4.1. Ofrimi i mundësive të barabarta për arsim cilësor e të mësuarit gjatë gjithë jetës, për vajzat, të rejat dhe gratë, si dhe djemtë, të rinjtë e burrat e Komunës, në të gjithë diversitetin e tyre.	613,800 EUR	613,800[13] EUR	0 EUR	0 EUR
	4.2. Promovimi i modeleve të suksesshme të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, që investojnë dhe marrin pjesë aktivisht në art, kulturë dhe sport.	2,940 EUR	1,380 EUR	0 EUR	1,560 EUR

[12] Këtu futen edhe subvencionet në total për të gjitha familjet skamnore. Ndarja sipas kryefamiljareve gra, do të bëhet në raportimet e përvitshme

[13] Këtu përfshihen edhe bursat dhe investimet në total. Komuna do raportojë në mënyrë të përvitshme sa % e këtij buxheti shkon për gratë, të rejat dhe vajzat.

Gjithsej Objektivi strategjik 4:		**616,740 EUR**	**615,180 EUR**	**0 EUR**	**1,560 EUR**
5. Liri nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.	5.1. Fuqizimi i Mekanizmit Koordinues në mbrojtje të viktimave/të mbijetuarave / mbijetuarve të dhunës në familje e dhunës me bazë gjinore.	62,945 EUR	49,770 EUR	0 EUR	13,175 EUR
Gjithsej Objektivi strategjik 5:		**62,945 EUR**	**49,770 EUR**	**0 EUR**	**13,175 EUR**

Për më shumë detaje, lutemi referohuni tek Matrica e Planit Lokal të Veprimit në vijim.

VI. RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Procesi i raportimit për aktivitetet e zbatuara do të kryhet nga Drejtoria përgjegjëse për zbatimin e aktivitetit tek ***Zyra e Kryetarit.***

Menjëherë pas miratimit të Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 - 2026, si hap i parë i zbatimit të tij, do të mblidhen të dhënat për vlerën bazë të treguesve në nivel të objektivave specifikë. Po kështu do të hartohen edhe fletët e treguesve me informacionin që duhet të mblidhet dhe raportohet në bazë aktiviteti, por edhe në bazë të objektivave specifikë. ***Raportimet në bazë të objektivave specifikë*** do të përgatiten ***dy herë në vit (çdo 6 muaj)*** ose në bazë të kërkesës së Zyrës së Kryetarit.

Monitorimi i zbatimit të Planit Vendor të Veprimit ***në nivel të objektivave*** do të kryhet nga **Komiteti për Barazi Gjinore (KBGJ)** dhe **Grupi Jo Formal i Grave (GG)** në nivel të **Kuvendit Komunal.** Raportet e përgatitura do të përcillen sipas nevojës/kërkesës edhe në Agjencinë për Barazi Gjinore apo në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Bazuar në monitorimin e kryer, PLVBGJ ***duhet të rishikohet dhe përmirësohet*** në mënyrë periodike dhe të paktën çdo një vit nga data e fillimit të zbatimit të tij.

VII. MATRICA E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2024 - 2026

OBJEKTIVI STRATEGJIK:	**1. PROMOVIMI I BARAZISË GJINORE DHE FUQIZIMI I GRAVE, TË REJAVE DHE VAJZAVE NË TË GJITHË DIVERSITETIN E TYRE.**
Rezultatet e pritshme:	1.a. Pjesëmarrja e të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike e publike, e përmirësuar. 1.b. Planet e zhvillimit dhe ndërhyrjes në të gjitha fushat, si dhe programet buxhetore të Komunës, me perspektivën gjinore të integruar.
Referenca në dokumentet kryesore:	- Ligji Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore, nenet 1, 2, 4, 5, 6, 12. - Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore 2020 – 2024, objektivi strategjik 1, objektivi specifik 1.2, objektivi strategjik 3, objektivat specifike 3.1 dhe 3.2. - Plani i Zbatimit në Nivel Vendi për Kosovën i Planit të Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III (EU GAP III) 2021-2025, fusha tematike 1, objektivat specifike 3.2 dhe 3.7, fusha tematike 4, objektivat specifike 4.1, 4.2 dhe 4.4. - Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) – nenet 2, 3, 4, 5 dhe 7. - Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) – nenet 4 dhe 6. - Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA), fushat kritike 7, 8 dhe 9. - Agjenda 2030, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) 2030, SDG 5, target 5.1, 5.2, 5.3, 5.4, 5.a dhe 5.c, treguesit 5.1.1, 5.2.1, 5.2.2, 5.3.1, 5.4.1, 5.5.1, 5.5.2, 5.a.1, 5.a.2 dhe 5.c.1; SDG 16, target 16.7 dhe 16.b, treguesit 16.7.1, 16.7.2 dhe 16.b.1 - Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE-së 2021 – 2025 (EU GAP III), fusha tematike 4. - Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, nenet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10.
Objektivi specifik:	***1.1. Rritja e pjesëmarrjes dhe krijimi i mundësive të barabarta për lidership në vendimmarrjen politike e publike, për gratë, të rejat dhe vajzat, në të gjithë diversitetin e tyre, duke sfiduar normat shoqërore diskriminuese dhe stereotipet gjinore, që nxitin pabarazitë dhe diskriminimin e shumëfishtë e të ndërthurur.***

Treguesi	**Vlera bazë (2024)**	**Synimi i vitit të fundit (2026)**	**Rezultati**
1.1.a. Numri i grave, të rejave e vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, të informuara mbi të drejtat dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë në vendimmarrjen politike e publike.	Do përcaktohet	Rritur me 10%	Më shumë vajza, të reja e gra, në të gjithë diversitetin e tyre, informohen e vetëdijesohen për të drejtat dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë në vendimmarrjen politike e publike.

AKTIVITETET	**ZBATIMI**		**AFATI KOHOR**	**KOSTO (€)**			**BURIMI I FINANCIMIT**	**TREGUESIT**	**MONITORIMI**
	Drejtoria / zyra përgjegjëse	**Drejtoritë/ zyrat mbështetëse**		**2024**	**2025**	**2026**			
1.1.1. Takime informuese me gratë dhe të rejat, në të gjithë diversitetin	Grupi Jo-Formal i Grave (GG)	Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe	2024 - 2026	1,220 € (komuna)	1,220 € (komuna)	1,220 € (komuna)	Zyra e Kryetarit (ZK)	- 6 takime të zhvilluara (2 në vit)	Komiteti për Barazi Gjinore (KBGJ)

e tyre, mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në Këshillat Lokale.		Barazinë Gjinore (NJDNJBGJ) Organizatat jo Qeveritare (OJQ) Organizatat Ndërkombëtare (ON)						- 240 gra të informuara (80 në vit), ndarë sipas moshës, etnisë, vendbanimit, etj.	Grupi Jo Formal i Grave (GG)
1.1.2. Identifikimi i nevojave dhe organizimi i një trajnimi/ apo aktiviteteve për fuqizimin e kapaciteteve për gratë dhe burrat e zgjedhur si kryetare/kryetarë të fshatrave dhe Këshillave Lokale	NJDNJBGJ	GG OJQ ON	2025 - 2026	/	Do përllogaritet në bazë të vlerësimit të nevojave dhe kërkesave të tyre	Do përllogaritet në bazë të vlerësimit të nevojave dhe kërkesave të tyre	NJDNJBGJ Donatorët	- Numri i aktiviteteve për fuqizimin e kapaciteteve të zhvilluara dhe numri i personave të përfshirë, ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, pozicionit, etj.	KBGJ GG
1.1.~~3~~2. Sesione informuese me nxënësët / nxënësit dhe studentet/studentët mbi pjesëmarrjen dhe lidershipin e barabartë gjinor, si dhe për çështje të tjera të fuqizimit të gruas e barazisë gjinore, në shkollat e komunës.	Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA)	NJDNJBGJ Shkollat OJQ ON	2024 - 2026	3,715 € (nga të cilat 2,423 € komuna dhe 1,293 € donatori)	3,715 € (nga të cilat 2,423 € komuna dhe 1,293 € donatori)	3,715 € (nga të cilat 2,423 € komuna dhe 1,293 € donatori)	DKA Donatorët[14]	33 sesione të zhvilluara (9 sesione në shkolla dhe 2 sesione në universitet, në vit) - 825 persona të informuar (275 në vit),	KBGJ GG

[14] Për këtë aktivitet do të kontribuojë edhe Qendra për Barazi dhe Drejtësi, Prizren

								ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, etj.	
1.1.34. Sesione informuese /trajnuese mbi barazinë gjinore dhe rëndësinë e integrimit gjinor në politikat lokale, për Grupin Jo Formal të Grave.	Kuvendi Komunal	NJDNJBGJ OJQ ON	2024 - 2026	520 € (nga të cilat 300 € komuna dhe 220 € donatori)	520 € (nga të cilat 300 € komuna dhe 220 € donatori)	520 € (nga të cilat 300 € komuna dhe 220 € donatori)	ZK Donatorët[15]	- 6 sesione të zhvilluara (2 në vit) - 10 asambleiste të informuara, ndarë sipas moshës, pozitës, partisë politike, etj.	KBGJ GG
1.1.54. Aktivitete sensibilizuese në kuadër të "Javës së Gruas" (8 Mars).	NJDNJBGJ	GG OJQ ON	2024 - 2026	2,430 € (nga të cilat 1,080 € komuna dhe 1,350€ donatori)	2,430 € (nga të cilat 1,080 € komuna dhe 1,350€ donatori)	2,430 € (nga të cilat 1,080 € komuna dhe 1,350€ donatori)	ZK Donatorët[16]	- 15 aktivitete të zhvilluara (5 në vit) - 300 persona të informuar (100 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.	KBGJ GG
1.1.56. Aktivitete vetëdijesuese për shënimin e ditës (ditëve) ndërkombëtare të vajzave[17].	NJDNJBGJ	DKA GG	2024 - 2026	2,060 €	2,060 €	2,060 €	ZK	- 6 aktivitete të zhvilluara (2 në vit)	KBGJ GG

[15] Për këtë aktivitet do të kontribuojë edhe DEMOS

[16] Për këtë aktivitet do të kontribuojë edhe Qendra për Barazi dhe Drejtësi, Prizren

[17] Data **11 tetor** është shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara si Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve Vajza, për të njohur të drejtat e vajzave dhe sfidat unike me të cilat përballen vajzat në mbarë botën)miratuar me Rezolutën 66/170, datë 19 dhjetor 2011). Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve Vajza fokuson vëmendjen në nevojën për të adresuar sfidat me të cilat përballen vajzat dhe për të promovuar fuqizimin e vajzave dhe përmbushjen e të drejtave të tyre njerëzore. Për më shumë shih: https://www.un.org/en/observances/girl-child-day Ditë të tjera ndërkombëtare të lidhura me fëmijët (pra vajza dhe djem), si dhe me të rejat e të rinjtë, janë: 12 qershori – Dita botërore kundër punës së fëmijëve, 12 gushti – Dita ndërkombëtare e rinisë, 20

		OJQ ON		(nga të cilat 1,330€ komuna dhe 730 € donatori)	(nga të cilat 1,330€ komuna dhe 730 € donatori)	(nga të cilat 1,330€ komuna dhe 730 € donatori)	Donatorët[18]	- 300 persona të informuar (100 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.	
1.1.~~76~~. Takime vetëdijesuese për ndërgjegjësimin e prindërve (nëna dhe baballarë), si dhe të vajzave e djemve, për parandalimin e martesave të hershme.	Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (DPMS)	NJDNJBGJ DKA OJQ ON	2024 - 2026	1,140 € (nga të cilat 770 € komuna dhe 370 € hendek financiar)	1,140 € (nga të cilat 770 € komuna dhe 370 € hendek financiar)	1,140 € (nga të cilat 770 € komuna dhe 370 € hendek financiar)	ZK Donatorët	- 6 takime të zhvilluara (3 në vit) - 135 persona të informuar (45 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.	KBGJ GG
1.1.~~87~~. Promovimi i rolit të rëndësishëm të grave në proceset zhvillimore të shoqërisë duke evidentuar modelet pozitive të grave në vendimmarrjen politike e publike.	GG	NJDNJBGJ DKA Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik (DTZHE) OJQ ON	2024 - 2026	830 € (komuna)	830 € (komuna)	830 € (komuna)	ZK Donatorët	- 6 takime promovuese të zhvilluara (2 në vit). -180 persona të informuar (60 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, aftësive, etj. - Numri i modeleve të grave në	KBGJ GG

nëntori – Dita botërore e fëmijëve; në prill (data ndryshon çdo vit, nga 22-28 prill) – dita ndërkombëtare e vajzave në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, etj. Për më shumë shih kalendarin e ditëve ndërkombëtare në: https://www.un.org/en/observances/list-days-weeks

[18] Për këtë aktivitet do të kontribuojë edhe Qendra për Barazi dhe Drejtësi, Prizren

								vendimmarrje të promovuara çdo vit	
1.1.~~08~~. Publikimi i revistës "Barazia Gjinore në Fokus".	Drejtoria e Administratës (DA)	NJDNJBGJ Të gjitha drejtoritë komunale GG OJQ ON	2025 - 2026	/	31,650 € (nga të cilat 450 € komuna dhe 31,200 € hendek financiar[19])	31,650 € (nga të cilat 450 € komuna dhe 31,200 € hendek financiar[20])	ZK Donatorët	- Revista "Barazia Gjinore në Fokus" e publikuar dhe shpërndarë çdo 2 muaj (nga 500 copë për çdo botim)	KBGJ GG
1.1.~~09~~. Takime me të punësuarat/punësuarit në institucione lokale dhe diskutimi mbi rëndësinë e njohjes dhe raportimit të ngacmimeve seksuale në vendin e punës.	NJDNJBGJ	OJQ ON	2024 - 2026	3,740 € (nga të cilat 2,620 € komuna dhe 1,120 € donatori)	3,740 € (nga të cilat 2,620 € komuna dhe 1,120 € donatori)	3,740 € (nga të cilat 2,620 € komuna dhe 1,120 € donatori)	ZK Donatorët[21]	- 42 takime të zhvilluara (14 në vit) - 420 persona të informuar (140 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.	KBGJ GG
1.1.1~~0~~1. Hartimi dhe miratimi i një politike komunale kundër ngacmimit seksual në vendin e punës.	DA	Zyra Ligjore (ZL) NJDNJBGJ GG	2024	7,875 € (nga të cilat 5,300 € komuna dhe 2,575 € donatori)	/	/	DA Donatorët[22]	- Politika e hartuar dhe miratuar	KBGJ GG

[19] Organizatat Jo Qeveritare janë angazhuar se do të mbështetin komunën për të mbuluar këtë hendek financiar
[20] Njëlloj si më sipër
[21] Për këtë aktivitet do të kontribuojë edhe Qendra për Barazi dhe Drejtësi, Prizren
[22] Për këtë aktivitet do të kontribuojë Qendra për Barazi dhe Drejtësi, Prizren si dhe UN Women

		OJQ ON							
1.1.112. Fillimi i punës për ngritjen e Muzeut të Nënë Terezës.	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (DKRS)	DTZHE DA ON	2025 - 2026	/	Do përllogaritet varësisht hapave që do hidhen gjatë vitit	Do përllogaritet varësisht hapave që do hidhen gjatë vitit	DKRS Donatorët	- Procedurat për ngritjen e Muzeut të përfunduara së bashku me studimin e fizibilitetit; - Puna për ngritjen e muzeut e filluar	KBGJ GG
1.1.123. Miratimi i masave të veçanta[23] që sigurojnë barazi gjinore në praktikë, në pozitat vendimmarrëse të ekzekutivit komunal, për shtimin e zyrtareve gra / të reja në të gjitha drejtoritë komunale sipas nevojës.	DA	ZL NJDNJBGJ GG OJQ ON	2024	2,650 € (nga të cilat 2,050 € komuna dhe 600 € hendek financiar)	/	/	DA	- Masat e hartuara dhe miratuara	KBGJ GG
Objektivi specifik:	***1.2. Rritja e masave dhe veprimeve të Komunës që marrin parasysh e zbatojnë integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.***								
Treguesi			**Vlera bazë (2024)**	**Synimi i vitit të fundit (2026)**	**Rezultati**				

[23] Vendosja e poentimeve, sistemit të kuotave apo zbatimi i masave të tjera të përcaktuara në Ligjin 05/L -020 "Për Barazi Gjinore", që mundësojnë pjesëmarrjen e barabartë gjinore në Këshillat Lokalë, në përzgjedhjen dhe punësimin e zyrtareve/zyrtarëve në pozitat vendimmarrëse në komunë, institucionet lokale publike (shkolla, shëndetësi, etj.), si dhe gjatë plotësimit të vendeve në drejtoritë përkatëse komunale me zyrtare gra / të reja.

1.2.a. Përqindja e buxhetit komunal dedikuar veprimeve për fuqizimin e grave dhe përparimin drejt barazisë gjinore.	Do përcaktohet	Rritur me 6%	Komuna do të hedhë hapa konkretë për integrimin gjinor në të gjithë fushat e veprimtarisë së saj, që do të realizohen duke përdorur si mjet kryesor buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.

AKTIVITETET	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO (€)			BURIMI I FINANCIMIT	TREGUESIT	MONITORIMI
	Drejtoria / zyra përgjegjëse	Drejtoritë/ zyrat mbështetëse		2024	2025	2026			
1.2.1. Takime koordinuese me institucionet lokale, OJQ dhe ON për zbatimin e PLVBGJ.	NJDNJBGJ	Drejtoritë komunale përgjegjëse për zbatimin e PLVBGJ	2024 - 2026	365 € (komuna)	365 € (komuna)	365 € (komuna)	ZK Donatorët	- 3 takime të zhvilluara (1 në vit) - 60 persona të përfshirë (20 në vit), ndarë sipas seksit, institucionit, etj - Plani i punës i koordinuar për zbatimin e PLVBGJ i përgatitur çdo vit	KBGJ GG
1.2.2. Ngritja e kapaciteteve të zyrtareve / zyrtarëve të komunës, për integrimin gjinor, vlerësimin e ndikimit gjinor në politika publike në nivel lokal.	NJDNJBGJ	OJQ ON	2024 - 2026	2,360 € (nga të cilat 300 € komuna, 1,030 € donatori dhe 1,030 € hendek financiar)	2,360 € (nga të cilat 300 € komuna dhe 2,060 € hendek financiar)	2,360 € (nga të cilat 300 € komuna dhe 2,060 € hendek financiar)	ZK Donatorët[24]	- 6 trajnime të zhvilluara (2 në vit). - 90 persona të trajnuar (30 në vit) ndarë sipas seksit, moshës, profesionit, etj.	KBGJ GG

[24] Për të realizuar këto trajnime do ofrojë mbështetje edhe UN Women.

1.2.3. Ngritja e kapaciteteve të zyrtareve / zyrtarëve të komunës, për aplikimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.	NJDNJBGJ	OJQ ON	2024 - 2026	2,360 € (nga të cilat 300 € komuna, 1,030 € donatori dhe 1,030 € hendek financiar)	2,360 € (nga të cilat 300 € komuna dhe 2,060 € hendek financiar)	2,360 € (nga të cilat 300 € komuna dhe 2,060 € hendek financiar)	ZK Donatorët[25]	- 6 trajnime të zhvilluara (2 në vit). - 90 persona të trajnuar (30 në vit) ndarë sipas seksit, moshës, profesionit, etj.	KBGJ GG
1.2.4. Aplikimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor (BPGJ) nga drejtoritë e komunës.	Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave (DEF)	Drejtoritë komunale OJQ ON	2024 - 2026	1,375 € (nga të cilat 375 € komuna dhe 1,000 € donatori)	1,375 € (nga të cilat 375 € komuna dhe 1,000 € donatori)	1,375 € (nga të cilat 375 € komuna dhe 1,000 € donatori)	DEF Donatorët[26]	- Numri i programeve buxhetore të analizuara nga këndvështrimi gjinor dhe ku aplikohet BPGJ	KBGJ GG
1.2.5. Takime informuese me gra / të reja / vajza dhe burra/të rinj/djem, në të gjithë diversitetin e tyre, mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në dëgjimet publike në përgjithësi, e veçanërisht në dëgjimet buxhetore.	Të gjitha drejtoritë komunale që organizojnë dëgjime publike	DEF NJDNJBGJ OJQ ON	2024 - 2026	3,240 € (nga të cilat 1,515 € komuna dhe 1,725 € donatori)	3,240 € (nga të cilat 1,515 € komuna dhe 1,725 € donatori)	3,240 € (nga të cilat 1,515 € komuna dhe 1,725 € donatori)	Drejtoritë komunale Donatorët[27]	- 30 takime të zhvilluara (10 në vit) - 300 persona të informuar informuara (100 në vit), ndarë sipas moshës, etnisë, vendbanimit, aftësive, etj.	KBGJ GG

[25] Për të realizuar këto trajnime do ofrojë mbështetje edhe UN Women.
[26] UN Women dhe DEMOS mund të ofrojnë mbështetje për këtë aktivitet
[27] UN Women dhe DEMOS mund të ofrojnë mbështetje për këtë aktivitet

1.2.6. Përgatitja e formave të unifikuara[28] për mbledhjen e të dhënave të ndara sipas seksit dhe karakteristikave të tjera individuale, si dhe publikimin e informacioneve, për të gjitha aktivitetet që organizon komuna.	DA	NJDNJBGJ Zyra e Informimit (ZI) OJQ ON	2024	2,050 € (nga të cilat 1,050 € komuna dhe 1,000 € donatori[29])	/	/	DA	- Format e përgatitura - Të dhënat që mblidhen të ndara, bazuar në plotësimin e tyre.	KBGJ GG
1.2.7. Mbledhja e të dhënave bazë për të gjithë treguesit në nivel objektivi specifik, të përcaktuar për matjen e progresit të këtij PLVBGJ.	Të gjitha drejtoritë komunale përgjegjëse	NJDNJBGJ OJQ ON	2024	400 € (komuna)	/	/	Drejtoritë komunale	- Tabela me të dhëna të plotësuara të vlerës bazë për secilin tregues të objektivave specifikë	KBGJ GG
1.2.8. Shtimi në faqen zyrtare të internetit të Komunës, i një vegëze me informacione dedikuar çështjeve të Barazisë Gjinore dhe përditësimi rregullisht i saj.	Njësia e Komunikimit me Publikun (NJKP)	NJDNJBGJ Të gjitha drejtoritë komunale përgjegjëse	2024 - 2026	2,475 € (komuna)	2,700 € (komuna)	2,700 € (komuna)	NJKP Të gjitha drejtoritë komunale përgjegjëse	- Vegëza e shtuar. -Informacioni i përditësuar rregullisht.	KBGJ GG
1.2.9. Publikimi i gjetjeve nga monitorimi i zbatimit të këtij Plani Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore.	NJKP	NJDNJBGJ Të gjitha drejtoritë komunale përgjegjëse	2024 - 2026	2,300 € (komuna)	2,300 € (komuna)	2,300 € (komuna)	NJKP Të gjitha drejtoritë komunale përgjegjëse	- Gjetjet e publikuara në mënyrë të përvitshme, bazuar në raportin e plotë	KBGJ GG

[28] Këtu bëhet fjalë për unifikimin e mbledhjes së të dhënave për pjesëmarrëset / pjesëmarrësit në të gjitha aktivitetet që zhvillon komuna, pavarësisht drejtorisë e fushës përkatëse. Pra do përgatitet një tabelë (p.sh. në Excel) me të gjithë specifikimet që duhet të përmbajnë të dhënat (si p.sh. numri i pjesëmarrëseve / pjesëmarrësve, seksi, mosha, etnia, aftësia e kufizuar, vendbanimi…etj.) dhe në bazë të saj do unifikohen edhe listat e pjesëmarrjes që duhet të plotësohen në çdo aktivitet. Ngjashmërisht, do përgatitet një fletë me udhëzime për mënyrën se si do të përgatitet informacioni për publikim në faqen e internetit të komunës, të zbatimit të aktiviteteve përkatëse në këtë PLVBGJ.

[29] Për zbatimin e këtij aktiviteti do të ofrojë mbështetje edhe DEMOS dhe UN Women

								të monitorimit të zbatimit të PLVBGJ	
1.2.10. Fuqizimi i NJDNJBGJ (shtim i dy zyrtareve/zyrtarëve me kohë të plotë dedikuar BGJ)	Zyra e Burimeve Njerëzore (ZBNJ)	ZK	2025 - 2026	/	13,320 € (hendek financiar)[30]	13,320 € (hendek financiar)[31]	ZBNJ	- Dy zyrtare/zyrtarë me kohë të plotë dedikuar çështjeve të BGJ të shtuar në strukturë	KBGJ GG
1.2.11. Trajnimi i zyrtareve/ zyrtarëve komunalë për përdorimin e gjuhës së ndjeshme gjinore, gjithëpërfshirëse dhe jo-diskriminuese.	NJDNJBGJ	ABGJ OJQ ON	2024 - 2026	1,275 € (nga të cilat 150 € komuna dhe 1,125 € hendek financiar)	1,275 € (nga të cilat 150 € komuna dhe 1,125 € hendek financiar)	1,275 € (nga të cilat 150 € komuna dhe 1,125 € hendek financiar)	ZK Donatorët	- 3 trajnime të realizuara (1 në vit) -60 persona të trajnuar (20 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, profesionit, etj.	KBGJ GG
1.2.12. Përdorimi i gjuhës së ndjeshme gjinore në dokumentet dhe politikat e komunës.	Të gjitha drejtoritë përgjegjëse	NJKP NJDNJBGJ	2024 - 2026	9,240 € (komuna)	18,480 € (komuna)	18,480 € (komuna)	Drejtoritë komunale	- Dokumentet dhe publikimet e komunës përgatiten me gjuhë të ndjeshme gjinore	KBGJ GG
1.2.13. Sesione informuese mbi raportimin e ndjeshëm gjinor.	ZI	NJDNJBGJ OJQ Mediat lokale	2024 - 2026	1,025 € (nga të cilat 150 € komuna dhe 875 € hendek financiar)	1,025 € (nga të cilat 150 € komuna dhe 875 € hendek financiar)	1,025 € (nga të cilat 150 € komuna dhe 875 € hendek financiar)	Drejtoritë komunale	- 3 sesione të zhvilluara (1 në vit)	KBGJ GG

[30] Komuna duhet ta planifikojë këtë shtim të dy zyrtareve në KAB 2025-2027
[31] Njëlloj si më sipër

		ON						- 30 persona të informuar (10 në vit)	

OBJEKTIVI STRATEGJIK:	**2. PROMOVIMI I SHËNDETIT DHE TË DREJTAVE SEKSUALE DHE RIPRODHUESE.**
Rezultatet e pritshme:	2.a. Edukimi mbi shëndetin seksual e riprodhues mes profesionisteve/profesionistëve dhe në komunitet, merr rëndësi të veçantë. 2.b. Vendimmarrja tek vajzat, djemtë, të rejat, të rinjtë, gratë dhe burrat për shëndetin seksual e riprodhues, e përmirësuar ndjeshëm.
Referenca në dokumentet kryesore:	- Ligji Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore, nenet 2,4, 5, 6, 11 dhe 12. - Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore 2020 – 2024, objektivi strategjik 2, objektivi specifik 2.3. - Plani i Zbatimit në Nivel Vendi për Kosovën i Planit të Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III (EU GAP III) 2021-2025, fusha tematike 2, objektivat specifike 2.1 dhe 2.2. - Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) – nenet 2, 3, 4, 5 dhe 12. - Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) – nenet 4 dhe 6. - Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA), fusha kritike 3 - Agjenda 2030, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) 2030, SDG 3, target 3.7 dhe 3.8, treguesit 3.7.1 dhe 3.8.1; SDG 5, target 5.6, treguesi 5.6.1 - Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE-së 2021 – 2025 (EU GAP III), fushat tematike 2 dhe 3. - Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, nenet 6, 10, 14, 34 dhe 37.
Objektivi specifik:	***2.1. Rritja e qasjes së grave, të rejave, e vajzave si dhe burrave, të rinjve e djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime cilësore shëndetësore dhe të shëndetit seksual e riprodhues.***

Treguesi	**Vlera bazë (2024)**	**Synimi i vitit të fundit (2026)**	**Rezultati**
2.1.a. Numri i grave, të rejave, vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, me akses të shtuar në kujdesin dhe shërbimet shëndetësore seksuale dhe riprodhuese.	Do përcaktohet	Rritur me 6%	Më shumë informacion mbi të drejtat dhe shëndetin, si dhe shëndetin seksual e riprodhues, veçanërisht tek gratë, të rejat dhe vajzat, në të gjithë diversitetin e tyre.

AKTIVITETET	**ZBATIMI**		**AFATI KOHOR**	**KOSTO (€)**			**BURIMI I FINANCIMIT**	**TREGUESIT**	**MONITORIMI**
	Drejtoria / zyra përgjegjëse	**Drejtoritë/ institucionet mbështetëse**		**2024**	**2025**	**2026**			
2.1.1. Sesione informuese me gratë, të rejat, vajzat dhe burrat, të rinjtë, djemtë, mbi të drejtat e tyre dhe	Drejtoria e Shëndetësisë (DSH)	Qendra Kryesore e Mjekësisë	2024 - 2026	1,440 € (komuna)	1,440 € (komuna)	1,440 € (komuna)	DSH Donatorët	- 6 takime të zhvilluara (2 në vit)	KBGJ GG

kujdesin për shëndetin seksual e riprodhues.		Familjare (QKMF) DKA OJQ ON						- 120 persona të informuar (40 në vit) ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.	
2.1.2. Aktivitete informuese në kuadër të fushatës "Tetori rozë".	DSH	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKSHP) QKMF NJDNJBGJ OJQ ON	2024 - 2026	1,120 € (nga të cilat 620 € komuna dhe 500 € donatori)	1,120 € (nga të cilat 620 € komuna dhe 500 € donatori)	1,120 € (nga të cilat 620 € komuna dhe 500 € donatori)	DSH Donatorët	- 9 takime të zhvilluara (3 në vit) - Numri i persona të informuar (në vit) ndarë sipas moshës, etnisë, etj.	KBGJ GG
2.1.3. Vazhdimi i kujdesit për nënat dhe foshnjat përmes vizitave në familje.	DSH	QKMF	2024 - 2026	40,000 € (komuna)	40,000 € (komuna)	40,000 € (komuna)	DSH	- 12000 vizita të zhvilluara (4000 në vit)	KBGJ GG
2.1.4. Aktivitete informuese për kancerin e qafës së mitrës, sidomos me gratë dhe të rejat në zonat rurale.	DSH	QKMF OJQ ON	2024 - 2026	1,580 € (nga të cilat 1,080 € komuna dhe 500 € hendek financiar)	1,580 € (nga të cilat 1,080 € komuna dhe 500 € hendek financiar)	1,580 € (nga të cilat 1,080 € komuna dhe 500 € hendek financiar)	DSH Donatorët	- 12 sesione të zhvilluara (4 në vit) - 120 gra të informuara (40 në vit), ndarë sipas moshës, etnisë, etj.	KBGJ GG

2.1.5. Sesione informuese me prindërit (nëna dhe baballarë) dhe vajzat për rëndësinë e kryerjes së vaksinës kundër HPV	DSH	QKMF OJQ ON	2024 - 2026	690 € (komuna)	690 € (komuna)	690 € (komuna)	DSH Donatorët	- 6 sesione të zhvilluara (2 në vit) - 150 persona të informuar (50 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj.	KBGJ GG
2.1.6. Kryerja e mamografisë falas për gratë dhe të rejat, përgjatë gjithë vitit	DSH	QKMF	2024 - 2026	1,250 € (komuna)	1,250 € (komuna)	1,250 € (komuna)	DSH	- Numri i mamografive të kryera çdo vit falas (250 në vit)	KBGJ GG
2.1.7. Avokimi për sponsorizimin dhe shpërndarjen e pecetave higjienike falas në shkolla.	DSH DPMS	OJQ ON	2024 - 2026	235 € (komuna)	Do përllogaritet	Do përllogaritet	DSH Donatorët	- 1 takim me 15 persona për të avokuar për këtë qëllim (2024). - Shpërndarja të mundësohet nga bashkëpunimi me biznese dhe OJQ e ON (2025 dhe 2026)	KBGJ GG
2.1.8. Mbështetja financiare për të sëmurat/sëmurët me sëmundje malinje.	DSH	ZK	2024 - 2026	Përllogaritet në bazë të kërkesave dhe mbulohet kosto 400 € për person.	Përllogaritet në bazë të kërkesave dhe mbulohet kosto 400 € për person.	Përllogaritet në bazë të kërkesave dhe mbulohet kosto 400 € për person.	DSH	- Numri i personave që kanë nevojë për mbështetje çdo	KBGJ GG

								vit[32] (400 euro për person)	

OBJEKTIVI STRATEGJIK:	**3. PROMOVIMI I TË DREJTAVE EKONOMIKE, SOCIALE DHE TË PUNËSIMIT TË DENJË, SI DHE FUQIZIMI I VAJZAVE, TË REJAVE DHE GRAVE.**
Rezultatet e pritshme:	3.a. Pjesëmarrja e grave dhe të rejave në aplikimin dhe përfitimin e subvencioneve të komunës në lidhje me bujqësinë dhe zhvillimin ekonomik, e përmirësuar ndjeshëm. 3.b. Mbështetja e komunës me shërbime sociale cilësore e të ndjeshme gjinore, e rritur.
Referenca në dokumentet kryesore:	- Ligji Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore, nenet 1, 2, 4, 5, 6, 12, 15, 16, 17 dhe 18. - Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore 2020 – 2024, objektivi strategjik 1, objektivat specifike 1.1 dhe 1.2. - Plani i Zbatimit në Nivel Vendi për Kosovën i Planit të Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III (EU GAP III) 2021-2025, fusha tematike 3, objektivi specifikë 2, 3, 4, 5 dhe 6. - Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) – nenet 2, 3, 4, 5, 11, 13 dhe 14. - Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) – nenet 4 dhe 6. - Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA), fushat kritike 1 dhe 6 - Agjenda 2030, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) 2030, SDG 5, targets 5.1, 5.4 dhe 5.a, treguesit, 5.1.1, 5.4.1 dhe 5.a.1, SDG 8, targets 8.5 dhe 8.6, treguesit 8.5.2 dhe 8.6.1. - Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE-së 2021 – 2025 (EU GAP III), fusha tematike 3. - Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, nenet 10, 11, 15, 18, 27, 31, 34 dhe 35.
Objektivi specifik:	***3.1. Rritja e qasjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik të tyre.***

Treguesi	**Vlera bazë (2024)**	**Synimi i vitit të fundit (2026)**	**Rezultati**
3.1.a. Numri i grave / të rejave fermere e në ndërmarrësi, përfituese të granteve dhe subvencioneve të Komunës	Do përcaktohet	Rritur me 10%	Më shumë gra e të reja të angazhuara si fermere e në ndërmarrësi do të kenë qasje në informacione burime dhe do të përfitojnë nga grantet dhe subvencionet e komunës.

AKTIVITETET	**ZBATIMI**		**AFATI KOHOR**	**KOSTO (€)**			**BURIMI I FINANCIMIT**	**TREGUESIT**	**MONITORIMI**
	Drejtoria / zyra përgjegjëse	**Drejtoritë/ institucionet mbështetëse**		**2024**	**2025**	**2026**			

[32] Komuna do përllogarisë dhe raportojë çdo vit numrin e personave që u është mbuluar kjo pagesë, duke bërë ndarjen e të dhënave sipas seksit, moshës, etnisë, etj.

- **Shërbime tregtare:** Zyre administrative, shërbime hotelierike, salla për ekspozim, hapësira për inkubator, qendra për konferencë, shitje të karburantit;
- **Shërbime argëtuese dhe infrastrukturë sportive.**

Kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për Zonat Industriale (ZI)

KUSHTET ZHVILLIMORE& NDËRTIMORE	**ZONA**		**Simboli**
	ZONË INDUSTRIALE E LEHTË		**ZI**
Dimensionet e parcelave	Sipërfaqja e parcelës (Min.)		**1500 m2**
	Sipërfaqja e parcelës (Maks.)		/
	Gjerësia e parcelës (Min.)		**40 m**
Vijat	Vija rregulluese		**Përcaktohet me vendosjen e profilit të rrugës**
	Vija ndërtimore e përparme	VN	**Min. 10m pavarësisht nga profili i**
	Vija ndërtimore anësore-djathtas/ majtas	VN	**Min. 1H** ***H paraqet lartësinë e objektitmë të lartë fqinj**
	Vija ndërtimore e pasme	VN	**Min. 1H** ***H paraqet lartësinë e objektitmë të lartë fqinj**
Lartësia	Etazhiteti		**2**
	Lartësia e objektit (maks.)		**15 m**
	Lartësia e strukturës dytësore (maks.)		**5 m**
	Raporti (përgjatë rrugës publike)		**1,5 L / 1 GJ**
	Raporti (anash)		**0.5 L / 1 GJ**
	Raporti (prapa)		**0.5 L / 1 GJ**
Intensiteti	ISHPKZh		**Maks. 50 %** **Për Parkun Industrial Maks. 70%**
	ISN		**Maks. 1.0** **Për Parkun Industrial Maks. 1.2**
	SGJAP		**30-50 %**
	SGJP		**15-30%**
	SAP		**15-20%**

Vend parkime	**Kërkesat minimale për vend parkime në përputhje me NTPH. Industria dhezanatet:** **Ndërtesat e industrive 1 VP/ 100 m²** **Ndërtesat e zanateve 2 VP/ 100 m²** **Ndërtesat e industrive 1 VP/ 100 m²** **Për shfrytëzime tjera, të sigurohen vende parkimi sipas kërkesave të NTPH. Vendparkimet mund të vendosen në tamponin gjelbërues të përparmë.**
Formësimi arkitektonik dhe estetik	**Arkitektura e këtyre objekteve që përfshihen në këto zona të lartpërmendura duhet të jetë arkitekturë bashkëkohore. Me qëllim të sigurojnë kushte sa më të mira për këto zona, duke krijuar/ruajtur një identitet dhe karakter te veçantë dhe origjinal urban dhe arkitektonik, duhet të hartohen zgjidhje urbane dhe arkitektonike në kuadër të blloqeve të ndërtimit edhe në këto zona.** **Në mënyrë që të pengohet ndotja potenciale e mjedisit përreth zonës industriale, duhet të formohet një bufer zonë e gjelbër me gjerësi 10 metra nga vija rregulluese.**
Përjashtime	**Për parcelat më të vogla se 1000 m2, lejohet ndërtimi i objekteve me shfrytëzim tregtar/prodhues. Për ndërtimin e objekteve me shfrytëzim deponim/distribuim, parcela duhet të jetë min. 2000 m2. Nuk lejohen ndryshimi i sipërfaqes totale të parcelave kadastrale nëpërmjet kërkesave për ndarje fizike të reja (pas miratimit të HZKP) të parcelave kadastrale zhvillimore më të vogla se 1000 m2.** **Për parcelat të cilat para implementimit të riparcelizimit kanë përmbushur kushtet (parcela minimale) për zhvillim të industrisë së lehtë, ky lloj zhvillimi iu lejohet edhe në sipërfaqet e ndarjeve të reja të parcelave, duke i respektuar distancat dhe të gjitha parametrat e tjera konform NTPH. Këto përjashtime zbatohen vetëm atëherë kur përmbushen kriteret e përcaktuara me nenin 37 të UA nr.24/2015.**

***Duhet të theksohet se pas hartimit të Hartës së Riparcelimit Gjerësia e parcelës (Min.) duhet të bazohet / merret nga pjesën hartografike ashtu siç është paraparë me riparcelim.*



Harta 1 Shfrytëzimi Aktual i Tokës

1.5. Shqyrtimi i përgjithshëm i Planeve Rregulluese paraprake që vlejnë për sipërfaqen që mbulohen me planin aktuale

Para hartimit të planit aktual rregullues për zonën e Parkut të Biznesit, nuk ka pasur një plan rregullues gjithëpërfshirës për këtë zonë specifike. Mungesa e nismave paraprake të planifikimit rregullator për këtë fushë ka bërë të nevojshme zhvillimin e një kuadri rregullator të detajuar për të udhëhequr në mënyrë efektive zhvillimin urban dhe infrastrukturën e ardhshme në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ. Ky plan rregullues përpiqet të adresojë nevojën ekzistuese për një qasje të strukturuar dhe të qëndrueshme ndaj zhvillimit dhe menaxhimit të zonës së Parkut të Biznesit.

1.6. Ndryshimet dhe plotësimet e mundshme të Hartës Zonale Komunale

Komuna e Prizrenit ka të aprovuar Hartën Zonale të Komunës, andaj destinimi, shfrytëzimet dhe kushtet zhvillimore dhe ndërtimore janë adekuate me të cilat mund të planifikojmë Planin Rregullues të Hollësishëm të Zonës së veçantë “Parku i Biznesit” në Prizren.

2. SIPËRFAQJA E PLANIFIKUAR

2.1. Kufijtë e sipërfaqes së planifikuar

Lokacioni i Parkut të Biznesit ndodhet në pjesën verilindore të qytetit të Prizrenit në lokacionin e ish-poligonit të shenjëtarisë që shtrihet në boshtin rrugor Lubizhdë – Korishë ne largësi 5 km prej qytetit. Parcelat e dedikuara për Parkun e Biznesit sipas vendimit me numër 01/011-4267 të datës 17 Korrik 2008 të Kuvendit të Komunës së Prizrenit janë ngastrat me numra: 248/1, 248/2, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 255, 256, 260', 261, 262, 263, 264, 266, 267, 268, 269, 407 (1407), 418 (1418), dhe 451 (1451).

Sipërfaqja totale e parcelave sipas çertifikatave të pronësisë del të jetë përafërsisht rreth 43ha.



Figura 1 Parcelat Inicuese

Siç shihet nga vizatimi parcelat e parapara nuk janë të lidhura në mes vete dhe si të tilla nuk ka qenë e mundur të përdoren si sipërfaqe për zhvillimin e Parkut të Biznesit.

Për këtë arsye si dhe për arsye të funksionalizimit dhe formësimit sa më të mirë të Parkut të Biznesit nga Komuna (Departamenti i Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor) është kërkuar që të bëhet lidhja fizike e këtyre parcelave përmes inkorporimit të parcelave fqinje në Parkun e Biznesit.

2.2. Parcelat kadastrale brenda sipërfaqes së planifikuar dhe pronësia

Sipërfaqja e planifikuar e Planit Rregullues të Hollësishëm Zona e Veçantë "Parku i Biznesit" - Prizren shtrihet brenda zonës kadastrale Prizren dhe përbëhet prej një numër 22 të parcelave inicuese prej nga shihet se të gjitha janë pronë e Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore, në përjashtim të parcelës me nr.253 e cila është e paidentifikuar.

PARCELAT INICUESE			
Nr.	**Numri i Parcelës**	**Pronari**	**Sipërfaqja sipas Certifikatës së Pronësisë m^2**
1	P-71813046-00248-1	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	227.00
2	P-71813046-00248-2	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	273.00
3	P-71813046-00249-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	5,800.00
4	P-71813046-00250-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	2,625.00
5	P-71813046-00251-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	4,693.20
6	P-71813046-00252-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	10,280.00
7	P-71813046-00253-0	Pronar Republika e Kosoves - shfrytezues Komuna e Prizrenit	2,011.90
8	P-71813046-00254-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	4,210.00
9	P-71813046-00255-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	16,000.00
10	P-71813046-00256-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	18,210.00
12	P-71813046-00261-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	5,276.00
13	P-71813046-00262-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	4,520.00
14	P-71813046-00263-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	3,027.00
15	P-71813046-00264-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	3,942.00
16	P-71813046-00266-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	7,234.00
17	P-71813046-00267-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	9,935.00
18	P-71813046-00268-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	10,513.00
19	P-71813046-00269-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	9,406.00
20	P-71813046-01407-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	6,834.00
21	P-71813046-01418-0	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	63,685.00
22	P-71813046-01451-1	Sekretariati Federativ për Mbrojtje Populllore	219,044.00
		Totali	**407,746.10**

Tabela 1 Parcelat inicuese në zonën e veçantë "Parku i Biznesit" - Prizren



Harta 2 Parcelat Kadastrale

2.2.1. Zgjerimi i kufijve dhe e parcelat e shtuara

Nevoja e lidhjes së parcelave të dhëna me kontratë, me qëllim të arritjes së një zgjidhjeje më funksionale urbanistike çon deri te shtimi i paevitueshëm i parcelave te reja.

Në Figurën e mëposhtme shihen parcelat e shtuara me numër të ngastrave:



Figura 2 Parcelat e shtuara

253, 257, 259, 265, 1393, 1404, 1405, 1406, 1409, 1411, 1412, 1413, 1414, 1426, 1431, 1435, 1436, 1437, 1438, 1440, 1441, 1442, 1443, 1444, 1445, 1446, 1447, 1448, 1449, 1450, 1452, 1454, 1455, 1456, 456, 1461, 1462, 1463, 1464, 1466, 2185, 1408/1, 1408/2, 1429/1, 1439/1, 1451/3, 1451/4, 1451/5, 258/1, 258/2, 3339/1, dhe 3339/2.

Arsye tjetër e cila detyron zgjerimin e kufinjëve te Parkut të Biznesit rrjedh edhe nga topografia e lokacionit, ku rreth 60% e parcelave kanë pjerrtësi rreth 26.8 % çka pamundëson shtrirjen dhe përmbushjen e kërkesave sipas detyrës projektuese.

Kjo dhe nevoja e lidhjes së parcelave inicuese ka si rezultat shtimin e parcelave fqinje të cilat shihen në figurën e mësipërme si dhe të detajuara janë dhënë edhe në tabelën e mëposhtme.

PARCELAT E SHTUARA			
PRONAT E KOMUNES			
Nr.	**Nr. parcelës**	**Pronari**	**Sipërfaqja sipas Certifikatës së Pronësisë m²**
1	P-71813046-00260-0	S F. Për Mbrojtje Popullore	20,159.00
	P-71813046-01416-0	Sipas certifikatës së pronësisë del se të gjitha këto parcela i takojnë parcelës me nr. 1418	
	P-71813046-01417-0		
	P-71813046-01419-0		

	P-71813046-01420-0		
	P-71813046-01421-0		
	P-71813046-01422-0		
	P-71813046-01423-0		
	P-71813046-01424-0		
	P-71813046-01425-0		
	258-1	Pronar Republika e Kosoves - shfrytezues Komuna e Prizrenit	
	258-2		
	259-0		
2	P-71813037-03340-0	Pasuria Shoqërore K.K.Prizren	
			PRONAT PRIVATE
3	P-71813046-00265-0	Antiq Marko (Krste)	7,348.00
		ONI. UD. PPK. PROGRES	
4	P-71813046-01393-0	Mojsiq Stana (UD. Xhorxha)	3,984.00
		Mojsiq Dobrivoje (Xhorxha)	
		Mojsiq Bozhidar (Xhorxha)	
5	P-71813046-01405-0	Mojsiq Stana (UD. Xhorxha)	3,403.00
		Mojsiq Dobrivoje (Xhorxha)	
		Mojsiq Bozhidar (Xhorxha)	
6	P-71813046-01426-0	Mishkoviq Stanko (Stojana)	3,115.00
7	P-71813046-01429-1	Tarbanqe Asan (Vejap)	15,936.00
8	P-71813046-01435-0	Ademi Kasëm (Dila)	847.00
9	P-71813046-01436-0	Ademi Ajvaz (Ramo)	1,645.00
		Ademi Ramiz (Ramo)	
10	P-71813046-01437-0	Ademi Rexhep (Bajram)	2,019.00
11	P-71813046-01439-1	Ramadani Jusuf (Latif)	7,686.00
		Ramadani Amit (Latif)	
		Ramadani Farush (Latif)	
		Ramadani Rexhep (Latif)	
12	P-71813046-01440-0	Todosiq Dima (Bogdana)	3,041.00
13	P-71813046-01441-0	Todosiq Stevanka (Vasila)	3,464.00
		Todosiq Susa (UD. Vasila)	
14	P-71813046-01451-5	Mojsiq Stana (UD. Xhorxha)	3,181.00
		Mojsiq Dobrivoje (Xhorxha)	
		Mojsiq Bozhidar (Xhorxha)	
15	P-71813046-01462-0	Jusufi Vajdin (Sejbit)	1,991.00
		Jusufi Zeqir (Sejbit)	
16	P-71813046-01463-0	Zdravkoviq Çedomir (Filip)	1,892.00
		Zdravkoviq Mladen (Dragutin)	
		Zdravkoviq Zhivorad (Cvetko)	
17	P-71813046-01464-0	Elezi Hasan (Eleza)	2,691.00
		Elezi Sherif (Elez)	
		Elezi Asim (Aslana)	
		Elezi Medija (E veja e Bajramit)	
18	P-71813046-01465-0	Elezi Hasan (Eleza)	2,242.00
		Elezi Sherif (Elez)	
		Elezi Asim (Aslana)	
		Elezi Medija (E veja e Bajramit)	

19	P-71813046-01466-0	Elezi Hasan (Eleza)	4,983.00
		Elezi Sherif (Elez)	
		Elezi Asim (Aslana)	
		Elezi Medija (E veja e Bajramit)	
20	P-71813037-03339-2	Abdullah Hoxha	6,500.00
21	P-71813037-01450-0	Kukaj Rexha (Balja)	20,033.00
22		Ahmetaj Veselj (Shabana)	5,845.00
23	P-71813037-01454-0	Ahmetaj Musli (Shabana)	6,509.00
24	P-71813037-01455-0	Ahmetaj Rustem (Shabana)	8,477.00
25	P-71813037-01456-0	Kukaj Nuhi (Qerima)	22,700.00
PRONAT E "PROGRES"it			
26	P-71813046-01404-0	P. SH. KBI. PROGRES - Prizren	7,035.00
27	P-71813046-01411-0	P. SH. KBI. PROGRES - Prizren	4,707.00
28	P-71813046-01412-0	P. SH. KBI. PROGRES - Prizren	4,833.00
29	P-71813037-03339-1	D.S.Preh.Industrijski Kome PROGRES Prizren	37,162.00
PRONAT PUBLIKE			
11	P-71813046-00257-0	Pasuri Shoqerore - Rruge	1,020.00
32	P-71813046-01409-0	Pasuri Shoqerore - Rruge	3,935.00
35	P-71813046-01413-0	Pasuri Shoqerore - Rruge	4,330.00
49	P-71813046-01431-0	Pasuri Shoqerore - Rruge	2,318.00
53	P-71813046-01438-0	Pasuri Shoqerore - Ujerat	5,857.00
71	P-71813046-01461-0	Pasuri Shoqerore - Ujerat	2,442.00
77	P-71813046-02185-0	Pasuri Shoqerore - Ujerat	25,391.00

Tabela 2 Pronësia e parcelave të shtuara

Në tabelën e sipërme janë dhënë parcelat dhe pronësia e tyre të cilat do të futen në kuadër të Planit rregullues Parku i Biznesit.



Harta 3 Pronësia e parcelat kadastrale të përfshira në zonën e veçantë "Parku i Biznesit" – Prizren

2.3. Aprovimi i Kufijve Përfundimtarë

Ansamblea Komunale e Kuvendit Komunal të Prizrenit pas propozimit qe i është bërë si arsyeve të paraqitura dhe nevojës për një sipërfaqe më të madhe për Park Biznesi nga konsultat me grupin e ekspertëve dhe shoqatës së Afaristëve, mori vendim për aprovimin e zgjerimit të kufijve.

Sipërfaqja në të cilën do të hartohet Plani rregullues Parku i Biznesit tani përfshinë sipërfaqe prej 80.33 ha.

TË DHËNAT E PARCELAVE				
Njësia kadastrale	**Lloji i pronës**	**Sipërfaqja**	**Pronari/Poseduesi**	**Pjesa e pronës**
P-71813037-03151-0	Pronë private	601 m²	BALJAJ ALJI (QAMILJA)	1/1
P-71813046-01463-0	Pronë private	1,892m²	Pirkovic Ljiljana (Mladen)	210/1892
P-71813046-01463-0	Pronë private	1,892m²	Pirkovic Zoran (Mladen)	210/1892
P-71813046-01463-0	Pronë private	1,892m²	Pirkovic Dragutin (Milan)	70/1892
P-71813046-01463-0	Pronë private	1,892m²	Pirkovic Blagoje (Milan)	70/1892
P-71813046-01463-0	Pronë private	1,892m²	Pirkovic Danijela (Milan)	70/1892
P-71813046-01463-0	Pronë private	1,892m²	Zdravkoviq Çedomir(Filip)	1/3
P-71813046-01463-0	Pronë private	1,892m²	Zdravkoviq Zhivorad (Cvetko)	1/3
P-71813046-00257-0	Pronë shoqërore	1,020m²	Pasuria Shoqërore-Rrugët	1/1
P-71813046-00256-0	Pronë shtetërore	18,210m²	Republika e Kosovës	1/1
P-71813046-00265-0	Pronë shoqërore	7,348m²	ONI.UD.PPK.PROGRES	2/3
P-71813046-00265-0	Pronë shoqërore	7,348m²	Kabashi Dukagjin (Murat)	1/3
P-71813046-00264-0	Pronë shtetërore	3,942m²	Republika e Kosovës	1/1
P-71813046-00263-0	Pronë shtetërore	3,027m²	Republika e Kosovës	1/1

P-71813046-00260-0	Pronë shtetërore	20,159m²	Republika e Kosovës	1/1
P-71813046-00266-0	Pronë shtetërore	7,234m²	Republika e Kosovës	1/1
P-71813046-01411-0	Pronë shoqërore	4,707m²	P.SH.KBI.PROGRES-PRIZREN	1/1
P-71813046-01412-0	Pronë shoqërore	4,833m²	P.SH.KBI.PROGRES-PRIZREN	1/1
P-71813046-01413-0	Pronë shoqërore	4,330m²	Pasuria Shoqërore-Rrugët	1/1
P-71813046-00267-0	Pronë shtetërore	9,935m²	Republika e Kosovës	1/1
P-71813046-00269-0	Pronë shtetërore	9,406m²	Republika e Kosovës	1/1
P-71813046-00262-0	Pronë shtetërore	4,520m²	Republika e Kosovës	1/1
P-71813046-00261-0	Pronë shtetërore	5,276m²	Republika e Kosovës	1/1
P-71813037-03149-0	Pronë private	2,878m²	Rexhaj Ajete (Rakip)	1/4
P-71813037-03149-0	Pronë private	2,878m²	Rexhaj Selim (Bislim)	1/4
P-71813037-03149-0	Pronë private	2,878m²	Rexhaj Ibrahim (Bislim)	1/4
P-71813037-03149-0	Pronë private	2,878m²	Rexhaj Zejnel (Bislim)	1/4
P-71813037-03150-0	Pronë private	4,712m²	Rexhaj Bislim (Selima)	1/1
P-71813037-03235-0	Pronë private	3,844m²	Dullaj Sakibe (Ibrahim)	1/1
P-71813037-03234-0	Pronë private	3,537m²	Dullaj Sakibe (Ibrahim)	1/1
P-71813037-03233-0	Pronë private	2,386m²	Simiq Lazar (Trifun)	1/3
P-71813037-03233-0	Pronë private	2,386m²	Simiq Gjorgje (Trifun)	1/3
P-71813037-03233-0	Pronë private	2,386m²	Simiç Petar (Trifun)	1/3
P-71813037-03152-0	Pronë private	1,148m²	Balaj Ramiz (Sadri)	3/4
P-71813037-03152-0	Pronë private	1,148m²	Balaj Salajdin (Sadri)	1/4
P-71813037-03245-0	Pronë private	1,739m²	Rexhaj Hamdi (Bajram)	1/1
P-71813037-03244-0	Pronë private	7,830m²	EPARHISKI UPRAVNI ODBOR PRAVOSLAVNE EPARHIJE RASKER PRIZRENSKA	1/1
P-71813037-03242-0	Pronë private	1,745m²	Rexhaj Veli (Hazir)	1/1
P-71813046-01405-0	Pronë private	3,403m²	Destani Imri (Memet)	1/2
P-71813046-01405-0	Pronë private	3,403m²	Destan Refki (Memet)	1/2
P-71813046-01407-0	Pronë shtetërore	6,834m²	Republika e Kosovës	1/1
P-71813046-01409-0	Pronë shoqërore	3,935m²	Pasuria Shoqërore-Rrugët	1/1
P-71813046-01429-1	Pronë private	15,936m²	Lezi Sejdi (Fazli)	1/1
P-71813046-01418-0	Pronë shtetërore	63,685m²	Republika e Kosovës	1/1
P-71813046-01426-0	Pronë private	3,115m²	Lezi Sejdi (Fazli)	1/1
P-71813046-01393-0	Pronë private	3,984m²	Destani Imri (Memet)	1/2
P-71813046-01393-0	Pronë private	3,984m²	Destan Refki (Memet)	1/2
P-71813046-01404-0	Pronë shoqërore	7,035m²	P.SH.KBI.PROGRES-PRIZREN	1/1
P-71813046-01440-1	Pronë private	1,041m²	Fatmir Godeni B.I.	1/1
P-71813046-01440-2	Pronë private	2,000m²	Arapi Muhamet (Sylejman)	1/1
P-71813046-01441-0	Pronë private	3,464m²	Todosiq Stevanka (Vasila)	1/2
P-71813046-01441-0	Pronë private	3,464m²	Todosiq Susa (Ud.Vasila)	1/2
P-71813046-01431-0	Pronë shoqërore	2,318m²	Pasuria Shoqërore-Rrugët	1/1
P-71813046-01438-0	Pronë shoqërore	5,857m²	P.SH.UJËRAT	1/1
P-71813046-01435-0	Pronë private	1,161m²	Ademi Kasëm (Dila)	1/1
P-71813046-01436-0	Pronë private	1,645m²	Ademi Ramiz (Ramo)	1/2
P-71813046-01436-0	Pronë private	1,645m²	Ademi Ajvaz (Ramo)	1/2
P-71813046-01437-0	Pronë private	2,019m²	Ademi Rexhep (Bajram)	1/1
P-71813046-01465-0	Pronë private	2,242m²	Elezi Hasan (Eleza)	1/4
P-71813046-01465-0	Pronë private	2,242m²	Elezi Asim (Aslana)	1/4
P-71813046-01465-0	Pronë private	2,242m²	Halimi Sherif (Sadik)	1/4

P-71813046-01465-0	Pronë private	2,242m²	Elezi Dino (Bajram)	1/8
P-71813046-01465-0	Pronë private	2,242m²	Elezi Ekrem (Bajram)	1/8
P-71813046-01466-0	Pronë private	4,983m²	Elezi Hasan (Eleza)	1/4
P-71813046-01466-0	Pronë private	4,983m²	Elezi Asim (Aslana)	1/4
P-71813046-01466-0	Pronë private	4,983m²	Halimi Sherif (Sadik)	1/4
P-71813046-01466-0	Pronë private	4,983m²	Elezi Dino (Bajram)	1/8
P-71813046-01466-0	Pronë private	4,983m²	Elezi Ekrem (Bajram)	1/8
P-71813046-01439-1	Pronë private	7,686m²	Ramadani Adnan (Zeim)	1/24
P-71813046-01439-1	Pronë private	7,686m²	Ramadani Bujar (Jusuf)	1/8
P-71813046-01439-1	Pronë private	7,686m²	Ramadani Naim (Jusuf)	1/8
P-71813046-01439-1	Pronë private	7,686m²	Ramadani Shkelzen (Sulejman)	1/64
P-71813046-01439-1	Pronë private	7,686m²	Ramadani Merlind (Sulejman)	1/64
P-71813046-01439-1	Pronë private	7,686m²	Ramadani Vllaznim (Sulejman)	1/64
P-71813046-01439-1	Pronë private	7,686m²	Ramadani Gzim (Mustafa)	1/96
P-71813046-01439-1	Pronë private	7,686m²	Ramadani Gazmend (Mustafa)	1/96
P-71813046-01439-1	Pronë private	7,686m²	Ramadani Mentor (Mustafa)	1/96
P-71813046-01439-1	Pronë private	7,686m²	Ramadani Ylber (Mustafa)	1/96
P-71813046-01439-1	Pronë private	7,686m²	Ramadani Adrian (Mustafa)	1/96
P-71813046-01439-1	Pronë private	7,686m²	Ramadani Blerim (Qerim)	1/32
P-71813046-01439-1	Pronë private	7,686m²	Ramadani Besim (Qerim)	1/32
P-71813046-01439-1	Pronë private	7,686m²	Ramadani Bashkim (Sulejman)	1/64
P-71813046-01439-1	Pronë private	7,686m²	Ramadani Urim (Mustafa)	1/96
P-71813046-01439-1	Pronë private	7,686m²	Ramadani Ramit (Salija)	1/32
P-71813046-01439-1	Pronë private	7,686m²	Ramadani Flamur (Salih)	1/32
P-71813046-01439-1	Pronë private	7,686m²	Ramadani Irmin (Ibrahim)	1/36
P-71813046-01439-1	Pronë private	7,686m²	Ramadani Vetim (Ibrahim)	1/36
P-71813046-01439-1	Pronë private	7,686m²	Ramadani Burim (Ibrahim)	1/36
P-71813046-01439-1	Pronë private	7,686m²	Ramadani Zemir (Liman)	1/12
P-71813046-01439-1	Pronë private	7,686m²	Ramadani Rezak (Zeim)	1/24
P-71813046-01439-1	Pronë private	7,686m²	Ramadani Remzi (Rexhep)	1/8
P-71813046-01439-1	Pronë private	7,686m²	Ramadani Arsim (Rexhep)	1/8
P-71813046-01451-5	Pronë private	3,181m²	Kijaqiq Gospogjinka (Bozhidar)	3/30
P-71813046-01451-5	Pronë private	3,181m²	Nekiq Verica	3/30
P-71813046-01451-5	Pronë private	3,181m²	Mojsiç Dushko (Dimitrije)	1/30
P-71813046-01451-5	Pronë private	3,181m²	Mojsiç Srdan (Slobodan)	3/30
P-71813046-01451-5	Pronë private	3,181m²	Petkoviq Nadica (Dimitrije)	1/30
P-71813046-01451-5	Pronë private	3,181m²	Mojsiq Svetlana (Dimitrije)	1/30
P-71813046-01451-5	Pronë private	3,181m²	Ramadani Naim (Jusuf)	3/30
P-71813046-01451-5	Pronë private	3,181m²	Velićković Biserka (Dobrivoje)	1/10
P-71813046-01451-5	Pronë private	3,181m²	Mojsiq Zhivorad (Dobrivoje)	1/10
P-71813046-01451-5	Pronë private	3,181m²	Mojsiq Zorka (Dobrivije)	1/10
P-71813046-01451-5	Pronë private	3,181m²	Mojsiq Radisalv (Dobrovoje)	1/10
P-71813046-01451-5	Pronë private	3,181m²	Mojsiq Radisalv (Dobrovoje)	1/10
P-71813046-01451-5	Pronë private	3,181m²	Mojsić Zoran (Dobrivoje)	1/10
P-71813046-01464-0	Pronë private	2,691m²	Elezi Hasan (Eleza)	1/4
P-71813046-01464-0	Pronë private	2,691m²	Elezi Asim (Aslana)	1/4
P-71813046-01464-0	Pronë private	2,691m²	Halimi Sherif (Sadik)	1/4
P-71813046-01464-0	Pronë private	2,691m²	Elezi Dino (Bajram)	1/8
P-71813046-01464-0	Pronë private	2,691m²	Elezi Ekrem (Bajram)	1/8

P-71813037-03248-0	Pronë private	4,852m²	Kabashi Bujar (Muharem)	1/3
P-71813037-03248-0	Pronë private	4,852m²	Kabashi Xhemal (Muharem)	1/3
P-71813037-03248-0	Pronë private	4,852m²	Kabashi Sami (Muharem)	1/3
P-71813037-03247-0	Pronë shoqërore	736m²	DRUSHTVENA SVOJINA JAVNI I NEKATEGORISANI PUTEVI	1/1
P-71813037-03251-0	Pronë private	8,205m²	Muqaj Rushit (Alije)	1/1
P-71813037-03253-0	Pronë private	4,479m²	Bobaj Sylejman (Rifat)	1/4
P-71813037-03253-0	Pronë private	4,479m²	Bobaj Tahir (Rifat)	1/4
P-71813037-03253-0	Pronë private	4,479m²	Bobaj Sadik (Rifat)	1/4
P-71813037-03253-0	Pronë private	4,479m²	Bobaj Feim (Rifat)	1/4
P-71813037-03257-0	Pronë private	4,000m²	Bobaj Tahir (Beqira)	1/1
P-71813037-03254-0	Pronë shoqërore	1,992m²	DRUSHTVENA SVOJINA JAVNI I NEKATEGORISANI PUTEVI	1/1
P-71813037-03256-2	Pronë private	1,000m²	ECO MASTER SH.P.K.	1/1
P-71813037-03255-0	Pronë shoqërore	1,375m²	DRUSHTVENA SVOJINA JAVNI I NEKATEGORISANI PUTEVI	1/1
P-71813037-03338-0	Pronë shoqërore	620m²	"Lavërtaria-Blegtoria" N.SH.Progres-Export	1/1
P-71813037-03339-2	/ /	6,500m²	Hoxha Abdullah	1/1
P-71813037-03340-0	Pronë shoqërore	197,569m²	Komuna e Prizrenit	1/1
P-71813046-01461-0	Pronë shoqërore	2,442m²	P.SH.UJËRAT	1/1
P-71813046-01462-0	Pronë private	1,991m²	Jusufi Vajdin (Sejbit)	1/2
P-71813046-01462-0	Pronë private	1,991m²	Jusufi Zeqir (Sejbit)	1/2
P-71813037-03339-1	/ /	37,162m²	D.S.PREH.INDUSTRIJSKI KOMB.PROGRES PRIZREN OS.OR.UD.RADA RATARSTVO DUSH.OB.LJUB	1/1
P-71813046-01460-0	Pronë private	718m²	Bajrami Berat (Sokol)	1/1
P-71813046-02185-0	Pronë shoqërore	25,391m²	P.SH.UJËRAT	1/1
P-71813046-01451-1	Pronë shtetërore	219,044m²	Republika e Kosovës	1/1
P-71813046-01455-0	Pronë shoqërore	5,541m²	P.SH.UJËRAT	1/1
P-71813046-01451-2	Pronë shoqërore	133,956m²	PASURIA SHOQËRORE-DOBRO SELO-	1/1
P-71813046-00248-2	Pronë shtetërore	273m²	Republika e Kosovës	1/1
P-71813046-00247-0	Pronë shoqërore	3,500m²	Zekaj Selim (Gani)	1/1
P-71813046-00249-0	Pronë shtetërore	5,800m²	Republika e Kosovës	1/1
P-71813046-00248-1	Pronë shtetërore	227m²	Republika e Kosovës	1/1
P-71813046-00252-0	Pronë shtetërore	10,280m²	Republika e Kosovës	1/1
P-71813046-00255-0	Pronë shtetërore	16,000m²	Republika e Kosovës	1/1
P-71813046-00254-0	Pronë shtetërore	4,210m²	Republika e Kosovës	1/1
P-71813046-00253-0	Pronë shtetërore	2,000m²	Republika e Kosovës	1/1
P-71813037-03246-0	Pronë shoqërore	3,379m²	P.SH.UJËRAT	1/1

Tabela 3 Pronësia e parcelave sipas të dhënave kadastrale

2.4. Gjendjen Ekzistuese për zonën e Veçantë “Parku i Biznesit”

2.4.1. Zona e Veçantë “Parku i Biznesit “ në raport me zonat kontaktuese

Lokacioni i përzgjedhur ofron kushte të mira për transport, si të atij publik ashtu edhe të atij privat, këmbësorëve dhe atij çiklistik. Si arterie kryesore është magjistralja Prishtinë – Prizren si dhe mundësia e lidhjes së ardhshme në autostradën Merdarë – Morinë – Durrës, e me këtë edhe mundësia e lidhjes me portin e Durrësit dhe të atij të Shëngjinit.



Harta 4 Pozita gjeografike e Parkut të Biznesit

2.4.2. Zona e Veçantë “Parku i Biznesit” në kontekst të ngushtë hapësinor

Parcela kufizohet ne pjesën veriperëndimore me magjistralen Prizren–Therandë , në pjesën jug-perëndimore me fshatin Lubizhdë, në pjesën verilindore me fshatin Korishë.



Harta 5 Parku i Biznesit në Kuptimin në kuptimin e ngushtë hapësinor

2.4.3. Inçizimi gjeodezik dhe struktura pejsazhore e lokacionit

Inçizimet gjeodezike për lokacionin e Parkut të Biznesit janë bërë nga kompania e kontraktuar "GEOLAND". Nga inçizimet del se diferenca ndërmjet izohipsës në pjesën më të rrafshët dhe asaj në pjesën më të lartë është 215 m. Izohipsa me kuotën më të ultë është 425 kurse ajo më e larta ka 640 m lartësi mbidetare.



Figura 3 Inçizimet Gjeodezike te lokacionit ekzistues



Harta 6 Prerjet karakteristike të terrenit

Nga incizimet del se lokacioni ka një pjerrtësi të konsiderueshme në 60% e prerjes gjatësore me një ramje 28.60%, ndërsa në 40% terreni ka ramje prej 6.9 % në drejtim veriperëndimor të lokacionit.

2.4.4. Infrastruktura Teknike dhe Rrugore

Si në mbarë Kosovën edhe në territorin e komunës së Prizrenit infrastruktura teknike e rrjedhimisht edhe shërbimet publike që lidhen me të nuk është në nivel të kënaqshëm të zhvillimit. Kjo çështje është problem sidomos sa i përket nivelit të zhvillimit të infrastrukturës ujore dhe për këtë arsye ka nevojë për përpjekje më të mëdha të shoqërisë, që ky problem të zgjidhet apo të zbutet. Problem është po ashtu furnizimi jo i mirë me energji elektrike ku rrjeti elektrik në disa pjesë është shumë i amortizuar, tensioni i dobët dhe ka reduktime të furnizimit. Gjithashtu edhe gjendje e rrjetit rrugor në këtë komunë nuk është ne nivelin më të mire të mundshëm.

Lokacioni në të cilin parashihet të zhvillohet Parku i Biznesit nuk përfshihet në infrastrukturën ekzistuese formale të qytetit. Përjashtim bën kablli optik i PTT i cili shtrihet përgjatë magjistrales.

2.4.4.1. Rrjeti i Ujësjellësit

Prizreni dhe fshatrat rreth tij furnizohen me ujë të pijshëm nga 4 burime kryesore dhe nga lumi "Lumëbardhi" nëpërmjet sistemit të filtrimit. Furnizimi me ujë i qytetit ndahet në zonën e ulët, ku 60% e sasisë së ujit transportohet me gravitet dhe zona e lartë ku 40% e ujit shpërndahet me anë të sistemit të pompave.

Rrjeti i ujësjellësit në Parkun e Biznesit është i rregulluar 50%.

Pjesa më e madhe e këtij rrjeti është shumë e vjetër dhe e amortizuar (është ndërtuar para 40 vjetëve) dhe për këtë arsye ka humbje të mëdha si në rrjetin kryesor ashtu edhe në atë sekondar. Këto humbje mendohet të jenë rreth 40% të sasisë së përgjithshme të ujit. Humbjet tjera janë edhe kyçjet ilegale të shumë subjekteve ekonomike.

Një ndër problemet më të mëdha në komunën e Prizrenit është problemi i shtrirjes së rrjetit të kanalizimit dhe derdhja e tyre.

Bazuar në informacionet nga KRU Hidroregjioni Jugor problemet kryesore në rrjetin e ujësjellësit janë:

- Gypat ekzistues janë në gjendje të keqe (gypat e gizës dhe te asbestqementos);
- Gypat me diametra shumë të vogla dhe jo adekuate për furnizim
- Lidhje të paligjshme dhe të panevojshme në sistem;
- Gypat te instaluar / vendosur me gradient të ulët, pa qasje për shkarkimin dhe pastrimin e rrjetit ekzistues;
- Pusetat ekzistues që ndodhen pjesërisht nën prona private / banesat / shtëpitë;
- Pusetat e Ujësjellësit për Ujëmatës, të valvulave, të shkarkimit etj., janë kryesisht te vjetërsuar dhe pa mirëmbajtje adekuate;
- Mirëmbajtje jo adekuate e sistemit te gypave te Ujësjellësit;
- Pusetat të hapura për shkak të kapakëve metalike, duke rrezikuar trafikun e njerëzve dhe automjeteve;
- Ne disa raste pusetat dhe valvulat me teleskop janë të padukshme pasi ato janë të mbuluara me asfalt ose thjesht me materiale të ndryshme (ne rrugët tokësore) dhe shume probleme te tjera;

Lokacioni në të cilin do të shtrihet Parku i Biznesit nuk përfshihet në rrjetin formal të ujësjellësit, dhe si rezultat i saj duhet të planifikohet shtrirja e rrjetit të ujësjellësit brenda zonës me standarde adekuate, të përballueshme për furnizim të qëndrueshëm me ujë zonën ekonomike.

2.4.4.2. Rrjeti i Kanalizimit Fekal dhe Atmosferik

Gjendja momentale me menaxhim të ujërave të zeza në territorin e komunës së Prizrenit është në gjendje jo të mirë, si rezultat i mungesës së rrjeteve adekuate për largimin dhe grumbullimin e ujërave të zeza.

Derdhja e ujërave të zeza në të shumtën e rasteve bëhet direkt në lumenj si rezultat i mungesës së impiantit për trajtimin e ujërave të zeza shtëpiake dhe ato industrial. Prandaj ndërtimi i impianteve duhet të jetë çështje e parë me rëndësi për mbrojtjen e ujërave nga ndotësit e ujërave të zeza që dalin nga vendbanimet dhe nga industria.

Lokacioni në të cilin do të shtrihet Parku i Biznesit nuk përfshihet në rrjetin formal të kanalizimit, andaj duhet të planifikohet impianti për trajtimin e ujërave të ndotura në këtë rast ujërave industrial, gjithashtu është e nevojshëm planifikimi dhe ndërtimi i kolektorëve për grumbullim të ujërave nga objektet deri tek impianti.

Rrjeti i kanalizimit fekal dhe atmosferik në Parkun Industrial është i rregulluar 50%.

Sa i përket rrjeteve të ujërave atmosferike në përgjithësi komuna e Prizrenit ka një përqindje të ulët të mbulueshmërisë më këtë infrastrukturë. Kryesisht ujërat atmosferik dhe fekale janë të përzier si rezultat i keq menaxhimit dhe kyçjeve ilegale. Zona e biznesit nuk posedon rrjet për largimin e ujërave atmosferik, si rezultat duhet të planifikohet dhe ndërtohet rrjeti i veçantë për menaxhimin dhe grumbullimin e ujërave atmosferik.

Infrastruktura e dobët e kanalizimit fekale dhe atmosferik ka nevojë për investime të reja si:

1. Ofrimi i shërbimeve me rrjet të kanalizimit për gjithë zonën e biznesit;
2. Eliminimi i pikave shkarkuese të ujërave të zeza;
3. Mundësia e ndërtimit të impiantit për trajtim të ujërave të zeza (industrial) dhe kolektorëve;
4. Shtrirja e rrjetit të kanalizimit Brenda zonës;
5. Mundësia e shtrirjes së rrjetit të kanalizimit atmosferik dhe ndarja e tyre nga ato fekale.

2.4.4.3. Rrjeti Elektroenergjetik dhe Telekomunikuese

Rrjeti energjik është i përfunduar dëri në një masë, rreth 50%, për arsye se akoma nuk dihet se cfarë bizneseve do të operojnë.

Gjendja e furnizim me energji elektrike është kryesisht e mirë dhe stabil. Furnizimi i konsumatorëve të qytetit të Prizrenit dhe fshatrave të kësaj komune bëhet nëpërmjet nënstacioneve elektrike ekzistuese te rrjetit transmetues te republikës se Kosovës.

KEK- PRISHTINË – Distribucioni në Prizren përfshin regjionin e Prizrenit me pesë komuna me rreth 76861 konsumatorë dhe për nga madhësia zë vendin e dytë në kuadër të distribucioneve të Kosovës. Konsumatorët e konsumit të KEK-Prishtine, distribucioni Prizren furnizohen me energji elektrike përmes tri TS 110/X kV me 189 MV A fuqi të gjithmbarshme të instaluar.

1. TS 110/35 kV Prizreni i është në punë nga viti 1971,
2. TS 110/35/10 kV Suhareka është 1ëshuar në punë në vitin 1978.
3. TS 110/10 kV Prizreni III punon nga viti 1987.

Zona e Industrisë së lehtë hynë në distribuimin Prizreni III.

Telekomunikimi

Në Kosovë janë dy operator të licencuar për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese mobile, Telekomi i Kosovës si operator publik shtetëror dhe IPKO Telecommunication si operatori i vetëm privat.

Të dy operatorët mbulojnë territorin e Prizrenit me shërbimet të telefonisë mobil me zë “voice” dhe me të dhëna “data”. Mbulueshmëria me shërbimet e zërit “voice” ne komunën e Prizrenit është e kënaqshme, përfshirë edhe zonën e Parkut të Biznesit.

Shërbimet e Telekomit të Kosovës jepen përmes dy shtyllave, Telekomi dhe Vala. Telekomi ofron shërbimet PSTN, përmes rrjetit kabllor të bakrit dhe kabllove optike, gjersa Vala ofron shërbimet përmes BTS. Telekomi i Kosovës ofron shërbimet e telefonisë fikse, internet edhe IPTV. Vala e Kosovës ofron shërbime të telefonisë mobile dhe internetit mobil përmes valëve 2G, 3G dhe 4G.

Përveç dy operatorëve kryesor në komunën e Prizrenit operojnë edhe operator të tjerë privat si: KUJTESA, ARTMOTION, dhe operator të tjerë të cilët ofrojnë shërbime të internetit dhe IPTV.

Centrali aktual telefonik është NGN dhe mundëson këto shërbime:

- Telefoni fikse;
- Internet brez-gjerë;
- IPTV etj.

Sfide për përmirësimin e shërbimeve telekomunikuese mobile, ne veçanti e shërbimeve "data" janë nivelet e ulëta të brezave frekuencore te cilat autoritetet rregullatore i kanë ndarë për operatorët e lartë cekur. Në Kosovë përdoren vetëm dy breza frekuencore. Ai 900 dhe 1800MHz, dhe atë vetëm nga 10 respektivisht 25 MHz për operatorë. Kjo vështirëson tej mase punën e operatorëve për të ofruar shërbime me të mira "data" për qytetarët.

Sfidë tjetër është transporti. Operatorët e telefonisë mobile mbi 70% të transportit e bëjnë me teknologjinë wireless, gjë e cila i limiton ne kapacitete.

Duke parë qe mbulueshmëria me shërbime "voice" është e kënaqshme, përmirësimet duhet të orientohen kryesisht në shërbimet "data". Nevoja për kapacitete me të mëdhaja nga shfrytëzuesit gjithnjë e në rritje, tregon që edhe zonat me mbulueshmëri të mirë në ditët e sotshme, në një të ardhme jo të largët nuk do të jetë e mjaftueshme. Për këtë nevojitet përmirësim ne infrastrukturë dhe teknologji.

Për të përmbushur kërkesat e qytetarëve dhe bizneseve për kapacitete të mjaftueshme, operatorët duhet qe të:

- Rrisin numrin e BTS-ve në zonat me koncentrim më të madh të qytetarëve dhe bizneseve. Mënyrë me e përshtatshme për ta bërë këtë, rekomandohet që të ndërtohen BTS të përbashkët nga dy operatorët, gjë që kishte me i ulët edhe kostot e tyre të operimit, njëkohësisht kishte me e përmirësua edhe mbulueshmërinë me shërbime për qytetarët.
- Rrisin kapacitetet duke zëvendësuar transportin me wireless, me atë me fije optike. Edhe ne këtë rast mund të përdorin infrastrukturë të përbashkët nëntokësore që mund te jetë pronë e operatorëve, pronë publike komunale, apo edhe ndonjë operatori të shërbimeve FIX-e, të cilët do ta ndajnë të njëjtën infrastrukturë gjithashtu.

Menaxhimi i mbeturinave

Hedhja e mbeturinave në komunën e Prizrenit bëhet në deponin Sanitare Regjionale të Prizrenit e cila është e ndërtuar në Landovicë. Përveç komunës së Prizrenit ajo mbulon edhe komunën e Suharekës, me popullsi përafërsisht 320.000 banorë. Kjo deponi ka një sipërfaqe prej 25 ha. Deponia Sanitare (regjionale) është financuar nga AER, dhe menaxhohet nga KLMC (Kosovo Landfill Managment Company).

Në këtë deponi pas ndërtimit të pikës transitore në fshatin Xërxë, planifikohet të deponohen mbeturinat e komunës së Rahovecit, Malishevës dhe Gjakovës.

Grumbullimi i mbeturinave nëpër institucione, biznese dhe amvisëri bëhet nga Ndërmarrja Publike Regjionale për mbledhjen e mbeturinave "Eko Regjioni" me seli në Prizren. Kjo ndërmarrje (ish-Higjiena), është transformuar në ndërmarrje regjionale në vitin 2003 me katër njësi punuese nëpër komunat tjera të regjionit (Prizreni, Dragashi, Rahoveci, Suhareka dhe Malisheva). Vëllimi i mbledhjes së mbeturinave të ngurta në qytet është 630 m3 në ditë ose 13.860 m^3 në muaj.

Analiza SWOT – Infrastruktura teknike

Përparësitë	Dobësitë
Ujësjellësi, Kanalizimi dhe ujitja/drenazhimi - Burime të ujit të pijes; - Cilësia e mirë e ujit; - Menaxhimi dhe mirëmbajtja e kanaleve ekzistuese	**Ujësjellësi, Kanalizimi dhe ujitja/drenazhimi** - Mos shfrytëzimi i kapaciteteve të ujit për nevoja të pijes; - Rrjeti pjesërisht i vjetër i ujësjellësit dhe gypa nga

dhe të reja është në kompetencë të njësisë KRU Hidroregjioni Jugor
- Vazhdimësia e ndërtimit të kanaleve të reja;
- 95% e vendbanimeve me rrjet të ujësjellësit;

Energjia elektrike
- Rezervat e mjaftueshme të linjitit për të prodhuar energji elektrike dhe termike me çmime konkurruese;
- Përvoja industriale për prodhim dhe eksploatim të linjitit në Kosovë;
- Kapacitete transmetuese interkonektive të mjaftueshme që mundësojnë tregti ndërkufitare
- Resurset humane të mjaftueshme për të rekrutuar dhe zhvilluar staf me shkathtësi që mund t'i përgjigjen kërkesave të sektorit;
- Baza ligjore në harmoni me direktivat e BE-së;
- Republika e Kosovës është anëtare e Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë të EJL

Telekomunikimi
- Shërbimet ekzistuese qe ofrojnë mbulueshmëri;
- Mbulueshmëri minimale edhe në zonat rurale;
- Shfrytëzimin e granteve (kombëtare e ndërkombëtare) për Përmirësimin e infrastrukturës

Menaxhimi i mbeturinave
- Traditë dhe përvojë në ofrimin e shërbimeve për grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave;
- Personeli/stafi ka përvojë në organizimin e punëve operative dhe mbulimin cilësor të terrenit;
- Kapacitetet e nevojshme në mekanizëm dhe automjete për ofrimin e shërbimeve në regjionin e Prizrenit;
- Kompani e licencuar nga Ministria e Planifikimit dhe Zhvillimit Hapsinor deri me 2023, për grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave;
- Staf profesional për përgatitjen e projekteve për kërkim të donacioneve;

materiali AC në disa zona;
- Mungesa e ujëmatëseve zonale në zona të caktuara të rrjetit ujësjellësit;
- Dimensione joadekuate të gypave ekzistues;
- Mungesa e sistemit të akumulimit të ujërave;
- Domosdoshmëria e shfrytëzimit të pompave në disa pjesë të qytetit (lagjet në zonat e larta);
- Shfrytëzimi jo i duhur i ujit (abuzimet);
- Mungesa e koordinimit ndërmjet kompanive publike;
- Mungesa e impianti për trajtimin e ujërave të zeza;
- Rrjeti i vjetruar i kanalizimit;
- Përzierje e rrjetit te kanalizimit me atë atmosferik;
- Mungesa e rrjetit atmosferik të ri;

Energjia elektrike
- Rrjet i vjetërsuar;
- Kapacitete gjeneruese aktuale të vjetërsuara që nuk sigurojnë prodhim të qëndrueshëm të energjisë elektrike;
- Nivel i lartë i humbjeve teknike dhe komerciale në sistemin e shpërndarjes;
- Mundësi të kufizuara për vetë financim të investimeve;
- Ngecja në ritmin e investimeve për modernizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve prodhuese;

Telekomunikimi
- Mënyra e shpërndarjes së rrjetit e pa organizuar;
- Mos unifikimi i rrjetave nga operatoret qe ofrojnë shërbime Telekomunikuese.
- Shërbimet "fiber to home" ne nivel minimal;
- Mbi 80% ofrojnë shërbime më kabllo koaksiale;

Menaxhimi i mbeturinave
- Shërbime jo të mira në menaxhim të mbeturinave;
- Mungesë e deponisë për mbeturina inerte/demolimit.
- Mungesa e trajtimit të mbeturinave industriale dhe sanitare;
- Mungesë e hapësirave për trajtim të mbeturinave shtazore;

Mundësitë	**Rreziqet**
Ujësjellësi, Kanalizimi dhe ujitja/drenazhimi - Shfrytëzimi i investimeve të jashtme; - Garantët qeveritarë; - Aplikimi i arritjeve teknologjike; - Trajnimi i stafit; - Ekzistenca e Legjislacionit përkatës; Telekomunikimi - Planifikimi dhe Ndërtimi i Infrastrukturës	**Ujësjellësi dhe Kanalizimi dhe ujitja/drenazhimi** - Mos ndërrimi i gypave të vjetër të ujësjellësit; - Cenimi i kualitetit/sigurisë së ujit si pasojë e rrjetit të vjetërsuar; - Humbjet e mëdha të ujit në rrjet; - Keqpërdorimi i ujit; - Mospjesëmarrja e komunitetit në vendimmarrje në procesin e ndërtimit të impiantit (çështja e

nëntokësore nga Komuna; - Realizimi i të hyrave nga shfrytëzimi I infrastrukturës; - Te ofrohen grante për operatorët që zgjerojnë rrjetin në zonat e largëta rurale; Menaxhimi i mbeturinave - Fushata vetedijësuese; - Krijimi i Eko-taksës - Angazhimi i OJQ-ve mjedisore; - Rritjen e inkasimit dhe marrëdhënieve me konsumatorë; - Rritjen e mundësive për investime të reja kapitale dhe pajisjeve; - Inicimin e procesit të riciklimit dhe ndërtimin e vijave recikluese; - Forcimin e partneriteti dhe kooperimit me rrjetin PAMKOS dhe ndërmarrjet simotra për mbeturina në Kosovë.	eksproprijimit); - Politika joadekuate; - Mbrojtja e zonave të burimeve të ujërave nëntokësorë dhe sipërfaqësorë - Mbrojtja e rezervuarëve dhe Stacioneve te pompave me rrethoj dhe siguri fizike - Dëmtimi i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit dhe ujitjes; **Telekomunikimi** - Largimi I shtyllave nga KEDS pa shtrirjen e gypave nëntokësor për operatorët e telekomunikimeve, që mund të lerë qytetarët pa shërbim; - Vazhdimi i infrastrukturës se pa unifikuar nga operatoret; - Cilësia e shërbimit; **Menaxhimi i mbeturinave** - Rritja e ndotjes; - Shfaqja e sëmundjeve infektive; - Ndotje e tokave bujqësore; - Mos mirëmbajtje adekuate e rrjetit energjetik;

2.4.4.4. Infrastruktura Rrugore

- **Transporti rrugor**

Komuna e Prizrenit është e lidhur mirë me qytetet kryesore të Kosovës si dhe me Shqipërinë veriore. Rrjeti rrugor kryesor përbëhet nga rrugët nacionale dhe rajonale si dhe autoudha "Ibrahim Rugova".

- **Rrugët nacionale dhe rajonale**

Nëpër qytetin e Prizrenit e kalon rruga nacionale N25 e cila vjen nga Prishtina dhe kalon në pjesën very -lindore të qytetit, respektivisht nëpër rrugën "Adem Jashari dhe Remzi Ademaj" dhe vazhdon për në Kukës në Shqipëri.

Gjashtë rrugë rajonale e lidhin Prizrenin me qytetet dhe fshatrat tjera në Kosovë. Një ndër rrugët më të rëndësishme është rruga rajonale R-107 e cila e lidhë Prizrenin me Gjakovën dhe Pejën.

- **Rrugët lokale**

Rrugët në qytetin e Prizrenit, kryesisht janë me nga dy korsi trafiku (2x1), përveç rrugës "Transitit" e cila ka nga dy korsi trafiku për kahe dhe rruga "Ibrahim Rugova, Remzi Ademaj dhe Adem Jashari" e cila është rrugë një kahore me dy korsi për kahe (1x2).

Rrugët lokale të cilat lidhin lokacione të ndryshme brenda qytetit të Prizrenit kanë karakter të ndryshëm. Rrugët e karakterit më të lartë janë plotësuar nga rrugë lidhëse të karakterit më të ulët. Shumica e rrugëve lokale nuk kanë gjerësinë e mjaftueshme dhe elementet gjeometrike të tyre nuk ofrojnë kushte të mira për të gjithë pjesëmarrësit në trafik, sidomos mungesa e trotuareve dhe shtigjeve për çiklist shkakton vështirësi për këmbësorë dhe çiklist.

Infrastruktura Rrugore Parku Biznesit

Parku i biznesit shtrihet përgjatë rrugës Nacionale N-25, rrugë e cila ka kapacitete të mjaftueshme për të përballuar fluksin e lëvizjes dhe gjendja fizike e rrugës është e mire.

Brenda zonës së Parkut të Biznesit shtrihen rrugë të karakterit më të ulët, viteve të fundit ka filluar hapja dhe asfaltimi i rrugëve kryesore brenda zonës. Ndërsa pjesa tjetër e rrugëve mbetet të hapen dhe ri-konstruktohen konform kërkesave dhe standardeve për zonën ekonomike.

Analiza SWOT – Infrastruktura Transportit

Përparësitë	Dobësitë
• Lidhjet relativisht të mira me komunat përreth (Gjakovë, Suharekë, Rahovec, Dragash dhe Kukës); • Lidhja relativisht e mirë me pjesën veriore të Shqipërisë; • Traditë në zhvillimin e Transportit urban • Konfiguracioni i terrenit dhe përdorimi i lëvizjeve të pamotorizuara si forma të lëvizjes brenda zonës urbane.	• Rrugët kryesore hyrëse- dalëse të qytetit nuk janë trajtuar për më tepër se 3 dekada • Rruga e vetme nacionale në Komunën e Prizrenit kalon nëpër rrugët e qytetit, • Gjashtë rrugë rajonale komunale janë me akses të ngushtë dhe segmente të papërshtatshme, veçanërisht në fushat kur kalon qyteti. • Mungesa e rrugëve rrethore urbane • Numri i madh i automjeteve kalon nëpër pjesën qendrore të qytetit, sidomos në zonën historike të qytetit; • Transport joadekuat dhe i pamjaftueshëm publik;
Mundësitë	**Rreziqet**
• Avancimi i sistemit të transportit urban • Lidhja në rrjetin hekurudhor të Kosovës dhe korridore panevropiane përmes rrjetit hekurudhor (korridori i X-të); • Afërsia me Shqipërinë si dhe linja e drejtpërdrejt me portin e Shëngjinit janë parakushte të mira për lulëzimin e tregtisë;	• Hapësirat e pamjaftueshme të parkingjeve publike, shtigjeve për çiklistëve • Investimet në infrastrukturën e transportit nuk janë integruar siç duhet në projektet e zhvillimit. Mungesa e ose pamjaftueshmëria e buxhetit komunal dhe granteve për realizimin e projekteve të parapara.



Harta 7 Shtrirja e rrugëve ekzistuese

2.5. Vlerësimi i gjendjes së sipërfaqes së planifikuar, si

Analiza të hollësishme të gjendjes fizike, sociale, ekonomike e mjedisore;

2.5.1. Gjendja fizike e zonës

Struktura fizike e lokacionit të Parkut të Biznesit ka vetëm 1.2% të sipërfaqes së ndërtuar, ndërsa sipërfaqja tjetër, 98.8% e lokacionit është sipërfaqe e pa ndërtuar dhe e pashfrytëzuar. Pjesa e ndërtuar ka vetëm tri objekte dhe vetëm njëra prej tyre është në funksion, që është një mobilieri, dhe dy të tjerat janë në ndërtim e sipër. Objektet e ndërtuara kanë destinim afarist dhe janë të tipit P+0. Gjendja fizike e tyre është "e mirë", me sistem konstruktiv skeletor.

Rrugët përgjatë lokacionit janë të paasfaltuara dhe ato përshkohen nga banorët e fshatrave përreth, si dhe nga deponia e hekurishtes e cila gjendet afër magjistrales.

Lokacioni ka pjerrtësi që shkon deri në 60% në prerje gjatësore, me një ramje 28.6%, ndërsa në 40% terreni ka ramje prej 6.9% në drejtim veriperëndimor të lokacionit.

Analiza SWOT – Gjendja fizike e zonës

Përparësitë	**Dobësitë**
• Pronësi komunale dhe private • Zonë e pa ndërtuar. • Rruga ndërlidhëse mes Komunës së Prizrenit dhe Suharekës. • Distancë të mjaftueshme nga Zona urbane. • Nuk paraqet rrezik për ngarkesa në komunikacion. • Rrugë ekzistuese të mjaftueshme për qasje jashtë vendbanimeve. • Nuk pengon qasjen në zonat fqinje, ndërlidhje të mjaftueshme mes vendbanimit dhe zonave fqinje të zonës ekonomike.	• Pjerrtësi e lartë >28%; • Mungesa e planit Rregullues • Numri i vogël i objekteve të ndërtuara • Gjysma e sipërfaqes e pa ndërtuar • Kufijtë e parcelës me formë te çrregullt dhe të papërshtatshme për një plan parcelimi të shfrytëzueshëm mirë. • Zonë jo kompakte dhe e ndarë në dy pjesë nga zonat bujqësore dhe pyjore. • Afërsi të vendbanimit Korishtë, Lubizhdë.
Mundësitë	**Rreziqet**
• Afërsia me rrugë nacionale • Afërsia me komunat e tjera • Mundësi të shfrytëzimeve të ndryshme për biznese. • Mundësi të planifikimit të rrugëve me standarde dhe norma teknike të planifikimit hapësinor. • Mundësi për ngritje të zhvillimit ekonomik në komunën e Prizrenit. • Mundësi për hapje të vendeve të reja të punës për banorët e Prizrenit dhe zonave përreth.	• Pjesë të caktuara kanë pjerrtësi të theksuar, që vështirësojnë zhvillimin e ndërtimeve në zonë; • Mungesa e Planit Zonal dhe Planit Rregullues krijon kushte të favorshme për rritjen e ndërtimeve pa leje. • Afërsi e burimeve ujore, kontaminimi i ujërave në rast të menaxhimit të dobët të mbeturinave. • Zhurma si ndotës, afërsi e vendbanimit.

2.5.2. Gjendja sociale

Parku i Biznesit Prizren gjendet në pjesën veri-lindore të Komunës me një distance 5 km nga qendra e qytetit, momentalisht në kuadër të zonës nuk ka ndërtim të objekteve industrial apo banimi, kryesisht zonat e banimit shtrihen në pjesën jugore të zonës me një perimetër prej 100 metra nga kufiri zonës.

Struktura e infrastrukturës rrugore, zona shtrihet përgjatë rrugës Nacionale Prizren-Suharekë N25, ndërsa brenda zonës në pjesë të caktuara infrastruktura rrugore është e pa rregullt në aspektin gjeometrik të shtrirjes. Ndërsa parcelat kadastrale të cilat përbejnë zonën, sipas gjendjes ekzistuese janë të parregullta gjeometrikisht, dhe me sipërfaqe të ndryshme nga më të vogla deri të parcela të mëdha.

Figura 4 Peizazhi ortogonal i zonës

Analiza SWOT – Gjendja sociale

Përparësitë	Dobësitë
• Zonë e pa ndërtuar nuk paraqet mosmarrëveshje me banorët. • Nuk pengon qasjen në zonat fqinje, ndërlidhje të mjaftueshme mes vendbanimit dhe zonave fqinje të zonës ekonomike. • Përmirësim i identitetit të vendbanimit si një zonë e zhvilluar ekonomike.	• Afërsi të vendbanimit Korishtë dhe Lubizhdë. • Pjerrtësia e lart e terrenit.
Mundësitë	**Rreziqet**
• Mundësi për hapje të vendeve të reja të punës për banorët e Prizrenit dhe banorët e vendbanimeve përreth. • Përmirësim i mirëqenies socio-ekonomike për banorët e Komunës së Prizrenit.	• Afërsi e burimeve ujore, kontaminimi i ujërave në rast të menaxhimit të dobët të mbeturinave. • Zhurma si ndotës, afërsi e vendbanimit.

2.5.3. Gjendja ekonomike

Në kohën e dominimit të prodhimtarisë zejtare, Prizreni u ngrit në një nga qendrat më të mëdha zejtare në Ballkan. Në punëtoritë e shumta të këtij qyteti ushtroheshon më shumë se 120 lloje zejesh, nga më të ndryshmet. Prodhimet e zejtarëve prizrenas jo vetëm se shiteshin në tregjet e mbarë Perandorisë Osmane, por ato depërtonin edhe në vende tjera, madje edhe deri në Indi.

Në veçanti është e njohur tradita e përpunimit artizanal të metaleve fisnike – filigrani.

Prizreni sërish mund ta fitojë shansin e vet historik në kuadër të një impakti ekonomik e kulturor. Revitalizimi dhe mbrojtja e fondit të trashëgimisë kulturore si dhe inkurajimi në riaktivizimin e atyre veprimtarive karakteristike ekonomike, do të mundësonin që Prizreni të bëhet partner i denjë në bashkëpunimin kulturor e ekonomik me qytetet tjera të Ballkanit, Europës Juglindore dhe më gjërë.

Ekonomia e Prizrenit është zhvilluar në drejtime të ndryshmenë vend se të jetë e bazuar në industrinë prodhuese, ndërkaq ekonomia shërbyese duhet të transformohet në një konomi të suksesshme për arsye të rritjes së madhe të kërkesave në sektorin e arsimit, shëndetesisë, rekreimit dhe të tregëtisë.

Prej vitit 1980 – 1999 ndërmarrjet shoqërore kanë punësuar 80% të fuqisë punëtore të Prizrenit. Aktualisht, NSH-të janë duke punuar në kushte shumë të vështira. Burimi i vetëm i të hyrave për këto ndërmarrje është dhënja me qera (leasing-u) objekteve të tyre sektorit privat. Për momentin organet komunale nuk kanë kompetenca që të administrojnë këto ndërmarrje shoqërore. (Prej vitit 2001 të gjitha NSH-të janë nën UNMIK-un, ndërsa prej vitit 2002 nën AKM-në – Agjensioni Kosovar I Mirëbesimit).

Tregtia—Lokacioni i qytetit të Prizrenit e ka bërë atë historikisht njërën prej qyteteve tregtare më të rëndësishëm në Ballkan. Sot, aktivitetet biznesore të qytetit të Prizrenit gjithashtu edhe të Komunës janë të orientuara drejt tregtisë me shumicë dhe pakicë.

Investimet kapitale të projektit supozohet të kryhen gjatë viteve: nga 2022 deri në vitin 2024. Komuna do mund të gjejë fondet e nevojshme dhe t'i alokojë ato në zhvillimin e infrastrukturës për fillim të operimit të zonës nga viti 2025. Fizibiliteti financiar është për 18 vite (3 vite zhvillim të infrastrukturës dhe 15 vite operimi).

Gjatë procesit të planifikimit janë shfrytëzimet në kuadër të zonës Parkut Industrial në Prizren, të cilat janë në harmoni me Hartën Zonale Komunale te Komunës së Prizrenit.

8.1.3. Arsyeshmëria ekonomike

- Krijimi i kushteve të favorshme për zhvillim të bizneseve të reja
- Krijimi i zonës turistike dhe rregullimi i zonave ekzistuese.
- Shfrytëzimi i resurseve natyrore për zhvillim ekonomik

8.1.4. Supozimet për modelin financiar

Supozimet:	**Vlera**
Njësia e përdorur	m^2 (Metër katror)
Vitet e investimit kapital	3 vjet
Vitet e operimit për studim të fizibilitetit	15 vjet
Inflacioni	2.5%
Sipërfaqja totale për të dhënë me qera m^2	320,000 m^2
Qiraja mujore e qirasë për m^2	0.35 Euro
Paga mesatare mujore e punëtorëve	650 Euro
Pjesëmarrje në borxh	0%
Investimi capital (Euro)	3,975,562
Investimi capital nga 2022-2024 (Euro)	1,562,796
Rritja e kostove operacionale	1.2%
Kostoja vjetore e mirëmbajtjes për m^2	0.02 Euro/ m^2
Norma e interesit	4%
Norma e skontimit	8%
Numri i punësuarve direkt	6 punëtorë

Investimi kapital prej shumës 1,562,796 Euro supozohet që mbarojnë në vitin 2024, kurse operimi i zonës të fillojë në vitin 2025.

9. ADMINISTRIMI, ZBATIMI DHE MONITORIMI I ZBATIMIT

Në rastin e PRrH-së për zonën e veçantë “Parku i Biznesit” - Prizren, organi kompetent për zbatimin e Planit Rregullues (PRrH) është Komuna e Prizrenit.

Komuna e Prizrenit duhet që të bëjë përfshirjen e plotë të qëllimeve, objektivave dhe veprimeve të cilat do të jenë relevante për kohën.

Raportimi i zbatimit për PRrH-në Zonën e veçantë “Parku i Biznesit” - Prizren, do bëhet në hap me ciklin e zbatimit i cili është i obliguar për raportim vjetor, por mundet me qenë edhe dy herë brenda vitit, sidomos para rishikimit të buxhetit në gjashtë mujorin e parë, me qëllim që gjatë rishikimit të buxhetit të kemi mundësin e futjes së ndonjë projekti ose alokimin e fondeve shtesë për ndonjë projekt i cili ka tejkaluar parashikimet buxhetore, këto informata e bëjnë administrimin e zbatimit mjaft të informuar por edhe veprues në kohë reale.

Pjesë e administrimit të zbatimit të PRrH-në Zonën e veçantë “Parku i Biznesit” - Prizren, janë të gjitha përmbajtjet e karakterit hapësinor të Planit: duke filluar nga procesi i dhënies së kushteve ndërtimore, kushteve për infrastrukturë

teknike, rrugor, publike e sociale, masave mbrojtëse, lejeve ndërtimore, përjashtimeve, bonuseve të zonimit, shqyrtimi i përputhshmërisë, etj.

Administrimi i zbatimit të PRrH-në Zonën e veçantë "Parku i Biznesit" - Prizren, nënkupton edhe menaxhimin me të gjitha aktivitetet e lart përmendura, por edhe trajtimin e kërkesave për jo konformitet, përjashtim apo bonuse të zonimit pas hartimit të Planit.

Si kusht i parë për të filluar procedurat e tilla është të kemi aplikim për të njëjtat nga ndonjë aplikues, subjektet fizike ose juridike duhet të aplikojnë zyrtarisht në përputhje me dispozitat e Planit dhe procedurat e aplikimit për jo konformitet, ndryshim-plotësim, përjashtim dhe/apo bonuse të zonimit, do përshkruhen brenda kapitujve të paraparë nga ligjvënësi si pjesë e Planit. Autoriteti kompetent duhet të bëjë të gjitha përpjekjet që këto procedura të sqarohen ashtu që të jenë më të lehtë për tu kuptuar nga aplikuesit dhe për t'u administruar. Procedurat e tilla janë trajtuar edhe në nenin 31 të UA MMPH-Nr. 01/2018, Ky udhëzim administrativ specifikon edhe kërkesat për aplikime për ndryshim plotësime në PRrH, por edhe për procedurën për përjashtimet dhe bonuset e zonimit.

Administrimi sidomos në funksion të shqyrtimit të përputhshmërisë nënkupton edhe një përgjegjësi të administratës për menaxhimin me marrjen e vendimeve për miratimin ose refuzimin e kërkesave për dhënien e kushteve ndërtimore, përjashtimeve, bonuseve të zonimit të përcaktuara Plan, i cili duhet bëhet duke krahasuar vendimet me kriteret, masat dhe kushtet e përcaktuara në Plan, por edhe ligje, rregullore dhe dokumente tjera. Përputhshmëria duhet shqyrtohet bazuar në përmbajtjet e dokumentuara dhe transparente.

Nëse kemi ankesa ndaj vendimeve të marra nga ana e autoritetit kompetent ose kërkesa për interpretime të ndryshme për përmbajtjet e pjesëve të Planit, në funksion të administrimit të zbatimit, interpretimi bëhet nga Autoriteti kompetent për planifikim dhe menaxhim hapësinor në nivel komunal dhe nga MMPH në nivel qendror, varësisht kujt do të i jepet administrimi i zbatimit të këtij Plani.

Gjatë zbatimit të Planeve, disa zhvillime të caktuara bëhen çështje e gjykatave: prej atyre komunale, e deri te nivelet e më të larta gjyqësore. Vlerësohet si i domosdoshëm bashkëpunimi me gjykatat dhe krijimi i një vije komunikimi dhe bashkëpunimi cilësor me to, në funksion të marrjes së vendimeve adekuate dhe me peshë të duhur. Ky bashkëpunim, është shumë i rëndësishëm sepse, është në funksion adekuat të parandalimit dhe të amortizimit të zhvillimeve të pa planifikuara. Duke e ditur se gjykatat tona janë shumë të ngarkuara, lëndët që vijnë nga kjo fushë duhet parë dhe duhet trajtuar me prioritet sepse, pasi që të bëhet zhvillimi apo implementimi në këtë drejtim, edhe tentimi për revidim ose edhe sanksioni eventual është i pa vlerë dhe jo efikas.

Nëse nuk krijohet një urë e bashkëpunimi efikas me gjykatat, lejohen apo stimulohen edhe më shumë zhvillimet e pa planifikuara dhe jo legale. Duke njohur rolin dhe fuqinë e gjykatave, Autoriteti kompetent, në funksion të zbatimit të Planit edhe Ekipi Punues si dhe instancat e tjera të nivelit komunal dhe qendror, duhet ofruar kushte, duhet krijuar komunikimin dhe bashkëveprimin të duhur në mënyrë që aty ku është e domosdoshme (madje edhe duke bashkëpunuar edhe me mekanizma të tjerë, siç është policia), të pengohen ndërtimet e pa planifikuara dhe ilegale në funksion të zbatimit efikas dhe cilësorë të Planit.

Bashkëpunimi me Byro Projektuese dhe me Institute adekuate si dhe me institucione që merren me projekte zhvillimore në mënyrë profesionale, është i rëndësishëm dhe në funksion të zbatimit të Planit, e të informimit adekuat. Komunikimi dhe bashkëpunimi në këtë drejtim, është shumë i rëndësishëm. Nëse vendosen ura të bashkëpunimit dhe të komunikimit dhe ngritët niveli i bashkëpunimit në shkallë adekuate, këto institucione nuk do të hartojnë projekte pa qenë të bazuara në kushtet zhvillimore dhe ndërtimore të parapara me Plan dhe pa qenë brenda shfrytëzimeve që lejohen, lejohen me kushte ose me kushte të veçanta. Në të njëjtën kohë, këtyre institucioneve duhet bërë të kuptojnë se për veprime të jashtëligjshme, mund edhe të dënohen madje, edhe t'u ndalohet veprimtaria. Paralajmërimi si dhe shqiptimi i sanksioneve, besojmë se kontribuon direkt në zbatim e mirëfilltë të Planit. Në këtë drejtim, Autoriteti kompetent por edhe Ekipi Punues si dhe instancat e tjera të nivelit komunal dhe qendror, duhet ta luajnë rolin e vetë të informimit, të komunikimit dhe të bashkëveprimit me këto institucione.

10. NDRYSHIM PLOTËSIMET DHE PËRJASHTIMET

Fillimisht duhet sqaruar pas aprovimit të PRrH-së, se cilat janë mundësitë ligjore për ndryshim dhe plotësim të Planit dhe cilat procedura duhet kalojmë.

Duke e ditur se ndryshimi dhe plotësimi – nënkupton ndryshimet në pjesët tekstuale dhe hartografike të Planit, të cilat do të bëhen vetëm në përputhje me nenin 31 të aktit nënligjor, ku është përcaktuar se pjesët tekstuale ose hartografike të Planit në këtë rast të PRrH-së Zonën e veçantë "Parku i Biznesit" - Prizren, mund të ndryshohen plotësohen me vendim të autoritetit kompetent dhe ndryshim plotësimi duhet të miratohet nga Ministria. Kjo rrethanë mund të aplikohet vetëm nëse në Hartën Zonale të Komunës janë bërë ndryshim plotësime apo edhe përjashtime pasi të jetë miratuar Plani Rregullues i Hollësishëm, Autoriteti për planifikim hapësinor në këtë pjesë plotëson këto ndryshim plotësimet dhe përjashtimet.

11. VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

Sipas ligjit të Planifikimit Hapësinorë nr. 04/L-174, përkatësisht nenit 23 dhe ligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisorë nr. 03/L-230, dokumentet e planifikimit hapësinorë obligohen të kenë edhe raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisorë (VSM).

PRrH – Zona e veçantë "Parku i Biznesit"-Prizren në përmbajtjen e tij ka të bashkangjitur Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, i cili është Aneks i këtij dokumenti.

12. PËRKUFIZIMET

Paraqet përkufizimet për të sqaruar shprehjet që janë të paqarta, që mund të keqinterpretohen, që janë të panjohura ose janë teknike apo specifike për Plane Rregulluese të Hollësishëm.

Përkufizimet përfshijnë shprehje të interpretimit të përdorura në Planin Rregullues të Hollësishëm të Zonës së veçantë "Parku i Biznesit" – Prizren.

Përkufizimet e përdorura gjatë hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm të Zonës së veçantë "Parku i Biznesit" – Prizren.

Përkufizimet që janë përdorur në këtë dokument bazohen në Udhëzimin Administrativ, Ligjin Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor, Ligjin për Ndërtim dhe ligjet tjera të zbatueshme, si dhe dokumente dhe procese tjera relevante dhe kanë këto kuptime:

Dokumenti i Planifikimit Hapësinor

Plani Hapësinor i Kosovës, Harta Zonale e Kosovës, Plani Hapësinor për Zona të Veçanta, Plani Zhvillimor Komunal, Harta Zonale e Komunës dhe Plani Rregullues i Hollësishëm, siç përkufizohen me ketë ligj dhe për të cilat sigurohet qasje publike përmes faqes së internetit të Ministrisë dhe komunave.

Plani Zhvillimor Komunal PZHK

Dokumenti i planifikimit hapësinor i nivelit lokal, në pajtim me dispozitat e nenit 15 të ligjit.

Plani Zhvillimor Komunal është një plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani Zhvillimor i Komunës duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare

Harta Zonale e Komunës HZK

Dokumenti i planifikimit hapësinor i nivelit lokal, në pajtim me dispozitat e nenit 16 të ligjit.

Harta Zonale e Komunës është një dokument multi-sektorial që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës, për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

Plani Rregullues i Hollësishëm PRrH

Dokumenti i planifikimit hapësinor i nivelit lokal, në pajtim me dispozitat e nenit 17 të ligjit, Komunat varësisht nga nevojat për zhvillim hapësinor mund të përgatisin Plane Rregulluese të Hollësishme për të gjitha ose për cilëndo nga zonat e përcaktuara me Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale të Komunës.

Planet Rregulluese të Hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane apo zona rurale siç është përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale Komunale, Planet Rregulluese të Hollësishme përcaktojnë edhe kushtet ndërtimore.

Autoriteti i Planifikimit Hapësinor

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe autoritetin përgjegjës të Komunës për planifikim dhe menaxhim hapësinor, siç përcaktohet me Ligjin e planifikimit Nr. 04/L-013.

Vendbanim
Zonë me karakteristika urbane, fshat, qytet apo vendbanimin tjetër.

Zonë
Një grup të parcelave kadastrale fqinje me përcaktim të njëjtë të shfrytëzimit të tokës, zhvillimit apo të mbrojtjes dhe ruajtjes, duke përdorur përkufizimet e zonave në Ligjin e planifikimit Nr. 04/L-013.

Zonë Rurale

Një sipërfaqe që karakterizohet me një sasi të ultë të ndërtimit, dendësisë së popullsisë, dhe të infrastrukturës teknike, publike dhe sociale, si dhe të punësimit përmes zhvillimit të agrikulturës, turizmit rural, qendrave shëruese dhe të prodhimtarisë që nuk ndot mjedisin rrethues.

Zonë Banimi

Sipërfaqe e caktuar kryesisht për qëllime të banimit.

Zonë Bujqësore

Një zonë tokësore të caktuar për kultivim të kulturave bujqësore dhe blegtorale si: tokë e lërueshme, kopsht, pemishte, vresht, livadh, kullosë, pellg peshqish, moçal, etj.

Zonë Mbrojtëse

Një zonë përreth perimetrit të burimeve natyrore dhe të trashëgimisë kulturore të ndërtuar, që është shpallur nën mbrojtje që përcaktohet nga institucioni kompetent, në të cilën ndalohet çdo zhvillim apo aktivitet që mund të dëmtojë pamjen e kuadrit ose dëmtim tjetër të burimeve natyrore dhe të trashëgimisë kulturore.

Parcela Kadastrale

Përkufizohet me Ligjin Nr.04-L-013 për Kadastrën dhe nënkupton sipërfaqen e tokës të identifikuar me numër të parcelës kadastrale dhe regjistruar në hartën kadastrale me sipërfaqe të vërtetë në hartën projektuese dhe sipërfaqe të regjistruara në Regjistrin e të Drejtave në Pronë të Paluajtshme në bazë të Ligjit Nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrit e të Drejtave në Pronë të Paluajtshme dhe Ligjit Nr.04/L- 009/2011 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2002/5 për Themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme.

Vija rregulluese VRR

Largësia nga kufiri i parcelës kadastrale të paraparë për ndërtimin e infrastrukturës teknike, në të cilin nuk lejohet asnjë lloj ndërtimi.

Vija e ndërtimit VN

Largësia nga kufiri i parcelës kadastrale dhe vija rregulluese në të cilin lejohet ndërtimi i sipërfaqes së përgjithshme të shfrytëzueshme.

Infrastruktura teknike

Shtrirje e rrugëve publike, ndërtesave, instalimeve nëntokësore dhe mbitokësore për furnizimin e energjisë elektrike dhe termike, rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, telekomunikacionit dhe instalimeve të tjera të ngjashme.

Infrastruktura publike

Shtrirje e ndërtesave për shpërndarjen dhe mbledhjen e postës, kujdesin shëndetësor, arsimimin, administratën publike dhe shërbimeve të tjera të ngjashme.

Infrastruktura sociale

Shtrirje e hapësirave dhe ndërtesave për zhvillimin e veprimtarive sportive dhe kulturore, peshkimit, gjuetisë, bibliotekave, parqeve publike, qendrat e komuniteteve, institucionet e komunikimit publik dhe të tjera të ngjashme.

Kushtet ndërtimore

Kushtet ndërtimore, siç janë përcaktuar në nenin 21 të Ligjit të planifikimit Nr. 04/L-013.

Normat teknike të Planifikimit Hapësinor

Dokumenti i cili përcakton kërkesat themelore për hartimin e të gjitha dokumenteve të planifikimit hapësinor.

Ministria
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Komuna
E përcaktuar me Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.

Sipërfaqe e Mbrojtur

Pjesa e territorit të përcaktuar për qëllime të ruajtjes së burimeve natyrore dhe të trashëgimisë kulturore, mbrojtje nga ndotja e mjedisit ose krijim të kushteve hapësinore për ushtrimin e papenguar të veprimtarisë si dhe sigurinë e banorëve dhe zonave përreth, e cila duhet të përcaktohet në Planin Hapësinor të Kosovës dhe Hartën Zonale të Kosovës dhe që mund të klasifikohet nga Ministria si Zonë e Veçantë.

Zonë e Veçantë e Mbrojtur

Zonë e themeluar me Ligjin Nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura.

Zonë e Veçantë

Një zonë të identifikuar në Planin Hapësinor të Kosovës dhe Hartën Zonale të Kosovës që ka veçori specifike që kërkojnë një regjim të posaçëm organizativ, të përdorimit dhe mbrojtjes të zhvilluar nga Ministria përmes Planit Hapësinor për Zona të Veçanta.

Kushte zhvillimore

Nënkuptojnë kushtet zhvillimore që kontrollojnë vendndodhjen, shfrytëzimin, dendësinë dhe karakterin e zhvillimit dhe Kushtet Ndërtimore në pajtim me nenin 21 të Ligjit Nr. 04/L-013;

Ndërtesë

Ndërtim i projektuar për banim për njerëzit apo kafshët, strehim apo ruajtje të gjësendeve, ose shfrytëzim për aktivitete publike apo private, dhe zhvillim të tregtisë ose prodhimit, sipas Ligjit - për Ndërtim në fuqi;

Ndryshim plotësim

Nënkupton ndryshimet në pjesët tekstuale dhe hartografike të Hartës Zonale të Komunës, të cilat do të bëhen vetëm në përputhje me nenin 35, 36, 37 të Udhëzimit Administrativ Nr. 24/2015 dhe nenit 11, paragrafi 1.7 dhe nenit 16 paragrafi 1 i Ligjit të planifikimit Nr. 04/L-013;

Përjashtimet

Nënkupton një devijim të lejuar nga kushtet zhvillimore apo kushtet ndërtimore, në përputhje me nenin 38 të Udhëzimit Administrativ Nr. 24/2015;

Jo konformitet

Nënkupton shfrytëzim ekzistues, ndërtesë ose parcelë kadastrale që nuk është në harmoni me kërkesat aktuale të zonimit dhe trajtohen në pajtim me nenin 38 të Udhëzimit Administrativ Nr. 24/2015;

Bonuset e zonimit

Nënkupton një mjet planifikimi që lejon komunat të mund të sigurojnë përfitime të komunitetit (të tilla si rritja e sipërfaqes së hapur, parqeve, shtigjeve për këmbësorë, etj.) në këmbim të një ndryshimi në kushtet e ndërtimit (zakonisht në formën e dendësisë së rritur, lartësia së shtuar, apo cilësisë më të lartë të kushteve zhvillimore kapacitete shtesë për drenazhim, të menaxhimit të peizazhit, etj.), të ofruara nga aplikuesi;

Sistemi Informativ Gjeografik (GIS)

Një sistem i përbërë nga hardueri, softueri kompjuterik dhe nga të dhënat gjeografike i dedikuar për mbledhjen, përpunimin, analizën dhe paraqitjen e të gjitha formateve të të dhënave referuese gjeografike.

Perimetri

Kufiri zyrtar të një territori me karakteristika të përbashkëta, të zhvillimit, mbrojtjes dhe ruajtjes.

Shërbimet publike

Është një term i përgjithshëm për të caktuar shërbimet e ofruara nga autoritete publike drejtpërdrejt ose tërthorazi të infrastrukturës teknike, publike dhe sociale për qytetarët.

Instituti

Instituti për Planifikim Hapësinor në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Baza e të dhënave të Planifikimit Hapësinor

Përmbledhje digjitale qendrore e të gjitha dokumenteve të planifikimit hapësinor dhe të dhënave tjera të përpunueshme, që janë përgatitur nga autoritetet e planifikimit hapësinor në pajtim me këtë ligj dhe përmban të dhëna për destinimin dhe rregullimin e shfrytëzimit të tokës në territorin e Kosovës, si pjesë e Infrastrukturës Kombëtare e të dhënave hapësinore sipas Ligjit Nr. 04/L-013 për Kadastër.

Të dhënat elementare digjitale

Përmbajtja digjitale të tekstit dhe vizatimeve që duhet të shfrytëzohen gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, Hartës Zonale të Komunës dhe Planit Rregullues të Hollësishëm.

Pjesëmarrja Publike

Pjesëmarrja e një ose më shumë personave fizikë apo juridikë, pjesëmarrjen e shoqatave apo organizatave në hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor.

Shqyrtimi Publik

Ngjarje e hapur për pjesëmarrje publike, të zhvilluara në vende të përshtatshme nga autoriteti i planifikimit hapësinor, i cili përmes njoftimit publik fton qytetarët, ekspertët dhe palët e interesuara për të parashtruar kundërshtimet, komentet apo sugjerimet, para finalizimit të dokumentit të planifikimit hapësinor.

Njoftimi Publik

Njoftim paraprak i palëve të interesuara dhe/ose publikut, për kohën, vendin dhe qëllimin e mbajtjes së shqyrtimit publik.

Komisioni i komunës

Nënkupton një komision që mund të formohet nga ana e komunës për qëllim të këshillimit mbi kërkesat për përjashtime të zonimit dhe autoritete të tjera siç janë deleguar nga komuna;

Listat e zonave

Nënkupton listën e të gjitha zonave të përdorura në Hartën Zonale të Komunës, me përshkrim të shkurtër të këtyre zonave;

13. PJESA HARTOGRAFIKE

Pjesa hartografike e gjendjës ekzistuese dhe të planifikuar është e bashkangjitur si Aneks i pjesës tekstuale.

14. PROCESET PËR NDRYSHIME PLOTËSIME, PËRJASHTIME, JO-KONFORMITETE DHE BONUSE ZOONIMI

14.1. Ndryshim Plotësimet

Fillimisht duhet sqaruar pas aprovimit të PRrH-së, se cilat janë mundësitë ligjore për ndryshim dhe plotësim të Planit dhe cilat procedura duhet kalojmë.

Duke e ditur se ndryshimi dhe plotësimi – nënkupton ndryshimet në pjesët tekstuale dhe hartografike të Planit, të cilat do të bëhen vetëm në përputhje me nenin 31 të aktit nënligjor, ku është përcaktuar se pjesët tekstuale ose hartografike të Planit në këtë rast të PRrH-së zona “Parku i Biznesit”- Prizren mund të ndryshohen plotësohen me vendim të autoritetit kompetent dhe ndryshim plotësimi duhet të miratohet nga Ministria. Kjo rrethanë mund të aplikohet vetëm nëse në Hartën Zonale të Komunës janë bërë ndryshim plotësime apo edhe përjashtime pasi të jetë miratuar Plani Rregullues i Hollësishëm, Autoriteti për planifikim hapësinor në këtë pjesë plotëson këto ndryshim plotësimet dhe përjashtimet.

Pjesa tekstuale dhe hartografike e Planit Rregullues të Hollësishëm mund të ndryshohet dhe të plotësohet, me kusht që ndryshim plotësimet nuk mund të ndryshojnë kushtet zhvillimore apo kushtet tjera të përcaktuara me dokumentet e planifikimit hapësinor të nivelit më të lartë.

Të gjitha propozimet për ndryshim plotësime i dorëzohen Autoritetit për planifikim hapësinor në format të shtypur dhe digjital (GIS).

14.2. Përjashtimet

Duhet sqaruar se në Planin Rregullues të Hollësishëm Zona e Veçantë "Parku i Biznesit" - Prizren, Përjashtimet – nënkuptojnë një devijim të lejuar nga kushtet zhvillimore apo kushtet ndërtimore, në përputhje me bazën ligjore.

Komuna e Prizrenit apo Autoriteti për planifikim hapësinor mund të lejojë përjashtime nga kushtet e rregullimit të hapësirës vetëm në rastet kur dëshmohet privimi nga mundësia e zhvillimit për një parcelë kadastrale, sipas paragrafit 3 të këtij Neni.

- Përjashtimi nga kushtet e rregullimit të hapësirës lejohet vetëm nëse kërkuesi dëshmon që ekziston "privimi" që e bën jashtëzakonisht të vështirë për pronarin e tokës të respektojë kushtet e rregullimit e hapësirës të përcaktuar dhe nuk ka të bëjë me nevojat apo dëshirat personale të pronarit të tokës.

Për të dëshmuar privimin e tillë duhen dëshmuar këto pika:

- Karakteristikat e veçanta të tokës që e bëjnë të pamundur për aplikuesin t'u përmbahet të gjitha kushteve për rregullimin e hapësirës;
- Përjashtimi kërkohet për shkak të gjendjes apo konfiguracionin unik të pronës, e jo kushteve të përgjithshme të lagjes apo sipërfaqes;
- Përjashtimi nuk mund të ketë efekt dëmtues mbi mjedisin apo sipërfaqen rrethuese;
- Privimi nuk është rezultat i veprimit të ndërmarrë nga pronari i tokës apo një pronar i mëparshëm;
- Përjashtimi nuk mund të krijojë ndikime negative në pronat fqinje apo pronat e tjera në afërsi duke ndikuar tek:
- Diellzimi dhe ajrosja e pronave fqinje;
- Trafik të shtuar dhe vështirësi në lëvizshmëri të trafikut publik dhe korridoreve të infrastrukturës në afërsi;
- Siguri publike duke përfshirë dhe rritjen e rrezikut nga zjarri apo rreziqet tjera të mundshme;
- Vlerat e pronave fqinje; dhe
- Shfrytëzim dhe zhvillim të pronave fqinje.

14.2.1. Përjashtimet për nevojat e personave me aftësi të kufizuara

Përjashtimi mund të lejohet me qëllim të mundësimit të qasjes në një parcelë dhe ndërtesë për një person me aftësi të kufizuara që punon në atë ndërtesë.

Përjashtimi mund të jetë i kufizuar me kohëzgjatjen e aftësisë së kufizuar apo për aq sa personi me aftësi të kufizuar punon në atë pronë.

Përjashtimet vendosen nga Autoriteti për planifikim hapësinor apo varësisht nga rasti dhe kompleksiteti i përjashtimit duhet të themelojë komision profesional i cili vlerëson dhe jep rekomandim lidhur me kërkesat për përjashtim.

Përjashtimet shqyrtohen edhe në dëgjim publik që është i hapur për publikun.

Procesverbali dhe vendimet nga dëgjimi publik publikohen në faqen zyrtare të internetit të komunës nga Autoritetit për planifikim hapësinor.

Dëgjimi publik mbahet në pajtim me procedurat e përcaktuara me Ligjin për Procedurën Administrative. Përjashtimet mund të lejohen vetëm nëse:

- Struktura dhe shfrytëzimi i tokës të propozuar të jetë në përputhje me kushtet për rregullimin e hapësirës të Planit Rregullues të Hollësishëm dhe kushtet zhvillimore të Hartës Zonale të Komunës përveç dispozitës specifike për të cilën kërkohet përjashtimi;
- Aplikuesi dëshmon kriteret e përcaktuara në këtë Nen.

Përjashtimi lejohet me kushte të veçanta sipas nevojës, për të parandaluar dëmet ndaj parcelave dhe strukturave të tjera përreth apo ndaj infrastrukturës së shërbimeve publike dhe për zvogëlimin e ndikimeve tjera negative.

Kushtet e veçanta përfshihen në vendimin për miratimin e përjashtimit dhe në lejen e ndërtimit që jepet në bazë të përjashtimit.

Shkelja e kushteve të përjashtimit është shkelje e Hartës Zonale të Komunës dhe Planit Rregullues të Hollësishëm.

Në rastet kur lejohet përjashtimi, kërkuesi prapë duhet të aplikojë për leje të ndërtimit sipas procedurës së rregullt. Aplikimi për leje ndërtimi dorëzohet brenda një (1) viti nga vendimi që lejon kushtet të veçanta përjashtuese, kurse pas këtij afati kohor përjashtimi bëhet i pavlefshëm.

14.3. Jokonformitetet

Jokonformiteti është shfrytëzim i tokës, ndërtimit apo parcelës kadastrale që ka ekzistuar para dhe nuk përputhet me kushtet për rregullimin e hapësirës të përcaktuara me Planin Rregullues të Hollësishëm.

Jokonformiteti që ka ekzistuar para miratimit të Planit Rregullues të Hollësishëm lejohet të vazhdojë edhe nëse nuk përputhet me e shfrytëzimeve e planifikuara të tokës dhe kushtet për rregullimin e hapësirës të përcaktuara me Planin Rregullues të Hollësishëm për aq sa ky jokonformitet vazhdon të plotësojë kërkesat e ligjeve tjera.

Rregulloret në fuqi që promovojnë shëndetin publik, sigurinë dhe mirëqenien, duke përfshirë por pa u kufizuar në, kërkesat e ndërtimit, mbrojtjes nga zjarri dhe mbrojtjes së shëndetit, vlejnë mbi ato jokonformitete.

Kushtet për rregullimin e hapësirës në Planin Rregullues të Hollësishëm zbatohen ndaj jokonformitetit nëse:

- Shfrytëzimi aktual jokonform shfrytëzimit të tokës ndërrohet; dhe
- Ndërtimi jokonform zgjerohet, ndryshohet apo rindërtohet në masë të madhe për arsye që nuk janë forcë madhore.

14.4. Zbatimi i bonuseve të zonimit

Plani Rregullues i Hollësishëm mund të përdoret për të zbatuar plotësisht apo pjesërisht bonuset e zonimit të përcaktuara me Hartën Zonale Komunale, norma teknike të planifikimit hapësinor, si dhe/ose me rregullore komunale.

Komunat mund të miratojnë rregullore për të përcaktuar dhe zbatuar bonuse të zonimit.

Bonuset e zonimit janë stimulime që jepen nga komuna në këmbim të ofrimit të një përfitimi publik. Bonuset e zonimit duhet të jenë brenda normave teknike të planifikimit hapësinor dhe përfshijnë si më poshtë:

- zvogëlim të kërkesave për tërheqje të vijave të ndërtimit;
- zvogëlim apo lirim nga taksat për leje ose tarifat për infrastrukturë;
- zvogëlim të kushtit për sipërfaqen minimale të parcelës, gjerësi dhe thellësi;

- rritje e përqindjes së sipërfaqes së shfrytëzueshmerisë së shputës në raport me parcelën kadastrale;
- rritje të lartësisë dhe kateve maksimale të ndërtesës;
- rritje të dendësisë; dhe
- stimulim i propozuar nga zhvilluesi ose komuna për të integruar dhe përmirësuar vendbanimet joformale.

Rregulloret e tilla komunale janë në përputhje me qëllimet, objektivat, vizionin dhe strategjitë e Planit Zhvillimor Komunal dhe përdoren për të:

- Rritur hapësirat e hapura ose sipërfaqet e gjelbra;
- Ofruar përmirësim të trafikut dhe lëvizje të këmbësorëve;
- Ruajtur sipërfaqet kulturore dhe historike;
- Ruajtur tokën bujqësore;
- Krijuar ndërtesa dhe hapësira publike dhe sociale prej të cilave përfiton komuniteti;
- Përfshirë dhe përmirësuar vendbanimet joformale; ose
- Ofruar mundësitë tjera të dëshiruara nga komuna në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal.

Rregulloret komunale përmbajnë:

- Përshkrimin e Bonusit të Zonimit që lejohet;
- Përshkrimin e strategjive me sqarime se si përfiton komuniteti nga Bonusi i Zonimit që është zgjedhur;
- Listën e të gjitha llojeve dhe kategorive të përfitimeve të komunitetit që mundtë pranohen nga zhvilluesit;
- Sipërfaqet dhe standardet për zhvillim të përfitimeve publike;
- Kërkesat për përfitimet publike do të vihen në dispozicion të përhershëm për komunitetin duke respektuar ligje dhe rregulloret përkatëse në fuqi përmes:
- Bartjes së pronësisë në komunë ose ndonjë organi tjetër publik ose
- Kërkesës që pronari i pronës të ofrojë mirëmbajtje të përhershme dhe ta mbajë të hapur për publikun së paku gjatë orarit zyrtar të punës;dhe
- Kërkesës që pronari i pronës të ofrojë garancion bankar duke garantuar zbatimin e bonusit të zonimit deri në marrjen e lejes së përdorimit, si për: bartje të pronësisë në komunë ose te ndonjë organ tjetër publik; ose kërkesës që pronari i pronës të ofrojë mirëmbajtje të përhershme dhe ta mbajë të hapur për publikun së paku gjatë orarit zyrtar të punës.
- Identifikimi i saktë i zonave në të cilat Bonuset e Zonimit mund të lejohen ;
- Procedurat për zbatimin e Bonusit të Zonimi ; dhe
- Dispozitat për të siguruar njoftim dhe shqyrtimin publik për projektin e propozuar që është përcaktuar sipas Nenit 36 të Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr. 24/2015 Mbi Elementet Dhe Kërkesat Themelore Për Hartimin, Zbatimin Dhe Monitorimin E Hartës Zonale Të Komunës.

Për të zbatuar çfarëdo Bonusi të Zonimit, komuna dhe aplikuesi do të:

- Nënshkruajnë marrëveshje për zhvillim, me qëllim të përcaktimit të bonuseve të sakta ose stimulimeve të tjerë që pranon zhvilluesi dhe përfitimin e saktë publik të cilin zhvilluesi ofrojë në këmbim për këto bonuse ose stimulime;
- Publikimin e të gjitha marrëveshjeve për zhvillim në faqen zyrtare elektronike të komunës;

- Vlerësimin nëse infrastruktura publike ekzistuese që do të shërbejë për densitetin e shtuar mund të jetë e kënaqshme për zhvillimin shtesë; dhe
- Sipas kërkesave ligjore mjedisore përgatitet vlerësimi i ndikimit në mjedis për përmbajtjen e propozuar.

14.5. Interpretimi dhe ankesat

14.5.1. Interpretimi

Planet Rregulluese të Hollësishme janë të hollësishme dhe gjithëpërfshirëse.

Autoriteti për planifikim hapësinor është përgjegjës për interpretime lidhur me Planet Rregullues të Hollësishëm, por nuk ka për qëllim të ndryshojë apo shtojë përmbajtjen thelbësore të Planit Rregullues të Hollësishëm.

Autoriteti për planifikim hapësinor shqyrton dhe merr vendimin përfundimtar me shkrim mbi kërkesat me shkrim për interpretim të Planit Rregullues të Hollësishëm brenda 30 ditësh.

14.5.2. Ankesat

Ankesat ndaj vendimeve që ndërlidhen me këtë Udhëzim Administrativ mund të bëhen në pajtim me Ligjin për Procedurën Administrative.

14.6. Zbatimi dhe monitorimi

14.6.1. Zbatimi

Kuvendi i Komunës është përgjegjës për alokimin e fondeve për zbatimin e PRrH-së.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor, bashkërendon aktivitetet e zbatimit dhe monitorimit të PRrH-së.

Drejtoritë komunale sektoriale zbatojnë dhe monitorojnë aktivitetet sektoriale përkatëse të tyre sipas Procesit të monitorimit dhe vlerësimit në Planin e Veprimit.

Drejtoritë sektoriale hartojnë dhe dorëzojnë raportet sektoriale vjetore për zbatimin dhe monitorimin e PRrU-së tek autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor harton dhe dorëzon raportin vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e PRrU-së, për miratim tek Kuvendi i Komunës.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor, dorëzon raportin e miratuar vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e PRrU-së në Ministri.

Çdo vit, sipas Planit të Zbatimit prezantohen projeksionet e kostos për zbatim para autoritetit për buxhet e financa, që duhen konsideruar në pajtim me procedurat për përfshirje në buxhetin e vitit vijues.

14.6.2. Monitorimi

Kuvendi i Komunës është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit Rregullues të Hollësishëm në bashkërendim dhe bashkëpunim me drejtoritë tjera përkatëse sektoriale përgjegjëse.

Raportet vjetore monitoruese të zbatimit bazohen në treguesit dhe procesin e monitorimit dhe vlerësimit të përcaktuar në Planin e Zbatimit.

Drejtoritë sektoriale të komunës çdo vit hartojnë Raportin Monitorues të Zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të deklaruara në Planit Rregullues të Hollësishëm dhe e dorëzojnë atë në Kuvendin Komunal për shqyrtim dhe miratim.

Kuvendi i Komunës pas shqyrtimit dhe miratimit të raportit monitorues, obligon Autoritetin përgjegjës për planifikim të dorëzon çdo vit në Ministri një raport informues mbi gjendjen e zbatimit të Planit Rregullues të Hollësishëm;

Raportet vjetore të monitorimit përmbajnë rekomandime për veprim që i paraqiten Kuvendit të Komunës, Kryetarit të Komunës dhe Ministrisë, me statistikat financiare në lidhje me çështjet e Planit Rregullues të Hollësishëm, në baza vjetore, dhe për rishikimet pesë (5) apo tetë (8) vjeçare.

14.7. Dispozitat kalimtare

Komuna obligohet të zbatoj këtë plan ose të merr vendimet e duhura që të marri masa të përkohshme adekuate që ta veje zonën nën menaxhim të plotë.

PJESA HARTOGRAFIKE

NËNZONAT URBANE
URBAN SUBZONES
URBANE PODZONA

NZ=D1
NZ=D2
NZ=A1
NZ=A8
NZ=A2
NZ=A9
NZ=A7
NZ=A3
NZ=A10
NZ=A13
NZ=A6
NZ=A4
NZ=A11
NZ=A5
NZ=A14
NZ=A12
NZ=A16
NZ=A15
NZ=E1
NZ=B1
NZ=E1
NZ=E2
NZ=B2
NZ=B3
NZ=E1
NZ=C1
NZ=C2

Legjenda

- Rruget

NËNZONAT

- NZ=A
- NZ=B
- NZ=C
- NZ=D
- NZ=E
- Kufiri PRRH



KOMUNA E PRIZRENIT

INSTITUTI "INSI" -PRISHTINË

"PARKU I BIZNESIT" - PRIZREN

TITULLI I HARTËS **NËNZONAT URBANE**

A1+

01

P = 1:2500

N W E S

80 40 0 80 m

KATEGORIZIMI I RRUGËVE

THE CATEGORY OF ROAD

KATEGORIZACIJA PUTA

Legjenda

Kategoria

- Rrugë
- Nacionale
- Rrugë brenda bllokut
- Rrugë për qasje
- Rrugë përmbledhëse
- Kufiri PRRH



KOMUNA E PRIZRENIT

INSTITUTI "INSI" -PRISHTINË

"PARKU I BIZNESIT" - PRIZREN

TITULLI I HARTËS **KATEGORIZIMI I RRUGËVE**

A1+

02

P = 1:2500

N W E S

80 40 0 80 m

















PROFILET E RRUGËVE
PROFILES OF THE ROADS
PROFILI PUTEVA

KOMUNA E PRIZRENIT

INSTITUTI "INSI" -PRISHTINË

"PARKU I BIZNESIT" - PRIZREN

TITULLI I HARTËS **PROFILET E RRUGËVE**

A1+
03

P = 1:2500

50 25 0 50 100 150 200 m

PLANI I NIVELIMIT

LEVELING PLAN

PLAN NIVELISANJE



Legjenda

- Izohipset
- Rruget

Nënzonat

- Nënzonat
- Kufiri PRRH

KOMUNA E PRIZRENIT

INSTITUTI "INSI" -PRISHTINË

"PARKU I BIZNESIT" - PRIZREN

TITULLI I HARTËS	**PLANI I NIVELIMIT**	A1+
P = 1:2500		**04**

50 25 0 50 100 150 200 m

SHFRYTËZIMI I PLANIFIKUAR I TOKËS
DESTINATION OF AREAS
DESTINACIJA OBLASTI SA

Legjenda

- Rruget

Shfrytëzimi i planifikuar i tokës

- Banim Individual dhe Prodhime Zejtare
- Gjelbrim, Sport, Rekreacion dhe Argëtim
- Gjelbërim
- Hoteleri
- Nënzonë Industriale
- Nënzonë Komerciale
- Sallë për konferenca
- Servisë, Shërbime dhe Deponim
- Servisë, Shërbime, Prodhim Zejtarë
- Servisë, Shërbime, Prodhim Zejtarë, Inkubatorë
- Lum/prrua
- Kufiri PRRH

KOMUNA E PRIZRENIT

INSTITUTI "INSI" -PRISHTINË

"PARKU I BIZNESIT" - PRIZREN

TITULLI I HARTËS
SHFRYTËZIMI I PLANIFIKUAR I TOKËS

A1+
05

P = 1:2500

50 25 0 50 100 150 200 m



NZ=D3
NZ=D1
NZ=A1
NZ=D2
NZ=A8
NZ=A2
NZ=A9
NZ=A7
NZ=A3
NZ=A10
NZ=A13
NZ=A6
NZ=A4
NZ=A11
NZ=A5
NZ=A14
NZ=A12
NZ=A16
NZ=E1
NZ=A15
NZ=B1
NZ=E1
NZ=E2
NZ=B2
NZ=B3
NZ=E1
NZ=C1
NZ=C2

VIJA RREGULLUESE DHE NDËRTIMORE

REGULATION AND CONSTRUCTION LINE
REGULATIVNA I GRAĐEVINSKA LINIJA

Legjenda

- Vija_rregulluese
- **Vija ndërtimore**
- Vn=5m
- Vn=10m
- Vn=15m
- Vn=20m
- Kufiri PRRH
- Rruget



KOMUNA E PRIZRENIT

INSTITUTI "INSI" -PRISHTINË

"PARKU I BIZNESIT" - PRIZREN

TITULLI I HARTËS
VIJA RREGULLUESE DHE NDËRTIMORE

A1+
06

P = 1:2500

50 25 0 50 100 150 200 m

PLANI I RIPARCELIMIT TË ZONËS

LAND CONSOLIDATION PLAN FOR THE AREA

PLAN REKOMASACIJE PODRUČJA



Legjenda

- Rruget
- Riparcelimi
- Kufiri PRRH

KOMUNA E PRIZRENIT

INSTITUTI "INSI" -PRISHTINË

"PARKU I BIZNESIT" - PRIZREN

TITULLI I HARTËS **PLANI I RIPARCELIMIT TË ZONËS**

A1+

07

P = 1:2500

50 25 0 50 100 150 200 m

KUSHTET E RREGULLIMIT

TERMS OF REGULATION

REGULATVNI USLOVI

NZ=A1
ISHKPZH=70%
ISN=1.2
P+2 + NK

NZ=A2
ISHKPZH=70%
ISN=1.2
P+2 + NK

NZ=A3
ISHKPZH=70%
ISN=1.2
P+2 + NK

NZ=A4
ISHKPZH=70%
ISN=1.2
P+2 + NK

NZ=A5
ISHKPZH=70%
ISN=1.2
P+2 + NK

NZ=A6
ISHKPZH=70%
ISN=1.2
P+2 + NK

NZ=A7
ISHKPZH=70%
ISN=1.2
P+2 + NK

NZ=A8
ISHKPZH=70%
ISN=1.2
P+2 + NK

NZ=A9
ISHKPZH=70%
ISN=1.2
P+2 + NK

NZ=A10
ISHKPZH=70%
ISN=1.2
P+2 + NK

NZ=A11
ISHKPZH=70%
ISN=1.2
P+2 + NK

NZ=A12
ISHKPZH=70%
ISN=1.2
P+2 + NK

NZ=A13
ISHKPZH=70%
ISN=1.2
P+2 + NK

NZ=A14
ISHKPZH=70%
ISN=1.2
P+2 + NK

NZ=A15
ISHKPZH=70%
ISN=1.2
P+2 + NK

NZ=A16
ISHKPZH=70%
ISN=1.2
P+2 + NK

NZ=D1
NZ=D1
ISHKPZH=60%
ISN=1.0
P+2 + NK

NZ=E1
ISHKPZH=50%
ISN=1
P+2

NZ=B1; ISHKPZH=40%; ISN=0.8; P+2 + NK

NZ=B2; ISHKPZH=40%; ISN=0.8; P+2 + NK

NZ=B3; ISHKPZH=40%; ISN=0.8; P+2 + NK

NZ=C1; ISHKPZH=60%; ISN=1.0; P+2 + NK

NZ=C2; ISHKPZH=60%; ISN=1.0; P+2 + NK

NZ=E

Legjenda

- Vija rregulluese

Vija ndertimore

- Vn=5m
- Vn=10m
- Vn=15m
- Vn=20m
- Rruget
- Riparcelimi
- Kufiri PRRH



KOMUNA E PRIZRENIT

INSTITUTI "INSI" -PRISHTINË

"PARKU I BIZNESIT" - PRIZREN

TITULLI I HARTËS

KUSHTET E RREGULLIMIT

A1+

08

P = 1:2500

50 25 0 50 100 150 200 m

RRJETA ELEKTROENERGJETIKE

ELECTRIC POWER GRID
ELEKTROMREŽA

KOMUNA E PRIZRENIT

INSTITUTI "INSI" -PRISHTINË

"PARKU I BIZNESIT" - PRIZREN

TITULLI I HARTËS **RRJETA ELEKTROENERGJETIKE**

A1+
09

P = 1:2500

N

50 25 0 50 100 150 200 m

RRJETI I UJËSJELLËSIT

WATER SUPPLY NETWORK
VODOVODNA MREŽA

KOMUNA E PRIZRENIT

INSTITUTI "INSI" -PRISHTINË

"PARKU I BIZNESIT" - PRIZREN

TITULLI I HARTËS

RRJETI I UJËSJELLËSIT

A1+

10

P = 1:2500

50 25 0 50 100 150 200 m

KANALIZIMI I UJRAVE
TE ZEZA DHE ATMOSFERIKE

KOMUNA E PRIZRENIT

INSTITUTI "INSI" -PRISHTINË

"PARKU I BIZNESIT" - PRIZREN

TITULLI I HARTËS

KANALIZIMI I UJRAVE
TE ZEZA DHE ATMOSFERIKE

A1+

11

P = 1:2500

50 25 0 50 100 150 200 m

P R O P O Z I M

Që në bazë të nenit 52 paragrafi 52.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe në pajtim me nenin 60 të Statutit të Kuvendit të Komunës, Kryetari i Komunës së Prizrenit, i propozon Komitetit për Politikë dhe Financa shqyrtimin e Projekt dokumentit - Plani Rregullues i Hollësishëm (PRRH) "Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit", sipas Hartë Zonale të Komunës së Prizrenit, me propozim që Komiteti për Politikë e Financa pas shqyrtimit të:

PROPOZOJË

Kuvendit të Komunës së Prizrenit që konform nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (d), e lidhur me nenin 17, shkronja a) dhe b), nenit 40, shkronja l), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 10 paragrafi 2, nën paragrafi 2.1 dhe 2.3, neni 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe 1.6, si dhe nenit 17 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174, të datës 31.07.2013, e lidhur me dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MMPHI-së Nr. 01/18 për Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme, Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, si dhe nenit 25 paragrafi 1, shkronja ll) dhe m) dhe paragrafi 2 shkronja b), e lidhur me nenin 27 paragrafi 1, të Statutit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, Nr. 01/011-5643, të datës 15 tetor 2008, si dhe Vendimit për Miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2022-2030, Nr. 001/011-48192, të datës 31.03.2022, ashtu që Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më ..... nëntor 2024, të miratoi këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM (PRRH) "ZONA E PARKUT PËR INDUSTRI TË LEHTË NË PRIZREN - PARKU I BIZNESIT", sipas Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit

Neni 1

Miratohet Plani Rregullues i Hollësishëm (PRRH) "Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit", sipas Hartë Zonale të Komunës së Prizrenit.

Neni 2

Planet Rregulluese të Hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane apo rurale, si çështje e përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale Komunale.

Neni 3

Me miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm (PRRH) "Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit", sipas Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të zhvillimit ekonomik dhe harmonizimi i tyre me nevojat reale dhe me mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, si dhe rregullimin dhe ndërtimin e zonës për të cilën hartohet plani.

Neni 4

Plani Rregullues i Hollësishëm përmban pjesën tekstuale dhe hartografike.

Neni 5

Zona për të cilën është hartuar Plani Rregullues i Hollësishëm përfshin një sipërfaqe prej S= 80.445 ha, e cila është e përcaktuar si Zonë e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit, sipas Hartë Zonale të Komunës së Prizrenit.

Neni 6

Bartës i Hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm (PRRH) "Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit", sipas Hartë Zonale të Komunës së Prizrenit, është Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor në Komunën e Prizrenit.

Neni 7

Plani Rregullues i Hollësishëm mbulon një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

Neni 8

Plani Rregullues i Hollësishëm (PRRH) "Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit", sipas Hartë Zonale të Komunës së Prizrenit është në gjuhë zyrtare dhe së paku në 3 (tri) kopje të shtypura dhe të vulosura dhe 3 (tri) kopje digjitale të origjinalit.

Neni 9

Ky vendim, hynë në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në web-faqen e Komunës.

KOMUNA E PRIZRENIT
Kuvendi i Komunës
Nr: _____
Më: .11.2024
P r i z r e n

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

RAPORTI FINANCIAR

PËR PERIUDHËN JANAR –QERSHOR 2024

Korrik 2024
Prizren

PËRMBAJTJA

I. TË HYRAT E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT KOMUNAL 3-4

II. TË HYRAT VETANAKE KOMUNALE 6-9

i. Pasqyra e arkëtimit të të hyrave vetanake gjatë periudhes Janar-Qershor 2024
ii. Pasqyra e ecurisë së realizimit të të hyrave sipas muajve
iii. Pasqyra krahasuese e planifikimit dhe realizimit të të Hyrave Vetanake për periudhën Janar-Qershor 2022,2023 dhe 2024
iv. Grafiku I ecurisë së arkëtimit të të hyrave vetanake sipas muajve në vitin 2024

III. SHPENZIMET E BUXHETIT KOMUNAL 10-18

A. Shpenzimet e përgjithshme

i. Shpenzimet në kategorinë e investimeve kapitale sipas drejtorive
ii. Pasqyra krahasuese e shpenzimeve të Komunës, sipas kategorive, për periudhën Janar-Qershor për vitet 2022, 2023 dhe 2024
iii. Grafiku I ecurisë së shpenzimeve sipas muajve në vitin 2024

B. Shpenzimet sipas Kategorive dhe Drejtorive:

i. Drejtoria e Administratës Komunale
ii. Drejtoria Komunale e Shëndetësisë
iii. Drejtoria Komunale e Arsimit
iv. Drejtoria e Shërbimeve Sociale

IV. PASQYRA E TË HYRAVE VETANAKE 19-20

V. PASQYRAT E SHPENZIMEVE 21-36

i. Shpenzimet sipas Kategorive dhe Drejtorive
ii. Raporti Përmbledhës I Kontrollit të Buxhetit

REALIZIMI I BUXHETIT KOMUNAL
PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2024

Të hyrat	Buxheti i miratuar 2024	Buxheti me ndryshime 2024	Alokimi I-VI-2024	Shpenzimet I-VI-2024	Buxheti i pashpenzuar I-VI-2024	Alokimi i pashpenzuar I-VI-2024	Ind. Alok/ plan	Ind. Shp./ plan	Ind. Shp./ Alok.
Granti qeveritar 2024	55,008,685	55,008,685	43,108,154	26,902,550	28,106,135	16,205,604	78.37	48.91	62.41
Të hyrat vetanake 2024	10,193,294	10,193,294	4,026,399	2,960,260	7,233,034	1,066,139	39.50	29.04	73.52
Të hyrat vetanake te bartura nga 2023	-	783,653	783,653	265,784	517,870	517,870	100.00	33.92	33.92
Te hyrat nga donacionet e brendshme - participimi	-	469,015	469,015	20,900	448,115	448,115	100.00	4.46	4.46
Donacionet e jashtme	-	368,198	368,198	189,862	178,337	178,337	100.00	51.57	51.57
Financimet nga huamarrjet	-	1,000,000	1,000,000		1,000,000	1,000,000	100.00	-	-
Totali	**65,201,979**	**67,822,845**	**49,755,419**	**30,339,355**	**37,483,490**	**19,416,064**	**73.36**	**44.73**	**60.98**

Në gjashtë muajt e parë të vitit 2024, granti qeveritar është alokuar në shumën prej 43,108,154€, pra 78.37% e shumës së planifikuar për vitin aktual (55,008,685€). Shuma e shpenzuar nga ky burim i Buxhetit komunal është 26,902,550 € ose 48.91% e shumës së paraparë për sivjet .

Për periudhën Janar-Qershor të vitin 2023 nga granti qeveritar janë alokuar 41,321,114 € kurse janë shpenzuar 22,951,948 € .

Gjatë periudhës janar- qershor 2024 të hyrat vetanake janë alokuar në shumë prej 4,026,399 € ose 39.50% nga planifikimi prej 10,193,294€. Nga kjo shumë janë shpenzuar 2,960,260 € ose 29.04% e shumës së planifikuar.

Të hyrat vetanake, në periudhën e njëjtë të vitit 2023, janë alokuar në shumën prej 4,714,894€. Shpenzimet nga kjo kategori e të hyrave kanë qenë 2,940,969€ .

Deri në këtë periudhë të raportimit alokimi i të hyrave vetanake të bartura nga viti paraprak ka qenë 783,653€. Nga kjo shumë janë shpenzuar 265,784€, pra 33,92% e shumës së planifikuar.

Në periudhën Janar-Qershor 2023 alokimi i të të hyrave vetanake të bartura nga viti paraprak ka qenë 3,817,543 €. Nga kjo shumë janë shpenzuar 986,664 €.

Të hyrat prej participimit me popullatën, në periudhën janar- qershor 2024, janë alokuar në shumën prej 469,015 €. Shpenzimet nga ky burim kanë qenë 20,900 €.

Nga participimi me qytetarë, në periudhën e njëjtë në vitin 2023, janë alokuar 444,686 €. Shpenzimet nga ky burim i të hyrave kanë qenë 8,760 €.

Gjatë periudhës Janar-Qershor të vitit 2024, nga kategoria e të hyrave nga donatorët e jashtëm janë alokuar 368,198 €. Shpenzimi nga ky burim i te hyrave ka qenë në shumë prej 189,862 €.

Në periudhën e njëjtë të vitit paraprak nga donatorët e jashtëm janë alokuar 106,999 € dhe janë shpenzuar 5,703 €.

Gjatë periudhës Janar- Qershor 2024 të hyrat nga financimi nga huamarrjet janë alokuar në shumë prej 1,000,000 €. Shpenzim nga këto të hyra nuk ka patur.

Në Buxhetin e Komunës për vitin 2023, si burim i të hyrave është planifikuar edhe financimi nga huamarrjet në shumë prej 3,000,000 € . Alokim dhe shpenzim nga këto të hyra nuk ka patur.

Të ardhurat totale të alokuara të buxhetit komunal për periudhën Janar-Qershor të vitit 2024 janë 49,755,419 € , nga 67,822,845 € të parashikuara. Nga ky buxhet janë shpenzuar 30,339,355 € ose 44,73 % e shumës së planifikuar (67,822,845 €) .

Në peiudhën e njëjtë të vitit paraprak të hyrat e tërësishme të alokuara, në shumë prej 50,405,236 €, kanë qenë për 649,816.66 € më shumë se sivjet. Shpenzimi i tërësishëm i buxhetit ka qenë 26,894,043€.

Grafiku i të hyrave të alokuara te Buxhetit Komunal për periudhën Janar-Qershor 2024:



Grafiku i shpenzimeve te Buxhetit Komunal për periudhën Janar-Qershor 2024 sipas burimeve te financimit:



TË HYRAT VETANAKE TË BUXHETIT KOMUNAL
PER PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2024

	Planifikimi 2024	%	Realizimi I-VI-2024	%	Ind.
Liçensat komerciale dhe të biznesit / Lejet	30,000	0.29	10,188.45	0.23	33.96
Shfrytëzimi i tokës dhe lejet e ndërtimit	2,050,000	20.11	1,214,566.87	27.03	59.25
Inspektimi i tokës dhe aktivitetet gjeodezike	200,000	1.96	65,054.00	1.45	32.53
Shërbimet e inspektimit të Shëndetit dhe Sigurisë	265,000	2.60	190,260.84	4.23	71.80
Shfrytëzimi i pronës Komunale	175,000	1.72	88,468.31	1.97	50.55
Pagesat në lidhje me automjetet	1,600,000	15.70	455,483.93	10.14	28.47
Çertifikatat dhe dokumentet zyrtare	600,000	5.89	239,417.50	5.33	39.90
Tatimi në pronë	3,203,294	31.43	1,416,723.08	31.53	44.23
Të ardhurat tjera	150,000	1.47	35,624.50	0.79	23.75
Menaxhimi I mbeturinave	1,200,000	11.77	566,418.31	12.61	47.20
Totali i të hyrave vetanake të Adm. Lokale	**9,473,294**	**92.94**	**4,282,205.79**	**95.31**	**45.20**
Shendetesia	230,000	2.26	119,220.75	2.65	51.84
Arsimi	470,000	4.61	89,178.50	1.98	18.97
Te hyrat nga Biblioteka	10,000	0.10	1,558.00	0.03	15.58
Te hyrat ngaTeatri	10,000	0.10	711.50	0.02	7.12
Totali i të hyrave vetanake	**10,193,294**	**100.00**	**4,492,874.54**	**100.00**	**44.08**

Verejtje: të hyrat nga gjobat e trafikut për tremujorin e dytë nuk janë të përfshira në këtë raport për shkak të vonesës së regjistrimit në sistem.

Në tabelën e mësipërme janë dhënë të hyrat vetanake të realizuara për periudhën Janar-Qershor 2024 të kategorizuara në bazë të grupeve.

Shuma e tërësishme e arkëtuar e të hyrave vetanake komunale për këtë periudhë të raportimit është 4,492,875 € ose 44.08% e shumës së planifikuar prej 10,193,294 € .

Realizimi i të hyrave në krahasim me planifikimin është i kënaqshëm sa i përket pagesave te: Shfrytëzimi i tokës dhe lejet e ndërtimit (59.25%), Shërbimet e inspektimit të Shëndetit dhe Sigurisë (71.80%), Tatimi në pronë (44.23%), Menaxhimi i mbeturinave (47.20%), Te hyrat në Shëndetësi (51.84%).

Realizimi i të hyrave në krahasim me planifikimin është jo aq i kënaqshëm në arkëtimin e të hyrave nga: Inspektimi i tokës dhe aktivitetet gjeodezike (32.53%), Pagesat në lidhje me automjetet (28.47%) Të hyrat nga të ardhurat tjera (23.75 %), Arsimi (18.97%), Te hyrat nga Biblioteka (15.58%), Te hyrat nga Teatri (7.12%)..

Në po të njëjtën periudhë të vitit të kaluar të hyrat vetanake janë arkëtuar në shumë prej 5,613,776.11 € ose 1,120,901.57 € më shumë se sivjet.

-Mbikëqyrja e planeve të punës dhe procesit edukativo - arsimor; kontrollimi i funksionimit të organeve të shkollës etj;

-Bashkëpunimi me prindër, Ekipet e EPRBM të shkollës, këshilli i prindërve dhe këshilli i nxënësve;

-Monitorimi i 35 shkollave për të kontrolluar plotësimin e standardeve për krijimin e mjedisit gjithëpërfshirës të përshtatshëm të mësimdhënies dhe të nxënit;

-Kontrollimi i orarit të ndjekjes ditore dhe javore të mësuesve në shkolla;

-Vlerësimi i brendshëm i shkollës në shkallë kurrikulare – “Monitorimi i nxënësve të shkollave të komunës së Prizrenit;

-Vlerësimi i brendshëm- Kontrollimi i dokumenteve të koordinatorëve të cilësisë së shkollave;

-Kontrollimi i vlerësimit të brendshëm të shkollave;

-Vlerësim i brendshëm i performancës së drejtorit të shkollës “Hasim Maliqi” dhe shkollës “Zenun Çoçaj”;

-Monitorimi i funksionimit të mjeteve teknologjike i 22 shkollave;

-Furnizimimi me robotë në 43 shkollave;

Pjesëmarrja në garën KOSOVA MAKERS LEAGUE OPEN 2023– 24;

Trajnime

-Trajnimi i mësimdhënësve me temë “Super shkolla”;

-Trajnimi i mësimdhënësve me temë “Metodologji interaktive e mësimdhënies”;

-Trajnimi i mësimdhënësve me temë “Planifikimi i mësimdhënies produktive”;

-workshop “Skills sustainable jobs in Kosova”;

SUBVENCIONET

-Për vitin shkollor 2023/24 DKA me mbështetjen e kryetarit të Komunës është rritur numri i bursave në 180. Vlera e bursës për studentë është 700 Euro.

-Për vitin shkollor 2023/24, DKA ka ndarë 134 bursa nga 300 Euro për nxënës të shkollave të mesme, për fëmijët e invalidëve të luftës, veteranëve, rasteve sociale dhe nxënës udhëtarë.

Matura Shtetërore 2024 afati i qershorit

Në bazë të Ligjit mbi Maturën Shtetërore Nr. 05/L-018, UA 04/2016 dhe UA 05/2016 Detyrat dhe përgjegjësit e administrueseve dhe komisioneve të qendrave të testimit, Vendimit të Ministrit të Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) me nr. 01B-039 të datës 17.04.2024, njoftimit të DVSM në MASHTI për mënyrën e paraqitjes së provimit të maturës përmes platformës e-Kosova, DKA në Prizren ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme organizative për mbajtjen e Maturës Shtetërore 2024, që mbahet më **22 qershor 2024 (**afati parë).

Sipas udhëzimeve të DVSM në MASHTI, prej DKA është kërkuar të caktohen koordinatorët e shkollave për Maturën Shtetërore, ku pastaj nxënësit individualisht pasi janë regjistruar në platformën e-Kosova, kanë paraqitur provimin e maturës, dhe DVSM ka shpërndarë listën e nxënësve të të gjitha shkollave nëpër qendrat e ndryshme të testimit. Përmes platëformës e-Kosova kanë paraqitur provimin 1926 maturantë nga të gjitha shkollat e mesme të larta të Komunës së Prizrenit.

Nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren janë caktuar 16 Qendra të Testimit dhe janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për mbarëvajtje më të mirë të maturës shtetërore.

Testit do ti nënshtrohen **1926 maturantë dhe atë 1690 maturantë të komunitetit shqiptarë, 128 maturantë të komunitetit boshnjak dhe 108 maturantë të komunitetit turk**. Janë caktuar komisionet e DKA-së nëpër Qendra të Testimit dhe **63 administruesit** e Provimit të Maturës Shtetërore nga shkollat e

komunës sonë kanë administruar Testin e Maturës Shtetërore në komunat e Suharekës, Dragashit dhe të Mamushës.

Në të gjitha Qendrat e Testimit procesi ka shkuar në nivel të mirë, përjashtimisht në disa qendra testimi ka filluar me vonesë, për shkak të vonesës së komisioneve dhe testeve nga MASHTI.

Pra, kalueshmëria e provimit të maturës shtetërore në nivel komune në afatin e qershorit është **78.98%**, kemi rritje të kalueshmërisë për **7.98%** nga viti kaluar.

REZULTATI I TESTIT TË MATURËS SHTETËRORE Qershor 2024

Rezultati i Maturës Afati_qershor 2024		Nxënësit që kanë hy në test			Nxënës që kaluan testin			Përqindja e kalueshmërisë (mbi 40% e pragut)
Nr.	Shkolla	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	
1	Gjimnazi "Gjon Buzuku"	134	211	345	131	203	334	96.81
2	Gjimnazi "Remzi Ademaj"	87	197	284	71	131	202	71.13
3	SHMM "Luciano Motroni"	91	289	380	82	250	332	87.37
4	SHME "Ymer Prizreni"	101	92	193	69	37	106	54.92
5	SHMM "Lorenc Antoni"	15	15	30	10	12	22	73.33
6	Qendra e Kompetencës	17	23	40	13	12	25	62.50
7	SHMT "11 Marsi"	223	117	340	155	71	226	66.47
8	Medreseja "Alauddin"	12	34	46	11	25	36	78.26
9	"Loyola" Gymnazium	49	59	108	49	59	108	100.00
10	College "Mehmet Akif"	18	28	46	16	23	39	84.78
11	Maarif School International	16	20	36	13	18	31	86.11
12	Q.B. "Nënë Tereza"	2	1	3	1	0	1	33.33
	Gjithsej	765	1086	1851	621	841	1462	78.98
					81.18	77.44	78.98	
					%meshkuj	%femra		

Testi i Arritshmërisë për nxënësit e klasëve të nënta (IX)

Testi i Arritshmërisë për nxënësit e klasëve të nënta

Është përmbyllur me sukses testi i arritshmërisë, ku rreth 99 për qind e nxënësve i janë nënshtruar testit të arritshmërisë. Për organizimin e testit të arritshmirisë DKA në bashkëpunim me MASHTI dhe institucionet shkollore kanë bërë përzgjedhjen e qendrave të testimit, ndarjen e nxënësve sipas qendrave dhe përzgjedhjen e koordinatorëve dhe administratorëve.

Jemi në pritje të rezultateve të nxënësve.

Infrastruktura në shkollat e komunës

Njësia teknike pranë DKA-së ka vazhduar punët edhe në këto 6 muajt e parë të vitit 2024 me realizimin e projekte dhe planifikimin e projekteve të reja, përfshirë furnizimin me mallra dhe dhënie të shërbimeve të shkollave, si dhe ka monituar punimet (nga investimet kapitale) që janë bërë në ndërtimin e objekteve shkollore. Janë realizuar aktivitetet e ndryshme si vijon:

- Kompletimi dhe dorëzimi i dokumentacionit të inventarizimit të shkollave dhe DKA-së tek zyrtarët në Drejtorinë e Financave,
- Vizitat e rregullta nëpër shkolla për verifikimin e pastërtisë dhe higjienës,
- Vizita të rregullta në çerdhen e fëmijeve për të evidentuar kërkesat lidhur me infrastrukturë dhe mallëra.
- Janë mbajtur takimet konsultative me operatorët ekonomikë – punëkryesit lidhur me ndërtimin e objekteve shkollor.
- Janë mbikqyrë punimet e projekteve të cilat vazhdojne nga vitet e kaluara.

1. **Ndërtimi i objektit të ri shkollor "Pllanjane" në Pllanjanë**

(Mjetet e planifikuara per vitin 2024 ne vlere prej 59,746.00€. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 54,185.06€ / 90.69% realizim)

Punimet kanë përfunduar dhe është bërë pranimi teknik i punimeve. Po ashtu është realizuar edhe pagesa përfundimtare.

2. **Ndërtimi i objektit të ri shkollor "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" (ish Pjeter Mazrreku) në Mazrrek**

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 140,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 80,000.00€ / 57.14% realizim)

Punimet janë duke vazhduar. Deri me tani jane realizuar kryesisht punimet e vrazhda të betonit në tri nivele-etazhe. Poashtu etazha e parë dhe e dyte

pjesërisht janë muratuar. Punimet, për shkak të planifikimit të buxhetit, do të zgjasin deri në vitin 2025.

3. **Ndërtimi i objektit të ri shkollor në Krushe të Vogël**

(Mjetet e planifikuara per vitin 2024 ne vlere prej 191,589.00€. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 60,000.00€ / 31.93% realizim)

Punimet janë duke vazhduar. Punimet e fazës së parë pritet të përfundojnë gjatë vitit 2024, ndërsa për punimet e fazës së dytë është shpallë tenderi përkatës dhe punimet do të vazhdojne edhe gjatë muajve te vitit 2024 varësisht nga buxheti. Objekti, sipas planifikimit, do të jetë në funksionim gjatë vitit 2025.

4. **Ndërtimi i objektit të ri shkollor (9 klasëshe) në Gjonaj të Hasit**

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 24,779.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 19,228.93€ / 77.61% realizim)

Punimet kanë përfunduar dhe është bërë pranimi teknik i punimeve. Po ashtu është realizuar edhe pagesa përfundimtare.

5. **Ndërtimi i aneksit të objektit të objektit shkollor "Ardhmëria" në Landovicë**

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 240,219.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 240,219.00€ / 100% realizim)

Të gjitha punimet janë realizuar dhe është bërë pranimi teknik.

Pjesa e mbetur për pagesë prej 24,779.20€ është e planifikuar dhe realizuar gjatë muajit shkurt të vitit 2024.

6. **Ndërtimi i aneksit të shkollës në Vermicë**

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 223,333.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 60,000.00€ / 26.86% realizim)

Deri me tani janë realizuar punimet e vrazhda (shtylla, traje, mure dhe pllaka ne tri nivele, bodrum, përdhesë dhe etazhe. Punimet janë duke vazhduar edhe në renovimin e objektit aneksit të vjetër. Në bazë të planifikimit të buxhetit, puniumet pritet të perfundojnë gjatë tremujorit të fundit te vitit 2024.

7. **Ndërtimi I sallës së edukatës fizike në shkollën "Haziz Tola" në Lagjen Jeta e Re - Prizren - faza e dytë**

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 67,147.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 67,147.00€ / 100% realizim)

Të gjitha punimet janë realizuar dhe është bërë pranimi teknik.

8. **Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën "Fatmir Berisha" në Lagjen Bajram Curri , Prizren - faza e dytë**

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 75,555.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 59,998.27€ / 79.41% realizim)

Punimet janë duke u realizuar sipas planifikimit, kryesisht punime ne suvatim dhe patinim të mureve, punime të dyshemeve me pllaka, izolime, etj. Punimet janë duke vazhduar. Në bazë të planifikimit të buxhetit, puniumet pritet të përfundojn gjatë tremujorit të tretë te vitit 2024.

9. **Ndertimi i aneksit të shkollës së mesme në Romajë – Has**

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 139,088.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Deri tani janë realizuar punimet e vrazhda (shtylla, traje, mure, pllaka dhe kulmi) dhe po punohet me punimet e brendshme suvatime, instalime te ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, etj. Punimet pritet të përfundojne deri në fund të tremujorit të tretë te vitit 2024.

10. **Renovimi i tërësishëm i objektit shkollor "Gernqare" Novoselan**

(Mjetet e planifikuara për vitin 2023 në vlerë prej 78,148.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 65,000.00€ / 83.17% realizim)

Punimet janë në fazën përfundimtare të punimeve dhe do të vazhdohet me procedurat e pranimit teknik të tyre. Pjesa e mbetur për pagesë prej 13,148.00€ është e planifikuar të realizohet gjatë muajit korrik të vitit 2024, pas pranimit teknik.

11. **Rregullimi i ambientit të oborreve në shkollat e Prizrenit**

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 100,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 100,000.00€ / 100% realizim)

Janë realizuar punimet në rregullimin e ambienteve të oborreve në shkollat "Zenun Çoçaj' në Gjonaj, "Dëshmorët e Kabashit" në Korishë dhe "Gani Saramati" Prizren. Pra me këtë edhe kontrata është realizuar në plotëni.

Pas realizimit të punimeve sipas kontratës, duhet cekur sa ka mungesë buxheti në vlerë prej 41,629.33€, për të cilat mjete duhet shikuar mënyrën për sigurimin e tyre.

12. **Ndërtimi i aneksit të shkollës "Besim Ndrecaj" Lutogllavë**

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 50,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Deri me tani janë realizuar punimet e vrazhda (shtylla, traje, mure dhe pllaka) të aneksit të perdhesës dhe etazhës. Për momentin punimet janë ndërprerë në mungesë të mjeteve financiare. Punimet, për shkak të planifikimit të buxhetit, ndoshta do të zgjasin deri në vitin 2026.

13. **Renovimi ë tërësishëm i objektit shkollor (aneksit të vjeter) "Naim Frasheri" Vlashne**

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 14,083.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 14,083.00€ / 100% realizim)

Të gjitha punimet janë realizuar dhe është bërë pranimi teknik.

Pjesa e mbetur për pagesë prej 14,083.00€ e planifikuar dhe realizuar gjatë muajit shkurt të vitit 2024.

14. **Renovimi i objektit shkollor SHF "Lekë Dukagjini" Prizren**

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 104,528.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 40,000.00€ / 38.26% realizim)

Punimet janë duke u realizuar sipas planifikimit, kryesisht punime në suvatim dhe patinim të mureve, rrjet elektrik, rrjet të ngrohjes qendrore për sallen e edukatës fizike, punime të dyshmeve dhe mureve te nyjeve sanitare me pllaka qeramike, izolime, etj. Punimet, për shkak të planifikimit të buxhetit, do të zgjasin deri në tremujorin e tretë të vitit 2024



15. **Ndërtimi i Çerdhes në Lagjen Tusus Prizren**

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 250,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 250,000.00€ / 100% realizim)

Deri me tani janë realizuar punimet e vrazhda (shtylla, traje, mure dhe pllaka) të bodrumit, përdhesës dhe etazhës, të njëres pjësë të objektit. Për momentin punimet janë ndërprerë në mungesë të mjeteve financiare. Punimet, për shkak të planifikimit të buxhetit, do të zgjasin deri në vitin 2026.

16. **Renovimi i tërësishem i salles së edukates fizike "Meto Bajraktari" në Recane**

(Mjetet e planifikuara per vitin 2024 ne vlere prej 68,312.00€. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekti i filluar nga viti 2022, por për shkak të mungesës së mjeteve financiare është shtyer deri në vitin 2024. Shumë shpejtë pritet që punimet të rifillojne te perfundojne gjatë tremujorit të tretë te vitit 2024.

17. **Ndërtimi i çerdhes në Fshatin Zhur Prizren**

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 50,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024. Projekti për momentin është në pritje deri në hartimin e projketit zbatues. Punimet, varësisht nga vlera dhe planifikimi i buxhetit, do të zgjasin deri në vitin 2026.

18. **Ndërtimi i çerdhes ne Lagjen Arbana Prizren**

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 80,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024. Projekti për momentin është në pritje deri në hartimin e projketit zbatues. Punimet, varësisht nga vlera dhe planifikimi i buxhetit, do të zgjasin deri në vitin 2026.

19. **Ndërtimi i aneksit për parashkollor në SHFMU"Motrata Qiriazi" Prizren**

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 50,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024, i propozuar nga komuniteti, duhet analizuar përsëri, pasi që nuk ka kushte-hapësirë të mjaftueshme për ndërtim.

Varësisht nga analiza dhe bisedat, do të ndërmeren hapa të mëtutjeshme.

20. **Renovimi i teresishem i obj.shk. "Mati Logoreci" Prizren**

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 50,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024. Projekti për momentin është në pritje deri në hartimin e projketit zbatues. Punimet, varësisht nga vlera dhe planifikimi i buxhetit, do të zgjasin deri në vitin 2025.

21. **Renovimi i nyjeve sanitare ne objektet shkollore: Ibrahim Fehmiu dhe Deshmoret e Kabashit**

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 50,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024. Projekti është në procedurë ofertimi-tenderimi. Punimet, varësisht nga vlera dhe planifikimi i buxhetit, do të zgjasin deri në vitin 2025.

22. **Ndërtimi i terrenit sportiv dhe murit mbrojtës në shkollën "Dëshmoret e Zhurit" në Zhur**

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 100,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024. Projekti për momentin është në pritje deri në hartimin e projektit zbatues. Punimet, varësisht nga vlera dhe planifikimi i buxhetit, mund të zgjasin deri në vitin 2025.

23. **Ndërtimi dhe rregullimi i stadiumit në shkollën "Meto Bajraktari" në Recane**

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 50,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024. Projekti për momentin është në fazen e prokurimit. Punimet, varësisht nga vlera dhe planifikimi i buxhetit, mund të zgjasin deri në vitin 2025.

24. **Ndërtimi i këndit të lojrave në SHFMU "Motrat Qiriazi" lagj.Kurilë Prizren**

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 20,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024. Projekti për momentin është në pritje deri në hartimin e projketit zbatues.

25. **Ndertimi i ashensorit ne SHFMU"Motrat Qiriazi" lagj.Kurile Prizren**

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlerë prej 30,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024. Projekti për momentin është në pritje deri në hartimin e projketit zbatues.

26. **Ndrrimi i kalldajave ngrohjes qendrore, montimi i pompave termike në SHFMU"Motrat Qiriazi" lagj.Kurile Prizren**

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 ne vlere prej 50,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024. Projekti për momentin është në pritje deri në hartimin e projketit zbatues.

27. **Punimi terrenit sportiv dhe rrethojes se oborrit ne SHFMU"Naim Frasheri" Kobaj Prizren**

(Mjetet e planifikuara per vitin 2024 ne vlere prej 50,000.00€. Jane realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024. Projekti për momentin është në pritje deri në hartimin e projketit zbatues.

28. **Digjitalizimi i sistemit te institucioneve arsimore ne shkollat; Emin Duraku, Mati Logoreci, Leke Dukagjini, Abdyl Frasheri, Hysen Rexhepi, Gani Saramati, Ibrahim Fehmiu, Fadil Hisari,**

(Mjetet e planifikuara për vitin 2024 në vlere prej 100,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024 dhe të vazhdoj edhe për vitet 2025 dhe 2026. Projekti për momentin është në pritje për ofertim.

Gjatë vitit 2024 janë planifikuar edhe 5 projekte tjera (nga kodi buxhetor mallra dhe shërbime) si më poshtë:

1. Hartimi I projekteve të ndryshme për nevojat e DKA, për vitin 2024 e planifikuar ne vlerë prej 100,000.00€. Projekti është në fazën e ofertimit-ankesave.
2. Mirëmbajtja e sistemit të ngrohjes qendrore nëpër instucionet arsimore të Komunës së Prizrenit. Për vitin 2024 e planifikuar në vlerë prej 100,000.00€. Kontrata eshte nenshkruar dhe tani me vareshisht nga kërkesat e shkollave do te filloj edhe implementimi.
3. Rregullimi dhe mirëmbajtja e ambientit të oborreve të shkollave në Komunën e Prizrenit - kontratë kornizë. E planifikuar për tri vite, ne vlerë prej 1,500,000.00€. Projekti është në fazën e ofertimit-ankesave.
4. Lyerja e brendshme dhe e jashtme (fasadave) të institucioneve arsimore. E planifikuar për tri vite, ne vlerë prej 600,000.00€. Projekti është në fazen e ofertimit.
5. Furnizimi me inventar shkollor për institucionet arsimore. Për vitin 2024 e planifikuar ne vlerë prej 95,000.00€. Projekti është në fazën e ofertimit-ankesave.

Nr. Protokol. 1808/24
Datë: 10.08.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren Prizren Belediyesi

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT NË PRIZREN

I. Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor 2024/2025

Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren në përputhje me Planin Dinamik të punës ka bërë përgatitjet optimale për fillimin e vitit të ri shkollor 2024/2025. Bazuar në planifikimin e sektorëve të DKA-së mbi detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve, ka planifikuar aktivitete dhe projekte të ndryshme të cilat do të zhvillohen gjatë këtij viti shkollor.
Janë bërë përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2024/2025, si në aspektin e përgatitjeve të objekteve shkollore dhe në regjistrimin e nxënësve në klasë të parë, të dhjetë për këtë vit shkollor.

Furnizimi me tekste shkollore dhe shpërndarja e tyre

Bazuar në udhëzuesin për evidentimin dhe shpërndarjen e tekstet shkollore për vitin shkollor 2024/2025, DKA ka nxjerrë vendim për themelimin e komisionit për shpërndarjen dhe pranimin e teksteve shkollore. Janë njoftuar shkollat publike dhe atyre private për grumbullimin e të dhënave të sakta për numrin e nxënësve sipas listave të cilat i kanë dërguar shkollat. Janë grumbulluar të dhënat për secilën shkollë, duke e verifikuar me saktësi numrin e nxënësve. Komisioni i DKA-së ka bërë verifikimin e të dhënave brenda afatit të përcaktuar nga MASHTI dhe e ka dërguar katalogun e parë të përzgjedhjes së teksteve shkollore tek MASHTI, në aq kopje sa ka shtëpi botuese. Po ashtu DKA ka dorëzuar të gjitha procesverbalet të takimeve të Aktiveve profesionale për përzgjedhjen e teksteve shkollore në një dosje të kompletuar në MASHTI si dhe vendimin për themelimin e komisionit për shpërndarjen dhe pranim të teksteve shkollore në aq kopje sa ka shtëpi botuese. Vendimet kanë qenë origjinale, të nënshkruara dhe të vulosura nga DKA.

Në gusht jemi njoftuar nga mediat se MASHT-i ka marrë vendim që të bëhet rimbursimi i mjeteve tek prindërit për blerjen e librave, situatë e cila ka sjellë vështirësi.

Në takim me drejtor/e të shkollave kemi kërkuar që të shkollat të formojnë ekipe mobile për t'iu dal në ndihmë prinderve për regjistrim në platformën e-Kosova.

Komisioni i DKA-së po ashtu ka grumbulluar të dhënat për fëmijët të cilët nuk po munden me u regjistru në platformën e-Kosova për arsye nga më të ndryshmet dhe informatat e detajizuara do të përcillen në MASHT për të shqyrtuar mundësinë e regjistrimit për të bërë furnizimin e tyre me tekste.

II. Infrastruktura në shkollat e komunës

Njësia teknike pranë DKA-së ka vazhduar punët që nga fillimi i vitit të ri shkollor 2024/2025 me realizimin e projekteve dhe planifikimin e projekteve të reja, përfshirë furnizimin me mallra dhe dhënie të shërbimeve të shkollave, si dhe ka monituar punimet (nga investimet kapitale) që janë bërë në ndërtimin e objekteve shkollore. Janë realizuar aktivitetet e ndryshme si vijon:

- Kompletimi dhe dorëzimi i dokumentacionit të inventarizimit të shkollave dhe DKA-së tek zyrtarët në Drejtorinë e Financave,
- Vizitat e rregullta nëpër shkolla për verifikimin e pastërtisë dhe higjienës,
- Janë mbajtur takimet konsultative me operatorët ekonomikë – punëkryesit lidhur me ndërtimin e objekteve shkollore .
- Janë mbikqyrë punimet e projekteve të cilat vazhdojne nga vitet e kaluara.

Sa i përket investimive kapitale të planifikuara për vitin 2024, kanë filluar së realizuari, gjersa projektet në vazhdimësi janë si më poshtë:

Ndërtimi i objektit të ri shkollor "Pllanjane" në Pllanjanë
Punimet kanë përfunduar dhe është bërë pranimi teknik i punimeve. Po ashtu është realizuar edhe pagesa përfundimtare.

Ndërtimi i objektit të ri shkollor "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" (ish Pjeter Mazrreku) në Mazrrek

Punimet janë duke vazhduar. Deri me tani jane realizuar kryesisht punimet e vrazhda të betonit në tri nivele-etazhe. Poashtu etazha e parë dhe e dyte pjesërisht janë muratuar. Punimet, për shkak të planifikimit të buxhetit, do të zgjasin deri në vitin 2025.

Ndërtimi i objektit të ri shkollor në Krushe të Vogël

Punimet janë duke vazhduar. Punimet e fazës së parë pritet të përfundojnë gjatë vitit 2024, ndërsa për punimet e fazës së dytë gjate vitit 2025. Punimet do te vazhdojne edhe gjate muajve të vitit 2024 varesisht nga buxheti. Objekti, sipas planifikimit, do të jetë në funksionim gjatë vitit 2025.

Ndërtimi i objektit të ri shkollor (9 klasëshe) në Gjonaj të Hasi

Ndërtimi i objektit të ri shkollor (9 klasëshe) në Gjonaj të Hasit

Punimet kanë përfunduar dhe është bërë pranimi teknik i punimeve. Po ashtu është relizuar edhe pagesa përfundimtare.

Ndërtimi i aneksit të objektit të objektit shkollor Ardhmëria" në Landovicë

Te gjitha punimet jane realizuar dhe është bërë pranimi teknik.

Ndërtimi i aneksit të shkollës në Vermicë
Punimet jane duke vazhduar dhe brenda muajit shtator pritet të përfundojnë në tërësi.

Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën "Haziz Tola" në Lagjen Jeta e Re - Prizren - faza e dytë
Të gjitha punimet janë realizuar dhe është bërë pranimi teknik.

Ndërtimi I sallës së edukatës fizike në shkollën "Fatmir Berisha" në Lagjen Bajram Curri - Prizren - faza e dytë
Punimet jane duke u realizuar sipas planifikimit, kryesisht punime ne suvatim dhe patinim te mureve, punim te dyshmeve me pllaka, izolime, etj. Punimet janë duke vazhduar. Në bazë të planifikimit të buxhetit, puniumet pritet te perfundojne gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024.

Ndërtimi i aneksit të shkollës së mesme në Romajë – Has

Punimet janë duke vazhduar dhe brenda muajit shtator pritet te perfundojne ne teresi.

Renovimi i tërësishem i objektit shkollor "Gernqare" Novoselan

Punimet kanë përfunduar dhe është bërë pranimi teknik i punimeve. Po ashtu është realizuar edhe pagesa përfundimtare.

Rregullimi i ambientit të oborreve në shkollat e Prizrenit

Janë realizuar punimet në rregullimin e ambienteve të oborreve në shkollat “Zenun Çoçaj’ në Gjonaj, “Dëshmoret e Kabashit” ne Korishë dhe “Gani Saramati” Prizren. Pra me këtë edhe kontrata është realizu në përgjithesi.
Pas realizimit të punimeve sipas kontratës, duhet cekur sa ka mungesë buxheti në vlerë prej 141,629.33€, për të cilat mjete duhet shikuar mënyrën për sigurimin e tyre.

Ndërtimi i aneksit të shkollës "Besim Ndrecaj" Lutogllavë

Deri me tani janë realizuar punimet e vrazhda (shtylla, traje, mure dhe pllaka) te aneksit te perdheses dhe etazhës. Pastaj eshte vazhduar edhe me suvatime dhe pune tjera ndertimore dhe zejtare.Për momentin punimet janë nderprere në mungese të mjeteve financiare. Punimet, për shkak të planifikimit të buxhetit, ndoshta do të zgjasin deri në vitin 2026.

Renovimi i teresishem i objektit shkollor (aneksit te vjeter) "Naim Frasheri" Vlashne
Të gjitha punimet janë realizuar dhe është bërë pranimi teknik.

Renovimi i objektit shkollor SHF "Lekë Dukagjini" Prizren
Të gjitha punimet janë realizuar dhe është bërë pranimi teknik.
Pas realizimit të punimeve sipas kontratës, duhet cekur sa ka mungesë buxheti në vlerë prej 16,800.00€, të cilat mjete jane planifikuar ne buxhetin e vitit 2025.

Ndërtimi i çerdhes në Lagjen Tusus Prizren

Deri me tani jane realizuar punimet e vrazhda (shtylla, traje, mure dhe pllaka) te bodrumit, përdhesës dhe etazhës, të njëres pjësë të objektit. Per momentin punimet jane nderprere ne mungese te mungese te mjeteve financiare. Punimet, për shkak të planifikimit të buxhetit, do të zgjasin deri në vitin 2026

Renovimi i tërësishem i salles së edukates fizike "Meto Bajraktari" në Recane
Projekti i filluar nga viti 2022, por për shkak të mungesës së mjeteve financiare është shtyer deri në vitin 2024. Punimet të perfundojne gjatë muajit shtator të vitit 2024.

Ndërtimi i çerdhes ne Fshatin Zhur Prizren
Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024. Projekti për momentin është në pritje deri në hartimin e projketit zbatues. Punimet, varësisht nga vlera dhe planifikimi i buxhetit, do të zgjasin deri në vitin 2026.

Ndërtimi i çerdhes në Lagjen Arbana Prizren
Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024. Projekti për momentin është në pritje deri në vendimin përfundimtar nga Qeveria për riparcializimin e pronës. Punimet, varësisht nga vlera dhe planifikimi i buxhetit, do të zgjasin deri në vitin 2026.

Ndertimi i aneksit per parashkollor ne SHFMU"Motrata Qiriazi" Prizren
Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024, i propozuar nga komuniteti, nuk ka kushte-hapësirë të mjaftueshme për ndërtim.
Varësisht nga analiza dhe bisedat, do të ndërmeren hapa të mëtutjeshme.

Renovimi i teresishem i obj.shk. "Mati Logoreci" Prizren
Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024. Projekti për momentin është në procedure tenderimi.

Renovimi i nyjeve sanitare ne objektet shkollore: Ibrahim Fehmiu dhe Deshmoret e Kabashit
Projekti i planifikuar ka filluar por ne mungese te mjeteve do te vazhdoje edhe gjate vitit 2025.

Ndërtimi i terrenit sportiv dhe murit mbrojtes në shkollën "Deshmoret e Zhurit" në Zhur
Projekti i planifikuar ka përfunduar gjate muajit shtator 2024.

Ndërtimi dhe rregullimi i stadiumit ne shkollen "Meto Bajraktari" ne Recane
Projekti ka filluar se implementuari i planifikuar të filloj nga viti 2024. Punimet, varësisht nga vlera dhe planifikimi i buxhetit, mund të zgjasin deri në vitin 2025.

Ndertimi i këndit të lojrave në SHFMU "Motrat Qiriazi" lagj.Kurile Prizren
Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024. Projekti për momentin është në procedurë të vlerësimit të ofertës.

Ndërtimi i ashensorit në SHFMU"Motrat Qiriazi" lagj.Kurile Prizren
Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024. Projekti për momentin është në procedurë të vlerësimit të ofertës.

Ndrrimi i kalldajave ngrohjes qendrore, montimi i pompave termike ne SHFMU"Motrat Qiriazi" lagj.Kurile Prizren
Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024. Projekti është anuluar dhe për vitin buxhtor 2025 është planifikuar të realizohet me ndryshim, ku ne vend të pompave termike është planifikuar të montohen kalldajat me pelet.

Punimi terrenit sportiv dhe rrethojes së oborrit në SHFMU"Naim Frasheri" Kobaj Prizren
Projekti i planifikuar ka filluar por n 137 mungesë të mjeteve do të vazhdoje edhe gjate vitit 2025.

Digjitalizimi i sistemit te institucioneve arsimore ne shkollat; Emin Duraku, Mati Logoreci, Leke Dukagjini, Abdyl Frasheri, Hysen Rexhepi, Gani Saramati, Ibrahim Fehmiu, Fadil Hisari,
Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024 dhe të vazhdoj edhe për vitet 2025 dhe 2026. Projekti për momentin është në pritje të kompletimit të dokumentacionit-materialit për ofertim.

Pra gjatë vitit 2024, investime kapitale, janë të planifikuara 28 projekte, në vlerë prej 2,506,827.00€
Sipas rrjedhes se punimeve, gjegjesisht realizimit te tyre, deri me datë 31.08.2024, janë realizuar rreth 67.31% €

Gjatë vitit 2024 janë planifikuar edhe 5 projekte tjera (nga kodi buxhetor mallra dhe shërbime) si më poshtë:
Hartimi i projekteve të ndryshme për nevojat e DKA, për vitin 2024 e planifikuar në vlerë prej 100,000.00€. Projekti është në fazën e ofertimit-ankesave.
Mirëmbajtja e sistemit të ngrohjes qendrore nëpër instucionet arsimore të Komunës së Prizrenit. Për vitin 2024 e planifikuar në vlerë prej 100,000.00€. kontrata është nënshkruar dhe tani me varëshisht nga kërkesat e shkollave do të filloj edhe implementimi.
Rregullimi dhe mirëmbajtja e ambientit të oborreve të shkollave në Komunën e Prizrenit - kontratë kornizë. E planifikuar për tri vite, ne vlerë prej 1,500,000.00€. Projekti është në fazën e ofertimit-ankesave.
Lyerja e brendshme dhe e jashtme (fasadave) të institucioneve arsimore. E planifikuar për tri vite, ne vlerë prej 600,000.00€. Projekti është në fazen e ofertimit.
Furnizimi me inventar shkollor për institucionet arsimore. Për vitin 2024 e planifikuar në vlerë prej 95,000.00€. Projekti është në fazën e ofertimit-ankesave.

III. Regjistrimi i nxënësve në klasë të dhjetë (10) për vitin shkollor 2024/2025

Duke u bazuar në kërkesën me nr. 3/1968 të datës 27.06.2024 të Departamentit të Arsimit Parauniversitar të MASHTI-t për kushtet dhe kriteret e regjistrimit të nxënësve në klasë e (10) në gjimnaze dhe IAAP për vitin shkollor 2024/2025, dhe bazuar në konkursin me nr. 1305/24 të datës 08.07.2024, në pesë (5) shkollat e mesme të larta që janë nën menaxhimin e DKA-së, në afatin e parë pasi janë krijuar komsionet e shkollave për pranimin e aplikacioneve për regjistrim dhe vlerësimin e tyre, është kjo gjendje e aplikimit dhe regjistrimit të nxënësve:

Regjistrimi i nxënësve në klasë të dhjet për vitin shkollor 2024-2025

Të dhënat e regjistrimit të nxënësve në klasë të dhjetë (10) në afatin e parë sipas shkollave nën menaxhimin e DKA-së janë si më poshtë:
Në gjimnazin "Gjon Buzuku" në Prizren janë planifikuar për regjistrim gjithsej 456 nxënës (336 nxënës shqip + 72 nxënës bosnjak + 48 nxënës turk), ndërsa në afatin e parë dhe afatin e dytë sipas kushteve dhe kritereve janë regjistruar gjithsej 242 nxënës (189 shqip + 15 boshnjak + 39 turk).
Në gjimnazin "Remzi Ademaj" në Prizren vetëm në gjuhën shqipe janë planifikuar për regjistrim gjithsej 408 nxënës (240 nxënës në qendër dhe 168 nxënës në 5 paralelet e ndara fizike, ndërsa prej konkurseve sipas kushteve dhe kritereve janë regjistruar gjithsej 170 nxënës, në qendër dhe në paralelet e ndara fizike në Gjonaj, në Romajë, në Zym, në Velezhë dhe në Zhur.
Në SHMLM "Luciano Motroni" në Prizren janë planifikuar për regjistrim gjithsej 360 nxënës (264 nxënës shqip + 48 nxënës bosnjak + 48 nxënës turk), ndërsa prej konkurseve sipas kushteve dhe kritereve janë regjistruar gjithsej 297 nxënës (241 shqip + 35 boshnjak + 21 turk).
Në IAAP "Ymer Prizreni" në Prizren janë planifikuar për regjistrim gjithsej 378 nxënës (306 nxënës shqip + 54 nxënës boshnjak + 18 nxënës turk), ndërsa prej konkurseve sipas kushteve dhe kritereve janë regjistruar gjithsej 195 nxënës (170 shqip + 4 boshnjak + 3 turk).
Në SHMLM "Lorenc Antoni" në Prizren janë planifikuar për regjistrim gjithsej 30 nxënës për dy paralele dhe janë regjistruar gjithsej 11 nxënës vetëm në gjuhën shqipe, në drejtimin teorik dhe instrumental.
Bazuar në raportet e shkollave pas konkursit për regjistrimin e nxënësve në klasë të dhjetë (10) edhe në afatin e dytë plotësues të gushtit, gjendja është mëse alarmante. Sipas kushteve dhe kritereve të DAP në MASHTI në dy afate janë regjistruar një numër shumë i vogël i nxënësve, gjë që nuk plotësohet numri i nxënësve sipas paraleleve në të gjitha shkollat e komunës të cilat i menaxhon DKA në Prizren. Gjithashtu nga shkollat kemi pranuar kërkesa për të plotësuar numrin e nxënësve nga listat e aplikuesve në konkurs.
Janë shqyrtuar mbi 46 ankesa të nxënësve për mos regjistrimin e nxënësve në shkollën e mesme të mjekësisë, vetëm në të cilën shkollë konkurenca e nxënsëve ka qenë më e madhe se sa kërkesat e shkollës, në krahasim me shkollat tjera të mesme të larta. Për këtë arsye komisionet e shkollave

kanë zbatuar kushtet dhe kriteret e konkursit. DKA ka bërë kërkesë në MASHTI për të ulur kushtet dhe kriteret, dhe kemi pranuar përgjigjen e MASHTI-t me nr. 3/2494 të dates 21.08.2024 ku shkollat janë duke zbatuar, së bashku me rekomandimin e DKA.

Zyrtarët nga sektori i arsimit në Drejtorinë Komunale të Arsimit kanë monitoruar shkollat e mesme të larta gjatë regjistrimit të nxënësve në klasë të dhjetë dhe kanë nxjerrë rekomandime me të gjeturat.
Më poshtë është planifikimi dhe raporti i regjistrimit të nxënësve sipas shkollave, profileve dhe komuniteteve në dy afate.

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT NE PRIZREN
RAPORTI PER REGJISTRIMIN E NXENESVE NË KLASË TË DHJETË (X) NË SHKOLLAT E MESME TË LARTA NE MENAXHIMIN E DKA-së, Viti shkollor 2024/2025

Nr	Shkolla		DREJTIMET	PROFILET	Vendi	Nr. i nx. që janë planifikuar për regjistrim në klasë të dhjetë (10)				Nr. i nx. që janë regjistruar sipas konkursit afati parë, korrik 2024				Nr. i nx. që janë regjistruar sipas konkursit, afatit të gushtit 2024			
						Shqip	Boshnj	Turk	Gjithsej	Shqip	Boshnj	Turk	Gjithsej	Shqip	Boshnj	Turk	Gjithsej
1	"Gjon GJIMNAZI Buzuku"	1	Shkencat natyrore	Shkencat natyrore	Prizren	288	0	0	288	170	0	0	170	5	0	0	5
		2	Shkencat natyrore	Shkencat natyrore	Romajë	24	0	0	24	0	0	0	0	0	0	0	0
		3	Shkencat natyrore	Shkencat natyrore	Gjonaj	24	0	0	24	14	0	0	14	0	0	0	0

		4	Shkencat natyrore	Shkencat natyrore	Turq	0	0	24	24	0	0	24	24	0	0	0	0
		5	Shoqëror - Gjuhësor	Shoqëror - Gjuhësor	Turq	0	0	24	24	0	0	12	12	0	0	3	3
		6	Shkencat natyrore	Shkencat natyrore	Boshnjak	0	24	0	24	0	6	0	6	0	1	0	1
		7	Shoqëror - Gjuhësor	Shoqëror - Gjuhësor	Boshnjak	0	24	0	24	0	8	0	8	0	0	0	0
		8	Shoqëror - Gjuhësor	Shoqëror - Gjuhësor	Boshnjak-Recane	0	24	0	24	0	0	0	0	0	0	0	0
		Gjithsej				336	72	48	456	184	14	36	234	5	1	3	9
2	GJIMNAZI "Remzi Ademaj"	1	Shoqëror - Gjuhësor	Shoqëror - Gjuhësor	Prizren	240	0	0	240	77	0	0	77	9	0	0	9
		2	Shoqëror - Gjuhësor	Shoqëror - Gjuhësor	Zhur	24	0	0	24	1	0	0	1	8	0	0	8

		3	Shoqëror - Gjuhësor	Shoqëror - Gjuhësor	Gjonaj	48	0	0	48	13	0	0	13	15	0	0	15
		4	Shoqëror - Gjuhësor	Shoqëror - Gjuhësor	Romaje	48	0	0	48	23	0	0	23	17	0	0	17
		5	Shoqëror - Gjuhësor	Shoqëror - Gjuhësor	Velezhe	24	0	0	24	4	0	0	4	3	0	0	3
		6	Shoqëror - Gjuhësor	Shoqëror - Gjuhësor	Zym	24	0	0	24	0	0	0	0	0	0	0	0
		Gjithsej				408	0	0	408	118	0	0	118	52	0	0	52
3	SHMM "Luciano Motroni"	1	Infermier i përgjithshëm	Shëndetësi	Shëndetësi	192	0	0	192	179	0	0	179	10	0	0	10
		3	Teknik i dentar	Shëndetësi	Shëndetësi	24	0	0	24	20	0	0	20	0	0	0	0
		4	Teknik i farmacisë	Shëndetësi	Shëndetësi	24	0	0	24	18	0	0	18	2	0	0	2
		5	Infermier i	Shëndetësi	Boshnjak	0	24	0	24	0	24	0	24	0	0	0	0

			përgjith shëm															
		6	Teknik i farmacis ë	Shëndet ësi	Boshnj ak	0	24	0	24	0	5	0	5	0	6	0	6
		7	Infermie r i përgjith shëm	Shëndet ësi	Turk	0	0	24	24	0	0	16	16	0	0	2	2
		8	Teknik dentar	Shëndet ësi	Turk	0	0	24	24	0	0	3	3	0	0	0	0
		9	Teknik i pediatri së	Shëndet ësi	shqip	24	0	0	24	8	0	0	8	4	0	0	4
		Gjithsej				264	48	48	360	225	29	19	273	16	6	2	24
4	"Ymer Prizreni" SHME	1	Ekonom i	Kontabi litet dhe tatime	Prizre n	36	0	0	36	28	0	0	28	4	0	0	4
		2	Ekonom i	Banka dhe sigurime	Prizre n	18	0	0	18	19	0	0	19	0	0	0	0
		3	Ekonom i	Marketi ng dhe shitje	Prizre n	18	0	0	18	9	0	0	9	3	0	0	3
		4	Ekonom i	Tregti me pakicë	Prizre n	18	0	0	18	0	0	0	0	1	0	0	1

				dhe shumicë													
		5	Ekonomi	Shpedicion dhe logjistikë	Prizren	18	0	0	18	5	0	0	5	0	0	0	0
		6	Ekonomi	Asistent financiar	Prizren	18	0	0	18	13	0	0	13	0	0	0	0
		7	Teknologji Ushqimore	Teknologji ushqimore	Prizren	18	0	0	18	11	0	0	11	4	0	0	4
		8	AgroBiznes	Agrobiznes	Prizren	18	0	0	18	7	0	0	7	0	0	0	0
		9	AgroBiznes	Hortikulturë	Prizren	18	0	0	18	6	0	0	6	0	0	0	0
		10	Hoteleri	Asistenti mikpritjes hoteliere	Prizren	18	0	0	18	5	0	0	5	0	0	0	0
		11	Juridik	Administrat dhe shërbime të zyrës	Prizren	54	0	0	54	32	0	0	32	6	0	0	6

		12	Ekonomi	Kontabilitet-boshnjak	Prizren	0	18	0	18	0	0	0	0	0	0	0	0
		13	Hoteleri	Asistenti shërbimeve të zyres	Prizren	0	18	0	18	0	0	0	0	0	0	0	0
		14	Juridik	Asistent restoranti	Reçane	0	18	0	18	0	4	0	4	0	0	0	0
		15	Ekonomi	Kontabilitet dhe tatime - turk	Prizren	0	0	18	18	0	0	3	3	0	0	0	0
		16	Ekonomi	Kontabilitet dhe tatime	Gjonaj	18	0	0	18	21	0	0	21	0	0	0	0
		17	Ekonomi	Kontabilitet dhe tatime	Romajë	18	0	0	18	8	0	0	8	0	0	0	0
		18	Ekonomi	Kuzhinier	Prizren	18	0	0	18	6	0	0	6	0	0	0	0
		Gjithsej				306	54	18	378	170	4	3	177	18	0	0	18
5	SHMM	1	Teorik	Teorik	Prizren	15	0	0	15	5	0	0	5	1	0	0	1

	"Lorenc Antoni"	**2**	**Instrumental**	**Instrumental**	**Prizren**	**15**	**0**	**0**	**15**	**5**	**0**	**0**	**5**	**0**	**0**	**0**	**0**
		Gjithsej				**30**	**0**	**0**	**30**	**10**	**0**	**0**	**10**	**1**	**0**	**0**	**1**
GJITHSEJ REGISTRIMI NE 5 SHKOLLA						**1344**	**174**	**114**	**1632**	**707**	**47**	**58**	**812**	**92**	**7**	**5**	**104**
						Shqip	**Boshnj**	**Turk**	**Gjithsej**	**Shqip**	**Boshnj**	**Turk**	**Gjithsej**	**Shqip**	**Boshnj**	**Turk**	**Gjithsej**
						TE PLANIFIKUAR PER REGJISTRIM				**TE REGJISTRUAR SIPAS KONKURSIT**				**TE REGJISTRUAR SIPAS KONKURSIT**			

IV. MATURA SHTETËRORE 2024

ORGANIZIMI DHE MBAJTJA E MATURËS SHTETËRORE 2024
AFATI QERSHORIT 2024

Në bazë të Ligjit mbi Maturën Shtetërore Nr. 05/L-018, UA 04/2016 dhe UA 05/2016 Detyrat dhe përgjegjësit e administrueseve dhe komisioneve të qendrave të testimit, Vendimit të Ministrit të Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) me nr. 01B-039 të datës 17.04.2024, njoftimit të DVSM në MASHTI për mënyrën e paraqitjes së provimit të maturës përmes platformës e-Kosova, DKA në Prizren ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme organizative për mbajtjen e Maturës Shtetërore 2024, që u mbajt më **22 qershor 2024 (**afati parë).
Sipas udhëzimeve të DVSM në MASHTI, prej DKA është kërkuar të caktohen koordinatorët e shkollave për Maturën Shtetërore, ku pastaj nxënësit individualisht pasi janë regjistruar në platformën e-Kosova, kanë paraqitur provimin e maturës, dhe DVSM ka shpërndarë listën e nxësnësve të të

gjitha shkollave nëpër qendrat e ndryshme të testimit. Përmes platëformës e-Kosova kanë paraqitur provimin 1926 maturantë nga të gjitha shkollat e mesme të larta të Komunës së Prizrenit.
Nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren janë caktuar 16 Qendra të Testimit dhe janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për mbarëvajtje më të mirë të maturës shtetërore.
Testit iu kanë nënshtrohen **1926 maturantë dhe atë 1690 maturantë të komunitetit shqiptarë, 128 maturantë të komunitetit boshnjak dhe 108 maturantë të komunitetit turk**. Janë caktuar komisionet e DKA-së nëpër Qendra të Testimit dhe **63 administruesit** e Provimit të Maturës Shtetërore nga shkollat e komunës sonë kanë administruar Testin e Maturës Shtetërore në komunat e Suharekës, Dragashit dhe të Mamushës.
Në të gjitha Qendrat e Testimit procesi ka shkuar në nivel të mirë, përjashtimisht në disa qendra testimi ka filluar me vonesë, për shkak të vonesës së komisioneve dhe testeve nga MASHTI.

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT NË PRIZREN
REZULTATI I TESTIT TË MATURËS SHTETËRORE Afati Qershor 2024

Rezultati i Maturës Afati_qershor 2024		Nxënësit që kanë hy në test		Nxënës që kaluan testin			Përqindja e kalueshmërisë (mbi 40% e pragut)		Rezultati në përqindje e shkollës
Nr.	Shkolla	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej		
1	Gjimnazi "Gjon Buzuku"	134	211	345	131	203	334	96.81	74.83
2	Gjimnazi "Remzi Ademaj"	87	197	284	71	131	202	71.13	45.13
3	SHMM "Luciano Motroni"	91	289	380	82	250	332	87.37	54.24
4	SHME "Ymer Prizreni"	101	92	193	69	37	106	54.92	40.85
5	SHMM "Lorenc Antoni"	15	15	30	10	12	22	73.33	47.60

6	Qendra e Kompetencës	17	23	40	13	12	25	62.50	41.28
7	SHMT "11 Marsi"	223	117	340	155	71	226	66.47	54.37
8	Medreseja "Alauddin"	12	34	46	11	25	36	78.26	49.57
9	"Loyola" Gymnazium	49	59	108	49	59	108	100.00	73.27
10	College "Mehmet Akif"	18	28	46	16	23	39	84.78	68.82
11	Maarif School International	16	20	36	13	18	31	86.11	52.83
12	Q.B. "Nënë Tereza"	2	1	3	1	0	1	33.33	37.33
	Gjithsej	765	1086	1851	621	841	1462	78.98	53.34
					81.18	77.44	78.98		
					%meshkuj	%femra			

ORGANIZIMI DHE MBAJTJA E MATURËS SHTETËRORE AFATI GUSHTIT 2024

Në bazë të Ligjit mbi Maturën Shtetërore Nr. 05/L-018, UA 04/2016 dhe UA 05/2016 Detyrat dhe përgjegjësit e administrueseve dhe komisioneve të qendrave të testimit, Vendimit të Ministrit të Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) me nr. 01B-039 të datës 17.04.2024, njoftimit të DVSM në MASHTI për mënyrën e paraqitjes së provimit të maturës përmes platformës e-Kosova, DKA në Prizren ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme organizative për mbajtjen e Maturës Shtetërore 2024, që mbahet më 31 gusht 2024 (afati dytë).

Sipas udhëzimeve të DVSM në MASHTI, prej DKA është kërkuar të caktohen koordinatorët e shkollave për Maturën Shtetërore, ku pastaj nxënësit individualisht pasi janë regjistruar në platformën e-Kosova, kanë paraqitur provimin e maturës, dhe DVSM ka shpërndarë listën e nxënësve të të gjitha shkollave nëpër qendrat e ndryshme të testimit. Përmes platëformës e-Kosova nxënësit paraqesin provimin e maturës, ku nga raportet e

shkollave kemi pranuart edhe 430 maturantë nga të gjitha shkollat e mesme të larta të Komunës së Prizrenit, të cilët do ti nënshtrohen provimit të maturës shtetërore më 31 gusht 2024, ndërsa nga sistemi e-Kosova kanë paraqitur provimin 365 nxënës.
Nga listat e nxënësve që kanë paraqit provimin e maturës, një numër i vogël i nxënësve nuk kan hy në test.
Nga DVSM në MASHTI janë caktuar tri qendra të testimit, ku janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për mbarëvajtje më të mirë të provimit të maturës shtetërore për afatin e gushtit.
Janë caktuar komisionet e DKA-së nëpër qendra të testimit dhe 19 administruesit e provimit të maturës shtetërore nga shkollat e komunës sonë që administrojnë testin e maturës shtetërore në Komunat e Suharekës, Dragashit dhe të Mamushës.
Janë bërë kërkesë Policisë së Kosovës dhe Drejtorisë së Shëndetësisë për mbështetje në ditën e provimit të maturës shtetërore. Një nxënëse Fatjona Hoxha (me kod MS-2421065) është larguar nga Qendta e Testimit për shkak që është nxënës duke përdorur telefonin.
Në të gjitha Qendrat e Testimit procesi ka shkuar në nivel të mirë, si në aspektin e sigurisë dhe të procedurave tjera sipas UA të MASHTI-t dhe ligjit të maturës shtetërore, ku përveç komisioneve dhe administruesve, testin e kanë monitorue edhe monitorues student nga UP.

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT NË PRIZREN

REZULTATI I TESTIT TË MATURËS SHTETËRORE gusht 2024

Rezultati i Maturës Afati_gushtit 2024		Nxënësit që kanë hy në test			Nxënës që kaluan testin			Përqindja e kalueshmërisë (mbi 40% e pragut)	Rezultati në përqindje e shkollës
Nr.	Shkolla	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej		
1	Gjimnazi "Gjon Buzuku"	7	11	18	6	10	16	88.89	47.53
2	Gjimnazi "Remzi Ademaj"	18	49	67	10	29	39	58.21	42.16
3	SHMM "Luciano Motroni"	9	40	49	7	30	37	75.51	47.08

4	SHME "Ymer Prizreni"	30	27	57	16	18	34	59.65	40.50
5	SHMM "Lorenc Antoni"	3	3	6	2	2	4	66.67	41.33
6	Qendra e Kompetencës	3	6	9	2	4	6	66.67	46.56
7	SHMT "11 Marsi"	58	30	88	36	19	55	62.50	41.89
8	Medreseja "Alauddin"	5	10	15	4	3	7	46.67	40.87
9	"Loyola" Gimnazium	0	0	0	0	0	0	#DIV/0!	
10	College "Mehmet Akif"	2	5	7	2	4	6	85.71	50.00
11	Maarif School International	4	1	5	3	1	4	80.00	45.40
12	Q.B. "Nënë Tereza"	1	1	2	1	0	1	50.00	44.50
	Gjithsej	140	183	323	89	120	209	64.71	44.35

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT NË PRIZREN

REZULTATI FINAL I PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE 2024 PËR DY AFATET

Rezultati i Maturës - Dy Afate 2024		Nxënësit që kanë hy në test			Nxënës që kaluan testin			Përqindja e kalueshmërisë	Rezultati në përqindje e shkollës
Nr.	Shkolla	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej		
1	Gjimnazi "Gjon Buzuku"	134	211	345	135	211	346	100.29	50.26
2	Gjimnazi "Remzi Ademaj"	87	197	284	81	160	241	84.86	42.16
3	SHMM "Luciano Motroni"	91	283	374	89	274	363	97.06	47.08
4	SHME "Ymer Prizreni"	101	92	193	85	55	140	72.54	40.50
5	SHMM "Lorenc Antoni"	15	15	30	12	14	26	86.67	41.33
6	Qendra e Kompetencës	17	23	40	15	16	31	77.50	46.56
7	SHMT "11 Marsi"	222	115	337	190	88	278	82.49	41.89
8	Medreseja "Alauddin"	12	34	46	15	28	43	93.48	40.87
9	"Loyola" Gimnazium	49	59	108	49	59	108	100.00	73.27
10	College "Mehmet Akif"	18	28	46	18	27	45	97.83	50.00

11	Maarif School International	16	20	36	16	19	35	97.22	45.40
12	Q.B. "Nënë Tereza"	2	1	3	2	0	2	66.67	44.35
	Gjithsej	764	1078	1842	707	951	1658	90.01	46.97
					92.54	88.22	90.01		
					Meshkuj %	Femra %			

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1 Opinioni i Auditimit

2 Gjetjet dhe rekomandimet

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.[1]

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

11.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë se drejtoritë përkatëse mbajnë evidenca të sakta për llogaritë e arkëtueshme në mënyrë që prezantimi i tyre në pasqyra financiare të jetë i saktë dhe i drejtë.	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	I zbatuar
12.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes ndërmarrjes se veprimeve të nevojshme me qëllim të rritjen e efikasitetit në arkëtimin e të hyrave.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimi
13.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar në paraprakisht, dhe se obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimi
14.	Detyrimet Kontigjente	Kryetari duhet të sigurojë një koordinim të duhur të informacionit dhe përmirësim të komunikimit në mes departamenteve, në mënyrë që të sigurohen evidenca të sakta dhe të plota të detyrimeve kontingjente për prezantim në pasqyrat vjetore financiare.	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme

Agron Fetiu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm

Ramadan Gashi, Drejtor i Auditimit

Florim Maliqi, Udhëheqës i ekipit

Luljeta Morina, Anëtare e ekipit

Edon Kabashi, Anëtar i ekipit

Shtojca I: Letër konfirmimi

Leterkonfirmimi

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Komunës së Prizrenit**, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës së Prizrenit

Data: 10.06.24, Prizren.

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare[6] duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet[7], duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)
Forma e opinionit

Opinioni i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinioni

Opinioni i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financave;

b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose

c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

[1] Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik

[2] Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar

[3] Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

[4] Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

[5] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

[6] Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit

[7] Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.

Republika e Kosovës
Republika Kosova -Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren- Prizren Belediyesi

ZYRA E KRYETARIT

DATË:	15.07.2024
PËR:	Vlora Mehmeti- Spanca, Auditore e Përgjithshme
CC:	Ramadan Gashi, Drejtor i Auditimit në ZKA Florim Maliqi, Udhëheqës i ekipit të Auditimit
NGA:	Agron Hoxha, Udhëheqës i AB
PËRMES:	Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës së Prizrenit
LENDA:	**PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2023**

Të nderuar,

Në pajtim me nenin 14, pika 1 deri në pikën 7 të Rregullores së Punës për zbatimin e Auditimit dhe Planeve të veprimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të aprovuar me datë 21.06.2019, gjeni të bashkangjitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga raporti final i Auditimit për Komunën e Prizrenit, për vitin financiar të përfunduar me 31.12.2023, të përgatitur nga anëtarët e grupit punues në bashkëpunim me NjAB. Duke marrë në konsideratë Raportin e Auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA-së), në pajtim me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, jemi zotuar për adresimin e rekomandimeve të dhëna përmes Planit të Veprimit. Komuna e Prizrenit ka të themeluar Grupin Punues dhe ka të emëruar Koordinatorin e procesit dhe se për progresin e zbatimit të rekomandimeve do të bëhet rishikimi sipas afateve të caktuara në planin e veprimit, duke përgatitur Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve, i cili raport do të dorëzohet në dy periudha: **30 shtator 2024 dhe 15 mars 2025**, sipas kërkesave të dalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit nga ZKA.

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2023

Nr	Komponenta e auditimit(kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
1	**Çështja A1 - Pagesa e plotë për furnizim me lëndë djegëse**	Më datë 23.02.2022 është lidhur kontratë me OE në shumë prej 56,550€, për projektin "Furnizimi me dru për ngrohje për rastet sociale". Më datën 06.04.2023, komisioni në bazë të faturës së pranuar, ka konstatuar se furnizimi me dru është pranuar si në sasi ashtu edhe në cilësi sipas kushteve të kontratës. Sipas dokumentacionit të ofruar vërehet se sasia prej 725m3 është paguar, ndërsa furnizimi dhe pranimi i furnizimeve ishte 720m3 apo 5 m3 më pak nga sasia e paguar/kontraktuar. Pas dëshmive të pranuara shihet se kjo sasi me lëndë djegëse është pranuar më vonë.	**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të sigurojë mbikëqyrje dhe kontroll mbi komisionet/organet mbikëqyrëse për pranim të furnizimeve me lëndë djegëse. Po ashtu, menaxheri i kontratës duhet të kërkojë nga operatori ekonomik furnizimin e plotë të sasisë apo të bëhet kthimi i mjeteve për sasinë e pa furnizuar.	**Rekomandim i zbatuar.** Kjo gjetje është e adresuar, ne kemi ofruar deshmi tek ekipi i auditorëve se sasia e paguar dhe e pranuar nga përfituesit është në harmoni me sasinë e kontraktuar me OE.	Udhëheqësja dhe zyrtarët përgjegjës të ZKK.	**Rekomandim i zbatuar.**
2	**Çështja A2 - Mos përfshirja e elementeve përkatëse në kushtet e kontratës me përfituesit**	Më datën 19.06.2023, është lidhur kontratë publike mes komunës dhe operatorit ekonomik për furnizimin e moto kultivatorëve dhe mekanizmave bujqësore për fermerët e komunës së Prizrenit. Çmimi i kontratës kornizë ishte 357,400€ duke participuar komuna me 85% dhe fermerët e komunës me 15%. Me rastin e testimi të dy pagesave (183,000€ dhe 100,000€), kemi vërejtur se komuna ka bërë pranimin teknik të moto-kultivatorëve më datën 12.09.2023 duke konstatuar se janë pranuar sipas specifikave të kërkuara. Në bazë të rishikimit të 11 kontratave të lidhura me përfituesit në kuadër të drejtave dhe obligimeve tek kontratat me fermerët nuk janë plotësuar kontratat me informata relevante siç janë vendosja e numrave	**Rekomandimi A2** Kryetari të sigurojë se çdo marrëveshje me përfituesit/fermerët me rastin e dhënies së subvencioneve të çfarëdo mekanizmi bujqësor do të përfshijë elementet përkatës, duke kërkuar vendosjen e numrave serik të të gjitha rasteve të tilla.	Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural konstaton se kjo e gjetur ka ndodhur pasi që gjatë bartjes së të dhënave nga lista e përfituesve tek kontrata nuk janë bartur numrat serik (edhe pse në listat e përfituesve ekzistojnë numrat serik të mekanizmave bujqësor), kjo çështje është adresuar dhe në përgatitjen e kontratave për përfituesit në thirrjet për subvencione me mekanizma bujqësor, gjatë këtij vitit do të vendosen të dhënat me numra serik.	Drejtori dhe zyrtarët përgjegjës të drejtorisë.	2 shtator – 31 dhjetor 2024.

		serik për mekanizmat bujqësor.				
3	**Çështja A3 - Dobësi në menaxhimin e projekteve përmes platformës elektronike të e-prokurimit**	Nga testimet e bëra, ka rezultuar se në nënte (9) raste, menaxhimi i kontratave dhe vlerësimi i performancës së kontraktuesve nuk është mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik (eprokurimi), si: • ‘’Ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve të klubeve sportive, shtrimi i fushave me tartan’’në vlerë prej 174,174€; • Renovimi i Qendrës Sportive ''Sezair Surroi'' në Prizren ” në shumë prej 518,035€; • ‘’Ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve të klubeve sportive në Prizren’’ në vlerë prej 262,000€; • ‘’Ndërtimi i shtëpisë së pleqve’’ në shumë prej 94,250€; • ‘’Asfaltimi i rrugës Trepetic-Petrovë’’ në shumë prej 198,933€; • ‘’Ndërtimi i aneksit të objektit shkollor Ardhmëria në Fshatin Landovicë’’ në vlerë prej 522,546€; • ‘’Ndërtimi i rrugëve lokale në Lubizhdë të Hasit’’ në shumë prej 327,118€; • ‘’Renovimi i tërësishëm i objektit shkollor (aneksit të vjetër) Naim Frasheri Vlashnje’’ në vlerë prej 64,083€; dhe • ‘’Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Randobravë’’ në vlerë prej 249,954€.	**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të rishikoj shkaqet e mospërdorimit të sistemit e-prokurimi dhe të ndërmarrë masa shtesë të kontrollit për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet në sistemin elektronik të prokurimit publik.	Drejtorit Komunale kanë analizuar këtë gjetje dhe së përkundër faktit disa prej Drejtorive shumica e kontratave janë menaxhuar(mbikëqyrur) nga operator të kontraktuar, ne do të sigurohemi që në të ardhmen menaxhimi i kontratave të bëhet edhe përmes platformës E-prokurimi. Shtimi i stafit profesional do të mundësoj të pakësohet edhe numri i menaxhimit të kontratave për menaxherët aktual dhe se mundësia për mirëmbajtjen e sistemit elektronik do të jetë me e madhe.	Menaxherët e kontratave në: Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Drejtorinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtorinë e Arsimit.	1 gusht - 31 dhjetor 2024
4	**Çështja A4 - Mos përfshirja e vendimeve në e-prokurim për pagesat për inflacion**	Sipas të dhënave të Thesarit në kuadër të kodit ekonomik’’34200’’ kompensim për inflacion, komuna ka paguar shumë totale prej 507,959€ për 25 projekte të ndryshme kapitale. Me rastin e testimit të dy mostrave në shumë prej 110,135€, kemi vërejtur se komuna ka bërë aprovimin për pagesë si kompensim të inflacionit derisa këto vendime nuk janë	**Rekomandimi A4** Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës në rastet e tilla do të marrin masa korrigjuese të menjëhershme për të zbatuar detyrimin ligjor të raportimit të vendimeve për kompensim për inflacion në platformën elektronike të	**Rekomandim i mbyllur i zbatuar (nuk është i aplikueshëm).** **Ky rekomandim konsiderohet i mbyllur(i pa aplikueshëm) pasi që fushëveprimi i ligjit ishte deri me 30 qershor 2023.** Udhëheqësi i prokurimit do të shtojë kontrollin e brendshme që në platformën e E-prokurimit, të ngris të gjitha dokumentet të cilat	Udhëheqësi i zyrës së prokurimit dhe menaxheri i kontratës.	**Rekomandim i mbyllur(nuk është i aplikueshëm).** **Rekomandim i zbatuar për pjesën e dytë të së gjeturës.**

		vendosur në platformën elektronike të prokurimit publike, siç është përcaktuar me rregullativën në fuqi. Në një rast tjetër, kemi vërejtur se një operator në bazë të kërkesës është marrë vendim për kompensim të inflacionit në vlerë 30,000€. Pavarësisht kësaj, operatori nuk ka përmbushur kontratën në tërësi, ku vlera e punëve të pakryera ishte 36,515€. Ne nuk kemi gjetur se komuna ka pranuar nga KRPP ndonjë sqarim me shkrim për mosfunksionimin e e-prokurimit, përkundër që zyra e prokurimit ka njoftuar KRPP-në. Ndërsa në rastin tjetër, sipas menaxherit të kontratës për mosrealizimin e kontratës në tërësi (për vlerën e lartcekur) ka ndodhur si rezultat i mos gatishmërisë, përkatësisht refuzimit së operatorit ekonomik për përmbushjen e kontratës në tërësi.	prokurimit publik. Po ashtu të kërkoj veprime apo mekanizma shtesë, për realizimin e projektit nga operatori ekonomik apo të ndërmerr hapa tjerë ligjor.	i parasheh LPP dhe rregulloret e KRPP. Për gjetjen në paragrafin e dytë konstatojmë se operatori ekonomik i ka përfunduar punimet dhe është iniciuar procesi për pranimin teknik të projektit.		
5	**Çështja A5 - Zotimi i mjeteve dhe urdhër blerjet jo sipas rregullave financiare**	Gjatë testimeve, kemi identifikuar se: • Në (19) raste, në vlerë të pagesave 1,692,329€, zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të mallit apo shërbimit/punëve dhe pranimit të faturës; dhe • Në (31) raste, në vlerë të pagesave 2,271,085€, urdhër blerjet ishin bërë pas pranimit të mallit apo shërbimit dhe pranimit të faturës, jo siç kërkohet me rregulla financiare.	**Rekomandimi A5** Kryetari të siguroj se duhet të respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave, në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet puna/shërbimi, si dhe të kryhet pagesa.	Drejtori për Buxhet dhe Financa do ta përgatit një qarkore-shkresë ku do të përshkruhen me saktësi të gjitha hapat për pagesë të bazuara në rregulloren e thesarit dhe do ti dërgohet të gjithë udhëheqësve të programeve buxhetore, menaxherëve të kontratave, zyrtarëve të prokurimit, me qëllim të zbatimit të hapave për pagesë.	Drejtori për Buxhet dhe Financa, ZKF, menaxherët e kontratave, stafi i zyrës së prokurimit.	1 gusht - 31 dhjetor 2024
6	**Çështja A6 - Mungesa e projektit ekzekutiv**	Projekti: "Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrugëve me asfalt” në vlerë prej 3,470,000€, nuk kishte një projekt ekzekutiv të hartuar nga komuna. Megjithatë, ishte nisur procesi i prokurimit duke përgatitur vetëm paramanës dhe parallogarinë''	**Rekomandimi A6** Kryetari të sigurojë forcimin e kontrolleve dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.	Sa i përket këtij rekomandimi, ne kemi monitoruar inicimin e procedurave tenderuese dhe nuk kemi zhvilluar procedura të mëtejme pa pasur projekte ekzekutive ashtu siç kërkohet edhe në LPP. Çështja e ngritur nga ana e juaj ka të bëjë me kontratë kornizë, e cila realizohet sipas kërkesave	Udhëheqësi dhe stafi i zyrës së prokurimit	**Përpos rastit në fjalë në të gjitha rastet tjera zbatohen projektet ekzekutive para inicimit të procedurave të prokurimit. Ne konsiderojmë se**

				gjatë afatit të caktuar kohor dhe ka të bëjë me punë rehabilituese (mirëmbjatje të rrugëve ekzistuese), andaj për këto lloje të kontratave nuk mund të përgatiten projekte ekzekutive.		**ky rekomandim është i zbatuar.**
7	**Çështja B1 - Vonesa në pagesën e faturave**	Në (6) gjashtë raste, faturat në vlerë totale prej 601,437€, të paraqitura në pasqyra financiare, prezantojnë fatura të papaguara për më shumë se 30 ditë me vonesë, nga 15 ditë deri në rreth 4 muaj. Me testimin e nëntë (9) pagesave nga kategoria e investimeve kapitale dhe gjashtë (6) pagesave nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, kemi identifikuar se janë ekzekutuar pagesa në bazë të vendimeve përmbarimore/gjykatave. Sipas vlerës së testuar të këtyre mostrave kemi vërejtur se në emër të pagave për shujta/paga jubilare janë paguar 89,448€, (nga investimet kapitale) përkatësisht 74,191€ (nga mallra dhe shërbime).	**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.	Do të shtohet monitorimi në disiplinën financiare dhe asnjë drejtori nuk do duhej të inicioj protokollimin/pranimin e faturave, nëse paraprakisht nuk janë zotuar mjetet. Pjesa më e madhe e pagesave përmes vendimeve gjyqësore, janë për pagesa që rrjedhin nga marrëveshjet kolektive për sistemin e arsimit, konsiderojmë që kjo çështje mund të mos zbatohet në tërësi edhe këtë vit dhe në shumë raste kemi të pamundur që të gjitha pagesat të orientohen nga fondi i pagave dhe mëditjeve, në rastet kur kemi mundësi financiare ne do të kërkojmë edhe ridestinim të mjeteve, me qellim të rritjes së fondit për realizimin e këtyre pagesave, e cila është dhe mbetet barra me e madhe dhe sfiduese për komunën.	Menaxherët e kontratave, zyrtari kryesor finananciar, zyrtarët e thesarit	1 gusht - 31 dhjetor 2024
8	**Çështja B2 - Vonesa në realizimin e projekteve kapitale**	Në tre (3) raste, kemi evidentuar vonesa në realizimin e projekteve, si në vijim: • Kontrata "Ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve të klubeve sportive dhe shtruarja me tartan'' në vlerë 174,174€, e nënshkruar më datë 03.02.2023, nuk është kryer sipas planit dinamik prej 180 ditë; • Kontrata "Ndërtimi i rrugës Trepetice - Petrove'' në vlerë 198,933€, e nënshkruar më datë 23.05.2023, nuk është kryer sipas planit dinamik prej 120 ditë; dhe	**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në menaxhimin e kontratave duke zbatuar një mbikëqyrje të rregullt dhe efektiv. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat/ndëshkimet e parapara në kontratë.	Do të shtohen kontrolle që realizimi i projekteve të bëhet brenda afateve të parapara në planin dinamik dhe duke respektuar kushtet e specifikuara në kontratë. Zakonisht në mos zbatimin e afateve sipas planit dinamik po ndikojnë shumë faktorë si kushtet atmosferike, problemet pronësore etj.	Menaxherët e kontratave në: Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe në Drejtorinë e Shërbimeve Publike.	Gjatë periudhës së mbetur të vitit 2024

		• Kontrata ''Ndërtimi i rrugëve lokale Lubizhdë të Hasit'' në vlerë 327,118€, e nënshkruar më datë 08.03.2021, nuk është kryer sipas planit dinamik prej 360 ditë. Derisa ishim nën auditim (prill 2024), asnjëra nga këto projekte nuk ishin të përfunduara.				
9	**Çështja B3 - Inicimi i procedurave të prokurimit pa fonde të mjaftueshme**	Në 13 raste komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale duke mos pasur mjete mjaftueshme të zotuara. Rastet kanë të bëjë me projektet: • Projekti ''Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrugëve me asfalt" me vlerë të kontratës prej 3,470,000€, derisa zotimi i mjeteve ishte 50,000€; • Projekti ''Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe vendosja e ujëmatësve jashtë pronës private në fshatin Zhur'' me vlerë të kontratës prej 2,497,919€, derisa zotimi i mjeteve ishte 50,000€; • Projekti ''Rregullimi i ndriçimit publik në fshatin Lubizhdë të Hasit të Prizrenit'' me vlerë të kontratës prej 444,887€, derisa zotimi i mjeteve ishte 14,307€; • Projekti ''Shtresimi i rrugëve me asfalt në fshatin Hoqë'' me vlerë të kontratës prej 248,980€, derisa zotimi i mjeteve ishte 17,801€; • Projekti ''Shtresimi i rrugëve me asfalt në fshatin Hoqë të Qytetit'' me vlerë të kontratës prej 76,671€, derisa zotimi i mjeteve nuk ishte bashkangjitur deklaratës së nevojave të disponueshmërisë; • Projekti ''Rehabilitimi dhe rivitalizimi i hapësirave publike në zonën e parë të mbrojtur në pjesën e vjetër të qytetit, restaurimi shesheve dhe objekteve'' me vlerë të kontratës sipas çmimit për njësi 3,360 (vlera e parashikuar 3,000,000) derisa zotimi i mjeteve ishte 5,914€. • LOT 2 'Furnizim me pelet për	**Rekomandimi B3** Kryetari duhet të forcojë kontrollet gjatë vlerësimit të projekteve, duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit për çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizimin e projekteve.	Inicimi i procedurave të prokurimit bëhen duke u bazuar në deklaratën e disponushemërisë së mjeteve(ku ka raste që mjetet të jenë të planifikuara brenda një deri në tri vite), zotimi për projektet e financuara nga Grandi qeveritar do të zotohen sipas planit të shpenzimeve. Për projektet që realizohen nga të hyrat vetanake, zotimi do të bëhet sipas alokimit për këto projekte(ku zotimi për këto projekte nuk do të mund të jetë sipas vlerës së kontratave të nënshkruara).	Udhëheqësit/ zyrtarët iniciues nga njesitë kërkuese, ZKF, udhëheqësi i zyrës së prokurimit	1 gusht - 31 dhjetor 2024

		ngrohje për shkollat e Komunës së Prizrenit 2023/2024 me vlerë totale indikative të kontratës prej 354,042€, derisa zotimi i mjeteve ishte 5,000€; • 'Furnizim me zhavorr për rrugët e paasfaltuara në Komunën e Prizrenit" me vlerë të kontratës prej 1,399,255€, derisa zotimi i mjeteve ishte 24,312€; • 'Furnizim me lëndë djegëse dru ahu për ngrohje për familjet e dëshmorëve, familjet e invalidëve të luftës dhe familjet skamnore –rastet sociale të Komunës së Prizrenit' me vlerë totale indikative të kontratës prej 184,161€, derisa zotimi i mjeteve ishte 24,000€; • 'Transporti i mësimdhënësve udhëtar në Komunën e Prizrenit' me vlerë totale indikative të kontratës prej 266,335€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 10,000€; • Revista teatrore'' me vlerë të parashikuar të kontratës prej 60,000€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 19,425€; • 'Hartimi i projekteve sipas nevojave të drejtorisë për Turizëm dhe zhvillim ekonomik' me vlerë të kontratës totale indikative prej 59,950€, derisa zotimi i mjeteve ishte 1,000€; dhe • 'Furnizim me material higjienik për nevojat e KPSH (projekt 2 vjeçar)' me vlerë totale indikative të kontratës prej 139,935€, deri sa zotimi i mjeteve ishte 15,000€.				
10	**Çështja B4 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve**	Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 241,824€ në kategori jo adekuate : • Nga kategoria investimet kapitale janë paguar për paga dhe mëditje/shujta në shumë prej 89,448€; dhe • Nga kategoria për mallra dhe shërbime janë paguar 74,191€, për furnizim me mjete ndihmëse për OJQ-të dhe klubet sportive si dhe 78,185€	**Rekomandimi B4** Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ri-destinimi i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.	Ne në vijim do të forcojmë kontrollin gjatë planifikimit të buxhetit dhe për çdo ndarje buxhetore do të planifikohet, shpenzohet dhe regjistrohet sipas kategorive ekonomike adekuate. Përmbarimi i obligimeve që kanë të bëjnë jashtë procesit të zbatimit të kontratës kolektive ne do ta rrisim kontrollin edhe në ato	Zyrtari Kryesor Financiar, Menaxhmenti i DASH, DKRS dhe DPMS.	Sa i përket çështjes së shujtave, zbatimi i plotë i rekomandimit nuk do të mund të ndodhë brenda vitit 2024, por është proces i vazhdueshëm;

		janë paguar për furnizim me material për ndërtimin e shtëpive për rastet sociale në Prizren, që për nga natyra shpenzimi i takon subvencioneve dhe transfereve.		raste kur kemi kërkesë zyrtare nga thesari për caktimin e fondit për pagesa do ti orientojmë në fondet sipas natyrës së shpenzimit. Pagesat përmbarimore për shujta/inflacion të punonjësve arsimor, të cilat ishin regjistruar në kategorinë ekonomike të Investimeve kapitale në vend që të klasifikohen tek kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve, këto pagesa po ekzekutohen nga thesari (procedura përmbarimore) dhe janë marrë mjete nga kategoritë të cilat kanë pasur mjete të lira, kjo çështje duhet të ngritët në nivel të ministrive përkatëse sepse edhe pas kërkesave për rritjen e fondit tek pagat dhe mëditjet që pagat jubilare, shujta, inflacioni të cilët paguhen me procedura përmbarimore të ekzekutohen nga kodi përkatës, në kornizat afatmesme po përcaktohen limitet e planifikim vetëm për paga të rregullta; DKRS-Furnizimi me mjete ndihmëse për OJQ-të dhe klubet sportive, të paguara nga kategoria mallra dhe shërbime, kjo e gjetur është adresuar dhe në vitin 2024 nuk është iniciuar asnjë procedurë për këto furnizime. DPMS- për projekte të tilla sipas rekomandimit tuaj, ne do të bëjmë planifikimin adekuat në kategorinë subvencione dhe transfere.		**Çështja e ngritur për keq klasifikim në DKRS është zbatuar,** DPMS me planifikimin buxhetor, për vitin 2025.
11	**Çështja A7 - Mos mbyllja e investimeve në**	Në regjistrin e pasurive me vlerë mbi 1,000€, kemi identifikuar se komuna ka të regjistruara në regjistrat	**Rekomandimi A7** Kryetari duhet të sigurojë	Do të formohet Grupi Punues me anëtarë nga secila drejtori dhe në koordinim me zyrtarin e	Zyrtari i pasurisë, anëtarët e	Duke filluar nga 1 gusht deri 31 dhjetor 2024

	vijim si dhe regjistrimi i tyre si pasurive në përdorim	kontabël investime në vijim në vlerë prej 57,444,588€. Këtu përfshihen pasuri të blera (ndërtuara) gjatë viteve 2013-2023, për të cilat nuk është bërë pranimi teknik edhe pse projektet kanë përfunduar, si dhe projekte të cilat ende nuk kanë përfunduar ose që janë në proces ndër vite ose të pezulluara. Për më tepër, nuk mund të kalkulohet zhvlerësimi i këtyre pasurive, pasi ato ende janë të regjistruara si investime në vijim.	funksionimin e kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara dhe trajtimin e duhur të projekteve që janë në proces ose të pezulluara.	pasurisë do ti zhvillojnë procedurat për mbylljen e investimeve në vijim për periudhën 2013-2022, ndërsa për projektet e përfunduara në vitin 2023, zyrtari i pasurisë ka zhvilluar procedurat e mbylljes së regjistrave kontabël-investimet në vijim.	grupit punues.	
12	**Çështja C1 - Mos regjistrimi dhe mos harmonizimi në kohën e duhur të regjistrit të pasurive jo financiare**	Gjatë auditimit kemi konstatuar se: • Në shtatë (7) raste/pagesa të realizuara në vitin 2023, në vlerë totale prej 513,637€ nuk ishin regjistruar në SIMFK dhe PVF, por këto pasuri janë regjistruar në kohën procesit të auditimit (prill 2024); • Në vitin 2023, komuna ka regjistruar pasurit jo kapitale në sistemin e-pasuria, por këtij regjistri i mungon informata lidhur me kodin e nënkategorisë për të identifikuar regjistrimet e vitit të audituar; dhe • Komisioni i inventarizimit të pasurisë ishte formuar me kohë, mirëpo nuk kishte arritur të përfundoj raportin para përgatitjes së PVF-ve, por më datën 23.02.2024.	**Rekomandimi C1** Kryetari duhet të siguroj regjistrimin e plotë të pasurive kapitale në SIMFK në kohen e duhur dhe pasurit jo kapitale të regjistrohen në e-pasuri me informatat e duhura sipas nën kodeve ekonomike të kërkuara. Po ashtu, duhet të siguroj se procesi i inventarizimit kryhet me kohë dhe këto raporte të harmonizohen me gjendjen e pasurisë në regjistra dhe ti paraprijnë përgatitjes së PVF, në mënyrë që vlera e pasurisë të përcaktohen saktë.	Sa i përket rastet/pagesa të identifikuara gjatë procesit auditues këto pasuri janë regjistruar në kohën e procesit të auditimit, si dhe të gjitha pagesat për pasuri kapitale të vitit 2024 janë duke u regjistruar në vazhdimësi; Në vitin 2023 gjitha pasuritë nën 1,000.00€ të pranuara në depo/nën depot e komunës, janë të regjistruara me të gjitha elementet e duhura të kërkuara në sistemin e-pasuria, ndërsa po vazhdohet me regjistrimin e pasurive të pranuara edhe gjatë vitit 2024. Do të ndërmerren hapa konkret që Komisioni i inventarizimit të pasurisë ta përfundoj regjistrimin e inventarizimit, përgatitjen dhe dorëzimin e raportit para përgatitjes së PVF-ve, pra para datës 31.01.2025.	Zyrtari i pasurisë në bashkëpunim me zyrtarët e depove/nën depove në komunë, komisioni i inventarizimit,	Regjistrimi i pasurisë mbi dhe nën 1,000€ është proces i vazhdueshëm sipas dinamikave të pranimit të pasurive. Raporti i inventarizimit planifikohet të përfundoj më së largu me **20.01.2025.**

13	**Çështja B5 - Rritje e saldos së llogarive të arkëtueshme**	Në pasqyrat financiare janë shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 22,978,746€. Pjesa më e madhe e tyre i takon tatimit në pronë (53%), taksës nga mbeturinat (22%), taksës për bizneset (11%), qirasë për shfrytëzimin e pronës publike (4%) dhe taksës për leje ndërtimi (10%). Në 57 raste të hyrat nuk ishin inkasuar me kohë, kjo ka ndikuar në rritjen e llogarive të arkëtueshme në krahasim me vitin paraprak për 4,042,130€.	**Rekomandimi B5** Kryetari të siguroje përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave me kohë.	**Tatimi në pronë-** Nga ana e Departamentit të Tatimit në Pronë është duke u përgatitur manuali për inkasimin e borxheve, deri në fillimin e zbatimit të kësaj procedure ne do ti ndërmarrim këto veprime: Do të fillohet me identifikimin e tatimpaguesve të mëdhenj, të cilët nuk e kanë paguar tatimin në pronë dhe pastaj do ti zhvillojmë procedurat për inkasim të detyrueshëm. **Taksa për mbeturina-** Në mungesë të stafit të sektorit të mbeturinave, menaxhmenti i DSHP-së, me qëllimin e vetëm për përmirësimin i sistemit të faturimit dhe inkasimit të shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, do të aranzhojë/kontrakton një ekip profesionale në terren me qëllimin e vetëm përmirësimin e sistemit të inkasimit të hyrave nga mbeturinat. **Sa i përket çështjeve për:** Taksat për biznese, të hyrave nga qiraja për shfrytëzimin e pronës publike dhe taksës për leje ndërtimi, drejtorët/udhëheqësit e drejtorive përkatëse do ti shqyrtojnë të gjitha opsionet e mundshme ligjore, duke vendosur politika efikase me qëllim të rritjes së efikasitetit të mbledhjes së borxheve të akumuluara ndër vite.	Menaxheri i ZTP, zyrtarët e të hyrave për taksa nga bizneset, udhëheqësi i sektorit të ambientit, udhëheqësi i sektorit të pronës, drejtori dhe zyrtarët përgjegjës sipas lëndëve në Drejtorinë e Urbanizmit.	Ky rekomandim nuk mund të zbatohet në tërësi brenda vitit 2024, por është proces i vazhdueshëm.

Prizren, korrik 2024

Kryetari i Komunës

Shaqir Totaj

Republika e Kosovës
Republika Kosova -Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren- Prizren Belediyesi

KANCELARIJA PREDSEDNIKA

DATUM:	15.07.2024.godine.
ZA:	Vlora Mehmeti- Spanca, Generalna revizorka
CC:	Ramadan Gashi, Direktor Revizije u NKR Florim Maliqi, Rukovodolica ekipe Revizije
OD:	Agron Hoxha, Rukovodilac UR
PREKO:	Shaqir Totaj, Predsednik Opštine Prizren
PREDMET:	**AKCIONI PLAN ZA SPROVOĐENJE PREPORUKA NACIONALNE KANCELARIJE ZA REVIZIJU ZA FINANSIJSKE IZVEŠTAJE OPŠTINE PRIZREN ZA 2023. GODINU**

Poštovani,

U skladu sa članom 14. tačka 1. do 7. Pravilnika o radu za sprovođenje revizije i Akcionih planova Nacionalne Kancelarije Revizije, usvojenog 21.06.2019. godine, u prilogu se nalazi Akcioni plan za sprovođenje preporuka iz Završnog izveštaja revizije za Opštinu Prizren za finansijsku godinu završenu 31.12.2023, koju su pripremili članovi radne grupe u saradnji sa JUR. Uzimajući u obzir Revizorski izveštaj Nacionalne Kancelarije Revizije (NKR), u skladu sa nalazima i zaključcima revizije, opredeljeni smo za adresiranje preporuka datih kroz Akcioni plan. Opština Prizren je formirala Radnu grupu i imenovala Koordinatora procesa i da će se napredak u sprovođenju preporuka razmatrati u skladu sa rokovima utvrđenim akcionim planom, pripremajući Izveštaj o napretku sprovođenja preporuka , koji će se izveštaj podnositi u dva perioda: **30. septembra 2024. godine i 15. marta 2025. godine**, prema uslovima propisanim Pravilnikom o radu za sprovođenje revizije i akcionih planova NKR.

AKCIONI PLAN ZA SPROVOĐENJE PREPORUKA NACIONALNE KANCELARIJE ZA REVIZIJU ZA FINANSIJSKE IZVEŠTAJE OPŠTINE PRIZREN ZA 2023. GODINU

Br	Komponenta revizije (poglavlje)	Nalaz	Preporuke	Praniranje preduzetih postupaka	Odgovorni službenik/ci	Planirani datum sprovođenja preporuke
1	**Pitanje A1 - Puno plaćanje za snabdevanje gorivom**	Dana 23.02.2022 godine potpisan je ugovor sa EO u iznosu od 56,550€ za projekat „Snabdevanje drvetom za grejanje za društvene prilike“. Komisija je dana 06.04.2023.godine, na osnovu primljenog računa, konstatovala da je isporuka drveta izvršena i po količini i po kvalitetu prema uslovima ugovora. Prema priloženoj dokumentaciji, konstatuje se da je uplaćen iznos od 725 m3, dok je isporuka i prijem zaliha 720 m3 ili 5 m3 manje od plaćenog/ugovorenog iznosa. Nakon dobijenih dokaza, vidi se da je ova količina goriva naknadno primljena.	**Preporuka A1** Predsednik mora da obezbedi nadzor i kontrolu komisijama/organima Nadzornik za prijem zaliha goriva. Isto tako, menadžer ugovora mora da zahteva od ekonomskog operatera punu nabavku količine ili da vrati sredstva za neisporučenu količinu.	**Preporuka sprovedena.** Ovaj nalaz je adresiran, pružili smo dokaze revizorskoj ekipi da je iznos koji je uplaćen i primljen od strane korisnika u skladu sa iznosom ugovorenim sa EO.	Rukovodilac i odgovorni službenici OKZ	**Preporuka sprovedena.**
2	**Pitanje A2 - Neuključivanje relevantnih elemenata u uslove ugovora sa korisnicima**	Dana 19.06.2023 godine potpisan je javni ugovor između opštine i ekonomskog operatera za nabavku motokultivatora i poljoprivrednih mehanizama za poljoprivrednike opštine Prizren. Cena okvirnog ugovora iznosila je 357,400€, uz učešće opštine sa 85% i poljoprivrednika opštine sa 15%. U slučaju testiranja dve uplate (183,000 € i 100,000 €), uočili smo da je opština izvršila tehnički prijem motokultivatora dana 12.09.2023. godine, navodeći da su primljeni prema traženim specifikacijama. Na osnovu pregleda 11 ugovora koji se odnose na korisnike u okviru prava i obaveza iz ugovora sa poljoprivrednicima, ugovori nisu kompletirani sa relevantnim informacijama, kao što je postavljanje serijskih brojeva za poljoprivrednu mehanizaciju.	**Preporuka A2** Predsednik će obezbediti da svaki sporazum sa korisnicima/poljoprivrednicima u slučaju davanja subvencija bilo kog poljoprivrednog mehanizma uključuje relevantne elemente, koji zahtevaju uspostavljanje serijskih brojeva svih takvih slučajeva.	U Diretorijatu za poljoprivredu i ruralni razvoj navode da je do ovog saznanja došlo zbog toga što prilikom prenosa podataka sa spiska korisnika na ugovor nisu preneti serijski brojevi (iako redni brojevi poljoprivrednih mehanizama postoje u spiskovima korisnika) , ovo pitanje je obrađeno iu pripremi ugovora za korisnike na pozivima za subvencije poljoprivrednim mehanizmima tokom ove godine biće stavljeni podaci sa serijskim brojevima.	Direktor i odgovorni službenici direktorijata	2 septembar – 31 decembar 2024

3	**Pitanje A3 - Nedostatke u upravljanju projektima preko elektronske platforme za e-nabavke**	Iz sprovedenih testova, ustanovljeno je da u devet (9) slučajeva, upravljanje ugovorima i ocenjivanje učinka izvođača nije održavano i arhivirano preko elektronskog sistema javnih nabavki (e-nabavka), kao što su: • „Izgradnja i održavanje objekata sportskih klubova, postavljanje tartan terena“ u iznosu od 174,174€; • Renoviranje sportskog centra „Sezair Suroi“ u Prizrenu“ u vrednosti od 518,035€; • „Izgradnja i održavanje objekata sportskih klubova u Prizrenu“ u iznosu od 262,000€; • „Izgradnja staračkog doma“ u iznosu od 94,250€; • „Asfaltiranje puta Trepetić-Petrove“ u iznosu od 198,933€; • „Izgradnja aneksa školske zgrade Ardhmeria u selu Landovice“ u iznosu od 522,546€; • „Izgradnja lokalnih puteva u Lubižde i Hasu“ u iznosu od 327,118€; • „Kompletna obnova školske zgrade (stari aneks) Naim Frasheri Vlashnje'' u iznosu od 64,083€; i • „Izgradnja kanalizacije u selu Randobrave“ u vrednosti od 249,954€	**Preporuka A3** Predsednik treba da razmotri razloge za nekorišćenje sistema e-nabavki i da preduzme dodatne mere kontrole kako bi obezbedio da se upravljanje ugovorima održava i arhivira u elektronskom sistemu javnih nabavki.	Opštinski direktori su analizirali ovaj nalaz i da uprkos činjenici da u nekim direktorijatima većinu ugovora upravlja (nadgleda) ugovoreni operater, mi ćemo se postarati da u budućnosti upravljanje ugovorima bude takođe vršeno preko platforma za e-nabavke. Dodavanje stručnog kadra omogućiće da se smanji broj upravljanja ugovorima za sadašnje rukovodioce i da će mogućnost održavanja elektronskog sistema biti veća.	Menadžeri ugovora u: Direktorijat za kulturu, omladinu i sport, Direktorijat za javne usluge, Direktorijat za rad i socijalno blagostanje i Direktorijat za obrazovanje.	1 avgust - 31 decembar 2024
4	**Pitanje A4 - Ne uključujući odluke u e-nabavkama za plaćanje inflacije**	Prema podacima Trezora, u okviru ekonomskog koda "34200" nadoknada za inflaciju, opština je isplatila ukupan iznos od 507,959€ za 25 različitih kapitalnih projekata. Prilikom testiranja dva uzorka u vrednosti od 110,135€, uočili smo da je opština dala saglasnost za isplatu na ime naknade za inflaciju do postavljanja ovih odluka na elektronsku platformu javnih nabavki, kako je utvrđeno važećim uredbama. U drugom slučaju smo uočili da je operateru na osnovu zahteva dato rešenje da nadoknadi inflaciju u	**Preporuka A4** Predsednik mora da obezbedi da će odgovorni službenici u takvim slučajevima preduzeti hitne korektivne mere za sprovođenje zakonske obaveze da se odluke o naknadi inflacije prijave na elektronskoj platformi javnih nabavki. Takođe zahtevam dodatne postupke ili mehanizme za realizaciju projekta od ekonomskog operatera ili preduzimam druge zakonske korake.	**Primenjena je zatvorena preporuka (nije primenljivo).** **Ova preporuka se smatra zatvorenom (nije primenljiva) pošto je delokrug zakona bio do 30. juna 2023. godine.** Menadžer nabavke će dodati unutrašnju kontrolu platformi e-nabavke, kako bi učitao svu dokumentaciju predviđenu propisima ZJN i RKJN. Za nalaz u drugom stavu, nalazimo da je ekonomski operater završio radove i da je	Rukovodilac kancelarije nabavke i menadžer ugovora.	**Zatvorena preporuka (nije primenljivo).** **Primenjena preporuka za drugi deo nalaza**

		iznosu od 30,000€. Uprkos tome, operater nije ispunio ugovor u celini, gde je vrednost nezavršenih radova bila 36,515€. Nismo pronašli da je opština dobila od RKJN bilo kakvo pismeno objašnjenje za nefunkcionisanje e-nabavke, uprkos činjenici da je kancelarija za nabavke obavestila RKJN. Dok je u drugom slučaju, prema menadžeru ugovora, neispunjenje ugovora u celosti (za gore navedenu vrednost) nastalo je kao rezultat nespremnosti, odnosno odbijanja ekonomskog operatera da ispuni ugovor u celini.		pokrenut proces tehničkog prijema projekta.		
5	**Pitanje A5 - Opredeljivanje sredstava i naručivanje kupovine nije u skladu sa finansijskim pravilima**	Tokom testiranja uočili smo da: • U (19) slučajeva, u iznosu od 1,692,329€, zalog sredstava je izvršeno nakon prijema robe ili usluge/radova i prijema računa; I • U (31) slučaju, u iznosu od 2,271,085€, narudžbenice su napravljeno nakon prijema robe ili usluge i primanje računa, a ne kako to zahtevaju finansijskih pravila.	**Preporuka A5** Predsednik mora da obezbedi da se poštuju koraci definisani pravilima koja su na snazi u vezi sa realizacijom plaćanja tako da se tokom procesa plaćanja prvo obavežu sredstva, zatim se izda nalog za kupovinu i na kraju rad/usluga prihvati, kao i da izvrši uplatu.	Direktor budžeta i finansija će pripremiti cirkularno pismo koje će tačno opisati sve korake za isplatu na osnovu uredbe o trezoru i biće poslato svim menadžerima budžetskih programa, rukovodiocima ugovora, službenicima za nabavke, u cilju sprovođenja plaćanja.	Direktor za budžet i finansije, finansijski direktor, menadžeri ugovora, osoblje kancelarije za nabavke	1 avgust - 31 decembar 2024
6	**Pitanje A6 - Nedostatak izvršnog projekta**	Projekat "Rehabilitacija i izgradnja asfaltnih puteva" u iznosu od 3,470.000 €, nije imao opštinski izvršni projekat. Međutim, proces nabavke je započet pripremanjem samo predmere i predračuna''	**Preporuka A6** Predsednik obezbeđuje jačanje kontrola i prati sprovođenje Zakonski uslovi da se po pokretanju postupka nabavke za ugovaranje radova unapred obezbedi izrada projekata u skladu sa predviđenim potrebama i zahtevima.	Što se tiče ove preporuke, mi smo pratili pokretanje tenderskih procedura i nismo razvili dalje procedure a da nismo imali izvršne projekte kao što se zahteva ZJN. Pitanje koje ste pokrenuli se odnosi na okvirni ugovor, koji se sprovodi prema zahtevima u navedenom vremenskom roku i odnosi se na radove na sanaciji (održavanje postojećih puteva), tako da za ove vrste ugovora ne može biti izvršni projekat. pripremljena .	Rukovodilac kancelarije za nabavke i osoblje	**Osim u predmetnom slučaju, u svim ostalim slučajevima izvršni projekti se realizuju pre pokretanja postupka nabavke. Smatramo da je ova preporuka sprovedena.**
